

Shtator 2015  
Numri: 90  
E përmuajshme

Revistë edukative-kulturore - [www.revistaetika.com](http://www.revistaetika.com)

Shqipëri: 200 Lekë  
Kosovë: 1.5 Euro  
Maqedoni: 90 Den  
Evropë: 7 Euro

# ETIKA




## Kthimi juaj është tek UNË!



ISSN 2227-3611  
9 772227 361004 08

# Arsyeja dhe Filozofia

IRI



Një notar profesionist mund të notojë në ujëra të thella pa frikë, duke shijuar në këtë mënyrë bukuritë nënujore. Nuk ka asnjë problem për një besimtar cilësor, i cili ka njohuri të mjaftueshme rreth fesë së tij, të shëtisë nëpër kulturat e popujve të tjerë. Problem është të notosh në ujëra të thella pa ditur not. E rrezikshme është të përballesh me kulturat, botëkuptimet dhe rrymat e tjera filozofike, pa pasur njohuritë e duhura rreth Islamit. Në këtë rast ekziston rreziku për të mbetur nën ndikimin e tyre.

Një tjetër problem që ka sjellë filozofia, është përpjekja e disa pseudofilozofëve dashamirë dhe admirues të filozofisë perëndimore, për ta bazuar mendimin islam mbi themele filozofike. Kjo është një përpjekje tinëzare për të vendosur arsyen mbi shpalljen hyjnore.

TË  
RËNË



Dita, e cila në një kuptim të ngushtë është shprehja e një pjese të caktuar kohore, me sa duket, ngaqë është mjaft e rëndësishme, në Kuranin Famëlartë përmendet me qindra herë. Në mesin e ditëve që përbëjnë rëndësi për botën tjetër, janë: Dita e gjykimit, Dita e Ahiretit, Dita e Kiametit, Dita e Ringjalljes etj.

Edhe në jetën e kësaj bote, njeriu ka ditë që përbëjnë rëndësi: dita e lindjes, dita e vdekjes, dita e takimit, dita e ndarjes, dita e fitesës, dita e humbjes etj. Sa më shumë që të kujtohen ditët e mira, aq më shumë lumturohet njeriu dhe sa më shumë që të përmenden ditët e këqija, aq më shumë mërzitët ai. Mirëpo, si gëzimi, ashtu edhe hidhërimi janë të përkohshëm. Ajo çfarë mbetet është fitesa dhe humbja, gëzimi dhe hidhërimi, që do t'i shërbejnë njeriut në botën tjetër. Ndaj dhe, që të kesh në duar fitesën që mbetet, duhet të drejtojmë të gjitha përpjekjet tona në drejtim të Ahiretit, me qëllim që të shpëtojmë nga dëmi që mbetet. Përpjekjet tona në këtë botë duhet të kenë frytet e tyre për botën tjetër.

Sipas Kuranit, secili që beson në botën tjetër duhet ta marrë seriozisht **"Ditën e Madhe"**. Pasi ajo ditë është dita në të cilën njerëzit do të dalin para Allahut që të japin llogari (K. Famëlartë, Mutaffifin, 6) **"Ditën, kur të gjithë njerëzit do të dalin para Zotit të botëve"** Pejgamberi (a.s.), e tregon në këtë mënyrë ditën e takimit me Zotin: **"Asnjëri nuk do të lëvizë nga vendi në Ditën e Kiametit, pa u pyetur se ku e ka kaluar jetën, se çfarë ka bërë me dijen e tij, se ku e ka fituar dhe ku e ka harxhuar pasurinë e tij dhe se ku e ka konsumuar trupin e tij"** (Tirmidhiu, Kijamet, 1) Ajo ditë është dita kur do të shpaloset gjithçka. Është dita kur nuk do t'i bëhet padrejtësi askujt dhe dita që do veprohet me drejtësi.

**"Kush ka bërë ndonjë të mirë, qoftë sa një thërmijë, do ta shohë atë e kush ka bërë ndonjë të keqe, qoftë sa një thërmijë, do ta shohë atë."** (Zelzele, 7-8)

Njeriu i mençur bën përgatitje për atë ditë të madhe; ka frikë të humbasë dhe që të mos turpërohet qëndron gjithnjë në gatishmëri. **"Frikësojuni Ditës kur askush nuk do të mund të bëjë asgjë për askënd dhe, kur prej askujt nuk do të pranohet as ndërmjetësim, as shpërblësë e as që do të ndihmoheni."** (Bekara, 48) **"Sikur keqbërësit të kishin çdo gjë që gjendet në Tokë dhe po kaq më tepër, të gjitha këto do t'i flijonin (për të shpëtuar) prej dënimit të ashpër në Ditën e Kiametit. Atëherë, do të përballen me atë që nuk e kanë llogaritur."** (Zumer, 47).

Zoti i Madhëruar është pronari i vërtetë i asaj dite, kur gjithçka që është vepruar në botë do të gjegjë shpërblim.

**"Ajo është Dita, kur askush nuk do të ketë fuqi për të bërë gjë për ndonjë tjetër dhe kur pushteti do të jetë vetëm i Allahut."** (Infitar, 19) Atë ditë as pendimi, as ndjesa, as përgjërimet e as dëshirat nuk do të vlejnjë. Paraja, pasuria, posti, fama, pushteti dhe fuqia do të mbesin jashtëloje. Do të kenë vlerë vetëm një ndërgegjeje e kulluar, një iman i pastër dhe një zemër e shëndoshë. **"Në Ditën, kur askujt nuk do t'i bëjë dobi as pasuria, as fëmijët, përveç atij që vjen me zemër të pastër tek Allahu!"** (Shuara, 88-89)

Atë ditë është e pamundur të fshehësh ndonjë gjë. Sipërfaqja e tokës dëshmon gjithçka çfarë ka mbi të. Edhe organet e njeriut bëjnë dëshmi kundër vetës së tyre. **"Sot Ne do t'ua vulosim atyre gojë e do të Na flasin duart e tyre dhe do të dëshmojnë këmbët e tyre për atë që kanë bërë."** (Jasin, 65)

# Përmbajtja

Arafati, vendi ku monumentalizohet Tevhidi  
Dr. Kerim Bulladë

12




10

Dita e madhe  
Ali Riza Temel



Egoizmi dhe mendjemadhësia  
Osman Nuri Topbash

34



22

29



Çfarë dhe përse duhet të mësoj?  
Idris Arpat

5 Sekreti i kësaj çështjeje,  
është të kuptosh "Atë ditë"

Ahmet Tashgetiren

15 Ebu Rezini

Mustafa Erish

16 Haxhi si një mysafirhane e madhe

Dr. Vejsel Akkaja

19 Kush është i suksesshmi?

Nuredin Jëlldëz

20 Përse është i rëndësishëm tevekkuli?

Xhafer Durmush

22 Haxhi sipas rregullave


M. Sami Ramazanollu

23 Puno!

Sadik Dana

24 Përse duhet lavdëruar Allahu?

Duran Ekizer



48

Përballë fëmijërisë sonë

Mehmet Dinç

Vetëdija e miqësisë

Sabahudin Tyzyn

Korniza e këshillës

Ali Byjyqçapar

Mrekullitë e Kuranit

Një Ajet - Një Hadith

Altruizmi

Sami Gëksyn

Kush mashtron nuk është prej nesh

Nuredin Nazarko

Unë dhe ti, tjetri jam unë

Edison Çeraj

Ruajtja e zemrës

Prof. dr. Hasan Kamil Jëllmaz

Fakte shkencore të Kuran  
M. sc. Artan S. Mehmet



40

"Allahume, më ruaj nga paaftësia  
për të punuar dhe nga dembelizmi..!"  
Imam Muhamed Sytari

46



# Sekreti i kësaj çështjeje, është të kuptosh “ATË DITË”

Njerëzit po shkojnë atje grupe-grupe...

Gjithësia po shkon drejt e atje. Drejt Kiametit. Drejt botës tjetër. Drejt daljes përpara Krijuesit Teala. Drejt vendit të mahsherit. Drejt Ditës së Madhe të llogarisë. Drejt Ditës së Gjykimit.

Fjala hyjnore, Kurani, është e mbushur me paralajmërimet për **“atë ditë”**. Atyre që pyesin me dyshim e mohim: **“Kur është ajo ditë?”, “Ajo ditë është afër!”**, u përgjigjet Kurani. **“Çdo shpirt do ta shijojë vdekjen”**, thërret ai (Kurani), sikur do t’u kujtojë të gjithëve Kiametin... **“Kthimi juaj është tek Unë”**, thotë Krijuesi i Madhëruar. **“Kënaqja me jetën e kësaj bote, është një shkak vetëmashtrimi dhe humbjeje”**, paralajmëron Krijuesi. **“Mos harroni se do të dilni para Meje, përndryshe do të jeni prej të harruarve”**, paralajmëron përsëri Krijuesi Teala. **“Shikoni çfarë keni përgatitur për nesër”**, thotë Ai. **“Do ta shihni se çfarë keni përgatitur dhe çfarë**

**nuk keni përgatitur”**, thotë përsëri.

Atje nuk të bën punë as pasuria e shumtë dhe as fëmijët e shumtë... “Lum ai që përgatit një zemër të pastër dhe pa sëmundje për daljen e tij para Allahut.” Bëhet e ditur se atje nuk do të anashkalohet as grimca më e vogël. Gjithashtu, siç është e sigurt se punët e mira do të dalin para njeriut mbi peshoren e drejtësisë, ashtu është e sigurt se edhe të këqijat nuk do të ngelen në xhepin e ndokujt. Bëhet e ditur se **“atje, të gjithë do të japin llogari më vete”**. Disa fytyra do të shkëlqejnë e disa të tjera do të nxihen.

Njeriu nuk e di në ç’vend dhe në ç’kohë do të thirret. Nuk ka radhë, të rinj, të vjetër, burrë apo grua. Për atë udhëtim, ftesat do të jenë surprizë. “Eja, tani është radha jote”, i troket derës meleku i vdekjes. Tani po ikën dhe s’ke mundësi tjetër. A je çdo moment i përgatitur apo jo? A je pajisur me zbardhues fytyre për atë udhëtim? Për të mos u turpëruar...

Për të mos përjetuar panikun e pastaj të thuash: **“Ku të ikim?”**... Për të mos u larguar në distanca të mëdha prej të afërmeve...

A i ke dhënë rëndësi **“Asaj dite”**, aq sa thirrjet dhe paralajmërimet këmbëngulëse të fjalës hyjnore, Kuranit? A është ndezur e fikur brenda teje drita e alarmit për Ditën e Mahsherit, për të vërtetën e dhënies së llogarisë? Sekreti i kësaj çështjeje, është të harrosh apo të mos e harrosh **“Atë ditë”**... Ja shiko, i përmblohdëm dhe i vumë para vetes një

pjesë të atyre paralajmërimeve të Kuranit... T'i lexojmë... t'i lexojmë disa herë. Le të gjejmë brenda këtyre paralajmërimeve se ku është vendi ynë... Të mendojmë se çfarë shpresojmë për momentin kur do të qëndrojmë të vetëm **“përballë Allahut”**. Kur të na thuhet: **“Lexoje librin tënd”** ose **“Shihe filmin tënd”**, a do të mbytemi në djersë nga koka tek këmbët apo me përgëzimin **“hyr në xhenetin Tim”**, do të shkëlqejnë thirrjet e gëzimit brenda nesh? Eja ni t'i lexojmë këto paralajmërimet të Kuranit, për t'i dhënë kuptim jetës sonë në këtë botë:

## Ajo Ditë në Kuran

“Çdo shpirt do ta shijojë vdekjen dhe pastaj të gjithë do të ktheheni tek Ne.” (Ankebut, 57)

“Vetëm Allahut i përket sundimi i qiejve dhe i Tokës dhe tek Ai kthehet çdo gjë.” (Nur, 42)

“Sigurisht, ata që nuk shpresojnë se do të takohen me Ne, që janë të kënaqur me jetën e kësaj bote, duke gjetur prehjen në të dhe që janë të pavëmendshëm ndaj shenjave Tona, do të kenë si vendstrehim zjarrin, për atë që kanë bërë.” (Junus, 7-8)

**“Atë ditë**, ata që nuk kanë besuar dhe që nuk i janë bindur të Dërguarit, do të dëshironin të rrafshoheshin me tokën, por Allahut nuk mund t'i fshehin asnjë fjalë.” (Nisa, 42)

“Atë që shpëtohet nga dënimi i **asaj dite**, vërtet Zoti e ka mëshiruar. Ky është shpëtimi i vërtetë.” (En'am, 16)

“Peshimi (i veprave), **Atë ditë** do të jetë i drejtë. Atyre që u rëndon peshorja me vepra të mira, do të jenë të shpëtuar.” (Araf, 8)

**“Atë ditë** do t'i shohësh keqbërësit të lidhur në pranga.” (Ibrahim, 49)

**“Atë ditë**, ata do t'i përulen Allahut dhe do të braktisen nga zotat që kishin sajuar vetë.” (Nahl, 87)

“Ditën, kur do të fryhet në Sur, pikërisht **Atë ditë** do t'i tubojmë të ligjtë me sy të zgurdulluar” (Ta-Ha, 102)

**“Atë ditë** nuk do të bëjë dobi ndërmjetësimi i askujt, përveç ndërmjetësit të atij, që i jep leje i

Gjithëmëshirshmi dhe që i është pranuar fjala.” (Ta-Ha, 109)

**“Atë ditë**, i tërë pushteti i përket Allahut. Ai do t'i gjykojë të gjithë: ata që kanë besuar dhe kanë bërë vepra të mira, do të gjenden në kopshtet e begatëve.” (Haxh, 56)

“Kur të fryhet në Sur (Ditën e Ringjalljes), **Atë ditë**, midis tyre nuk do të ketë lidhje farefisnore dhe ata as që do të pyesin për njëri-tjetrin.” (Mu'minun, 101)

**“Atë ditë** Allahu do t'ju shpagojë dënimin e merituar dhe ata do ta marrin vesh se Allahu është e Vërteta e qartë.” (Nur, 25)

**“Atë ditë**, kur të shohin engjëjt, për keqbërësit nuk do të ketë lajm të mirë dhe do t'u thuhet: ‘Nuk do të kaloni dot për matanë!’ (Furkan, 22)

“Ndërsa banorët e Xhenetit **Atë ditë** do të kenë vendbanim më të mirë dhe vendpushim më të bukur.” (Furkan, 24)

**“Atë ditë** pushteti i vërtetë do t'i përkasë vetëm të Gjithëmëshirshmit. Kjo do të jetë ditë e vështirë për jobesimtarët.” (Furkan, 26)

“Ata që kanë bërë vepra të mira, do të kenë shpërblim më të mirë dhe do të jenë të çliruar nga tmerrin e **asaj dite**” (Neml, 89)

**“Atë ditë**, argumentet e tyre do t'u ngatërrohen e ata nuk do të mund të pyesin njëri - tjetrin.” (Kasas, 66)

“E, **Atë ditë** kur të arrijë Ora, ata (besimtarët dhe



## FYTYRAT E ASAJ DITE

**Atë Ditë** do të poshtërohen fytyra njerëzish, që kanë punuar e janë rraskapitur (duke bërë të këqija në këtë botë). Ata do të digjen në zjarr të nxehtë e do të pinë nga burime të valuara. Për ata nuk do të ketë tjetër ushqim, përveç ferrave helmuese, të cilat as nuk do t'i mbajnë, as nuk do t'ua shuajnë urinë.

**Atë Ditë**, fytyrat e disave do të jenë të gëzuara, të kënaqura për punët e bëra. Ata do të jenë në kopshtin e lartë, në të cilin nuk do të dëgjojnë fjalë boshe. (Gashije, 2-11)

jobesimtarët) do të ndahen." (Rum, 14)

"Drejtohu ti me përkushtim në fenë e drejtë, para se të vijë prej Allahut Dita, e cila nuk mund të shtyhet. **Atë ditë**, njerëzit do të ndahen." (Rum, 43)

"**Atë ditë**, të gjithë ata do të jenë së bashku në dënim." (Saffat, 33)

"**Atë ditë** miqtë do të bëhen armiq të njëri-tjetrit, përveç të drejtëve, që e kanë pasur frikë Allahun." (Zuhruf, 67)

"I Allahut është pushteti i qiejve dhe i Tokës! E kur të arrijë Ora (e Kiametit), **Atë ditë** mohuesit do të humbasin." (Xhathije, 27)

"**Atë ditë** njerëzit dhe xhindet nuk do të pyeten për gjynahet e tyre. Pra, cilat dhunti të Zotit tuaj po i mohoni? Keqbërësit do të njihen sipas shenjave dhe do të kapen për ballukesh dhe për këmbësh." (Rahman, 39-41)

"**Atë ditë** do të mbeteni zbuluar dhe asnjë fshehtësi e juaja nuk do të mbetet pa u shfaqur: Ai, të cilit do t'i jepet libri i veprave të tij nga ana e djathtë, do t'u thotë (njerëzve të tij): 'Ja, lexoni librin tim! Vërtet, unë kam qenë i bindur se do të jepja llogari! Kështu, ai do të ketë jetë të lumtur, në një kopsht të lartë, frutat e të cilit do t'i kapë lehtë. (Njerëzve të tillë u thuhet): 'Ju bëftë mirë, hani e pini për atë, që keni bërë në ditët e kaluara! Por ai, të cilit do t'i jepet libri i veprave të tij nga ana e majtë, do të thotë: 'Ah, sikur të mos më ishte dhënë libri im dhe të mos e kisha ditur llogarinë time! Ah, të kisha qenë i vdekur (e të mos isha ringjallur)! Pasuria ime nuk

më solli dobi dhe më la fuqia!' (Do të thuhet) 'Kapeni dhe lidheni në pranga, pastaj digjeni në zjarrin përveçues, mandej lidheni në zinxhirë prej shtatëdhjetë kutësh, sepse ai, me të vërtetë, nuk ka besuar në Allahun e Madhërisëm dhe nuk është kujdesur për të ushqyer të varfrit e shkretë. Prandaj, ai sot këtu s'ka mik të afërt e as ushqim tjetër, përveç qelbit, të cilin e hanë vetëm gjynahqarët.'" (Hakka, 18-37)

"**Ajo ditë** do të jetë e shumë e vështirë. Për jobesimtarët nuk do të jetë aspak e lehtë." (Muddeththir, 9-10)

"Kur yjet të shuhën dhe, kur qielli të çahet dhe, kur malet të thërrmohen si pluhur dhe, kur të dërguarit të tubohen në kohën e caktuar, në cilën ditë do të ndodhin të gjitha këto? Në Ditën e Ndarjes vendimtare! Kush vallë do të ta shpjegojë se ç'është Dita e Ndarjes vendimtare? Mjerë mohuesit në **Atë ditë!**" (Murselat, 8-15)

"**Atë ditë** disa zemra do të jenë të mbushura me tmerr e shikimet e tyre do të bien përdhe. Ata thonë: 'Vallë, vërtet do të rikthehemi në jetë? A thua edhe kur të bëhemi eshtra të thërrmuara? Dhe thonë: 'Po që kështu, atëherë ky kthim do të jetë humbje (për ne)!' Por ajo do të jetë veç një fryrje e vetme (e Surit) dhe ata përnjëherësh do të brofin (të ringjallur)." (Naziat, 8-14)

"Por, kur të vijë Ushtima, **Atë ditë** njeriu do të ikë nga i vëllai, nga e ëma dhe nga i ati, nga e shoqja dhe nga fëmijët e vet. **Atë ditë**, secili prej tyre do të ketë aq shqetësim për veten, sa do t'i mjaftojë. **Atë ditë** do të ketë fytyra rrezëllore, të qeshura e të gëzuara

ra. **Atë ditë** do të ketë (edhe) fytyra të pluhurosura, që do t'i mbulojë errësira. Këta janë jobesimtarët, gjynahqarët." (Abese, 33-42)

"Kur Dielli të mblidhet e të humbë shkëlqimin; kur yjet të rrëzohen dhe malet të lëvizin tutje; kur devetë barsa të braktisen dhe egërsirat të tubohen; kur detet të vlojnë dhe shpirtrat të bashkohen (me trupat); kur foshnja e varrosur për së gjalli të pyetet për çfarë faji ishte vlarë; kur fletët të shpërndahen dhe qielli të zhvishet; kur Xhehenemi të flakërojë dhe Xheneti të afrohet: atëherë çdokush do të marrë vesh çfarë kishte përgatitur (për KËTË DITË)." (Tekuir, 1-14)

"(Atë ditë) çdokush do të mësojë për veprat që ka bërë dhe që ka lënë pa bërë." (Infitar, 5)

"Atë ditë, askush nuk do të ketë fuqi për të bërë gjë për ndonjë tjetër dhe pushteti do të jetë vetëm i Allahut." (Infitar, 19)

"Por ani! Kur Toka të bëhet copë e thërrime, kur të vijë Zoti yt (për të ndarë gjykimin) me engjëjt të rreshtuar radhë pas radhe. Dhe kur të sillt Xhehenemi, **Atë ditë** njeriu do të kujtohet - por ç'i duhet se u kujtua! Ai do të thotë: 'Ah, sikur të kisha bërë diçka të mirë për jetën time!' **Atë ditë**, askush nuk do të dënojë siç dënon Ai, e askush nuk do të lidhë

në pranga siç lidh Ai! O ti shpirt i qetësuar! Kthehu te Zoti yt, ti i kënaqur me Atë dhe Ai kënaqur me ty! Bashkohu me robërit e Mi dhe hyr në Xhenetin Tim!" (Fexhr, 21-30)

"Kur të dridhet Toka me tronditjen e saj (të fundit), kur të nxjerrë barrët nga brendia e saj e njeriu të thotë: 'Ç'po i ndodh asaj?' **Atë ditë** ajo do të tregojë lajmet e saj, sepse Zoti yt e ka frymëzuar atë. Atë Ditë njerëzit do të paraqiten grupe-grupe, që t'u tregohen veprat e tyre: kush ka bërë ndonjë të mirë, qoftë sa një thërrmijë, do ta shohë atë, e kush ka bërë ndonjë të keqe, qoftë sa një thërrmijë, do ta shohë atë." (Zelzele, 1-8)

"Vallë, a nuk e di ai se kur të nxirren jashtë ata që gjenden në varre dhe, kur të dalë në shesh ajo që është në gjokse, Zoti i tyre, me siguri, **Atë ditë** di çdo gjë për ta?" (Adijat, 9-11)

"Ju ka hutuar rivaliteti për të shtuar, derisa të shkoni në varre. Gjithsesi, do ta merrni vesh! Madje, së shpejti do ta merrni vesh! Kujdes! Ah, sikur ta dinit të vërtetën me siguri! Sigurisht që do ta shihni Zjarrin flakërues! Pastaj, me të vërtetë, do ta shihni atë me syrin e sigurisë. Pastaj, **Atë ditë**, do të pyeteni për kënaqësitë (e kësaj bote)!" (Tekathur, 1-8)

"Sot (**Atë ditë**) Ne do t'ua vulosim atyre gojë të do

## ATË DITË NGA ËSHTË IKJA?

"Betohem në **DITËN E KIAMETIT!**

Betohem në shpirtin qortues! A mendon njeriu se nuk do të mund t'i mbledhim eshtrat e tij? Po, si jo! Ne jemi të Zotë t'ia ribëjmë bashkë me përsosmëri edhe majat e gishtave të tij.

Por njeriu dëshiron të gabojë sa të jetë gjallë dhe pyet: 'Kur do të jetë Dita e Kiametit?'

Por, kur sytë t'i verbohën dhe të zihet Hëna dhe Dielli e Hëna të bashkohen, **Atë ditë** njeriu do të thotë: 'Ku të iki?'

Askund! S'ka strehë! Atë

ditë, streha është te Zoti yt.

**Atë ditë**, njeriu do të vihet në dijeni për veprat që ka bërë dhe për ato që ka lënë pa bërë. Po, vërtet që njeriu do të dëshmojë kundër vetvetes, edhe sikur të paraqesë shfajësimet e veta." (Kijame, 1-15)

"Por ju doni këtë jetë (kallimtare) e për jetën tjetër nuk kujtoheni!

**Atë ditë**, disa fytyra do të shkëlqejnë dhe Zotin e tyre do të shohin. Kurse disa fytyra, **Atë ditë**, do të jenë të zymta, duke e ditur se do të





të Na flasin duart e tyre dhe do të dëshmojnë këmbët e tyre për atë që kanë bërë." (Ja - Sin, 65)

"O besimtarë! Jepni pa u kursyer nga të mirat që ju kemi dhënë Ne, para se të vijë **Dita** (e Gjykimit) në të cilën nuk ka shitblerje, as miqësi, as ndërmjetësi! Jobesimtarët janë keqbërësit e vërtetë." (Bekare, 254)

"(Kini frikë) **Ditën**, kur çdokush do ta gjejë përpara atë që ka punuar mirë dhe atë që ka punuar keq, duke dëshiruar që midis tij dhe së keqes së tij, të ketë largësi të madhe. Allahu ju paralajmëron që t'i ruheni Vetes së Tij. Allahu është i Butë e i Mëshirshëm me robërit e Vet." (Al'Imran, 30)

"**Atë ditë** disa fytyra do të zbardhen e disa të tjera do të nxihen. Atyre që do t'u nxihet fytyra, do t'u thuhet: 'Vallë, ju mohuat pas besimit? Atëherë shijoni dënimin për shkak se nuk besuat!'" (Al'Imran, 106)

"**Atë ditë**, kur askujt nuk do t'i bëjë dobi as pasuria, as fëmijët, përveç atij që vjen me zemër të pastër tek Allahu!" (Shuara, 88-89)

"Allahu thotë: "Kjo është **Dita** në të cilën të sinqertëve u sjell dobi sinqeriteti i tyre..." (Maide, 119)

"**Atë ditë**, keqbërësve nuk do t'u bëjë dobi shfa-

pësojnë një fatkeqësi, që të thyen në mes. Por, kur shpirti të vijë në grykë e të thërrasin: 'A ka shërues', atëherë, ai (që po vdes) do të bindet se ky është çasti i ndarjes dhe këmbët do të ngrijnë.

**Atë ditë**, ai do të sillet te Zoti yt. Ai as nuk besoi dhe as nuk u fal, por e mohoi të vërtetën dhe ia ktheu kurrizin e pastaj shkoi te njerëzit e vet, duke u krenuar. Mjerë për ty! Mjerë për ty! Mjerë për ty! Mjerë për ty! Mjerë për ty!

Vallë, a mendon njeriu se do të mbetet pa përgjegjshmëri? A s'ka qenë një pikë fare që derdhej, pastaj u bë droçkë gjaku e më pas Allahu e krijoi dhe i dha formë e përmasa të caktuara, e prej tij bëri çiftin: mashkullin e femrën? Vallë, Ai Krijues, a nuk ka fuqi t'i ngjallë të vdekurit?" (Kijame, 20-40)

jësimi i tyre. Ata i pret mallkimi dhe një vendbanim i shëmtuar." (Gafir, 52)

## ATË DITË SHOKU S'DO PYESË PËR SHOKUN

"**Atë ditë** qielli do të bëhet si llumi i vajit e malet do të bëhen si lesh i shprishur. Shoku s'do të pyesë për shokun, edhe pse do të vihen të shohin njëri-tjetrin. Për të liruar veten nga dënimi i asaj dite, fajtori do të sakrifkonte me gjithë qejf fëmijët e vet, edhe gruan, edhe vëllain e vet, edhe farefisn, që i gjendej pranë (ne jetën e Tokës), si dhe të gjithë ata që gjenden në faqe të Tokës, nëse kjo do të mund ta shpëtonte. Por jo, (fajtori do të hidhet në zjarr)! Ai është zjarr flakërues, që e shkul (dhe e djeg) krejtësisht skalpin e kokës. Ai thërret këdo që (i) ka kthyer shpinën e (i) është larguar (besimit), që ka grumbulluar (pasuri) dhe e ka fshehur." (Me'arixh, 8-18)

## MJERË PËR MASHTRUESIT ATË DITË

"Mjerë për ata që hanë në peshë (dhe matje), që, kur matin për veten, e marrin masën të plotë, ndërsa, kur u matin të tjerëve me litër ose me kandar, ua pakësojnë. A nuk mendojnë ata se do të ringjallen në një Ditë të madhe, Ditën, kur të gjithë njerëzit do të dalin para Zotit të botëve? Sigurisht (që do të ringjallen), dhe Libri i punëmbropshtëve do të jetë në Sixh-xhîn! E kush do të ta shpjegojë ty se ç'është Sixh-xhîn? Është një libër i shkruar! Mjerë mohuesit **Atë ditë**, të cilët mohuan Ditën e Gjykimit! Askush nuk e mohon atë, përveç gjynahqarëve që shkelin çdo kufi e të cilët, kur u lexohen shpalljet Tona, thonë: 'Këto janë përralla të popujve të lash-të!' Nuk është ashtu! Por veprat e tyre (të këqija) ua kanë mbuluar zemrat. Nuk është ashtu! Në të vërtetë, atë ditë një vel do t'i pengojë ata që të shohin Zotin e tyre, pastaj, me siguri, do të hyjnë në Zjarrin e Xhehenemit e do t'u thuhet: 'Ja, ajo që e quanit të gënjeshtërt!' Ndërsa Libri i punëdrejtëve me siguri që do të jetë në Il-lijûn. E kush do të ta shpjegojë ty se ç'është Il-lijûn? Është një libër i shkruar! Atë e dëshmojnë të afërmit (e Allahut). Me të vërtetë, punëdrejtët do të gjenden në Xhenet, duke shikuar nga divanet. Në fytyrat e tyre do të njohësh shkëlqimin e Lumturisë. Atyre do t'u jepet të pinë musht të pastër të ruajtur mirë, fundi i të cilit është myshku. Për këtë, le të përpiqen ata që përpiqen." (Mutaffin, 1-26)



# DITA e madhe

All Riza Temel

Dita, e cila në një kuptim të ngushtë është shrehja e një pjese të caktuar kohore, me sa duket, ngaqë është mjaft e rëndësishme, në Kuranin Famëlartë përmendet me qindra herë. Në mesin e ditëve që përbëjnë rëndësi për botën tjetër, janë: Dita e gjykimit, Dita e Ahiretit, Dita e Kiametit, Dita e Ringjalljes etj.

Edhe në jetën e kësaj bote, njeriu ka ditë që përbëjnë rëndësi: dita e lindjes, dita e vdekjes, dita e takimit, dita e ndarjes, dita e fitesës, dita e humbjes etj. Sa më shumë që të kujtohen ditët e mira, aq më shumë lumturohet njeriu dhe sa më shumë që të përmenden ditët e këqija, aq më shumë mërzitet ai. Mirëpo, si gëzimi, ashtu edhe hidhërimi janë të përkohshëm. Ajo çfarë mbetet është fitesa dhe humbja, gëzimi dhe hidhërimi, që do t'i shërbejnë njeriut në botën tjetër. Ndaj dhe, që të kesh në duar fitesën që mbetet, duhet të drejtojmë të gjitha përpjekjet tona në drejtim të Ahiretit, me qëllim që të shpëtojmë nga dëmi që mbetet. Përpjekjet tona në këtë botë duhet të kenë frytet e tyre për botën tjetër.

Sipas Kuranit, secili që beson në botën tjetër duhet ta marrë seriozisht **"Ditën e Madhe"**. Pasi ajo ditë është dita në të cilën njerëzit do të dalin para Allahut që të japin llogari (K. Famëlartë, Mutaffifin, 6) **"Ditën, kur të gjithë njerëzit do të dalin para Zotit të botëve"** Pejgamberi (a.s.), e tregon në këtë mënyrë ditën e takimit me Zotin: *"Asnjëri nuk do të lëvizë nga vendi në Ditën e Kiametit, pa u pyetur se ku e ka kaluar jetën,*

*se çfarë ka bërë me dijen e tij, se ku e ka fituar dhe ku e ka harxhuar pasurinën e tij dhe se ku e ka konsumuar trupin e tij"* (Tirmidhiu, Kijamet, 1) Ajo ditë është dita kur do të shpaloset gjithçka. Është dita kur nuk do t'i bëhet padrejtësi askujt dhe dita që do veprohet me drejtësi.

**"Kush ka bërë ndonjë të mirë, qoftë sa një thërrmijë, do ta shohë atë e kush ka bërë ndonjë të keqe, qoftë sa një thërrmijë, do ta shohë atë."** (Zelzele, 7 -8)

Njeriu i mençur bën përgatitje për atë ditë të madhe; ka frikë të humbasë dhe që të mos turpërohet qëndron gjithnjë në gatishmëri. **"Frikësojuni Ditës kur askush nuk do të mund të bëjë asgjë për askënd dhe, kur prej askujt nuk do të pranohet as ndërmjetësim, as shpërblesë e as që do të ndihmoheni."** (Bekara, 48) **"Sikur keqbërësit të kishin çdo gjë që gjendet në Tokë dhe po kaq më tepër, të gjitha këto do t'i flijonin (për të shpëtuar) prej dënimit të ashpër në Ditën e Kiametit. Atëherë, do të përballen me atë që nuk e kanë llogaritur."** (Zumer, 47).

Zoti i Madhëruar është pronari i vërtetë i asaj dite, kur gjithçka që është vepruar në botë do të gjejë shpërblim.

**"Ajo është Dita, kur askush nuk do të ketë fuqi për të bërë gjë për ndonjë tjetër dhe kur pushteti do të jetë vetëm i Allahut."** (Infitar, 19) Atë ditë as pendimi, as ndjesa, as përgjërimet e as dëshirat nuk do

të vlejshme. Paraja, pasuria, posti, fama, pushteti dhe fuqia do të mbesin jashtëloje. Do të kenë vlerë vetëm një ndërgjegje e kulluar, një iman i pastër dhe një zemër e shëndoshë. **“Në Ditën, kur askujt nuk do t’i bëjë dobi as pasuria, as fëmijët, përveç atij që vjen me zemër të pastër tek Allahu!”** (Shuara, 88 - 89)

Atë ditë është e pamundur të fshehësh ndonjë gjë. Sipërfaqja e tokës dëshmon gjithçka çfarë ka mbi të. Edhe organet e njeriut bëjnë dëshmi kundër vetës së tyre. **“Sot Ne do t’ua vulosim atyre gojët e do të Na flasim duart e tyre dhe do të dëshmojnë këmbët e tyre për atë që kanë bërë.”** (Jasin, 65). Ajo ditë është aq e tmerrshme, sa edhe fëmijët i bën me thinja, porsi të moshuarit. Për të mos rënë në këtë gradë, atë ditë nuk duhet sjellë në mënyrë të papërgjegjshme si fëmijët, por në mënyrë të përgjegjshme si të rriturit.

Ato çfarë kemi shprehur deri këtu, janë disa pjesë nga Kurani dhe Suneti, që tregojnë mbi vështirësinë e asaj dite. Ka edhe pjesë të tjera nga tekstet fetare, që përshkruajnë edhe më gjerë tmerrin që do të përjetojnë femohuesit, zullumçarët dhe mëkatarët. Mirëpo, ne duhet të dimë se vetë ajo ditë nuk është kaq e vështirë, ajo çfarë e bën të vështirë atë ditë është pasoja e veprave të këqija. Pasi e njëjta ditë nuk është aq e vështirë për besimtarët dhe për vepërmirët, sërish në tekstet hyjnore bëhet e ditur:

**“Atë Ditë do të ketë fytyra rrezëllore, të qeshura e të gëzuar.”** (Abese, 38 - 39) **“Ditën (e Kiametit), kur disa fytyra do të zbardhen e disa të tjera do të nxihen. Atyre që do t’u nxihet fytyra, do t’u thuhet: ‘Vallë, ju mohuat pas besimit? Atëherë shijoni dënimin, për shkak se nuk besuat!’ Kurse ato fytyra që do të zbardhen e do të shkëlqejnë, do të jenë në mëshirën e Allahut (në Xhenet), ku do të qëndrojnë përgjithmonë.”** (Al ‘Imran, 106 - 107) **“Atë ditë, disa fytyra do të shkëlqejnë dhe Zotin e tyre do të shohin.”** (Kijame, 22 - 23)

E gjithë çështja është që atë ditë të tmerrshme ta shndërrojmë në ditë lumturie. Kjo gjë ndodh atëherë kur lëmë mënjanë kundërvënien ndaj Allahut të Madhëruar dhe kur i drejtohem Atij me ibadet. **“Thuaj: ‘Unë kurrë nuk e kundërshtoj Zotin tim, sepse i frikësohem dënimin të një Dite të Madhe’. Atë që shpëtohet nga dënimi i kësaj dite, vërtet Zoti e ka mëshiruar. Ky është shpëtimi i vërtetë.”** (Enam, 15 - 16)

Të marrësh seriozisht atë ditë, është punë vetëm e të mençurve. Kur Omeri (r.a.), kishte lexuar ajetin: **“Me**

**të vërtetë, dënimi i Zotit tënd do të ndodhë dhe askush nuk mund ta pengojë.”** (Tur, 7 - 8), kishte rënë përtokë pa ndjenja.

Ajo çfarë është e rëndësishme në një gjyq, është drejtësia. Mirëpo, sikur Zoti të vepronte ndaj njerëzve vetëm përmes drejtësisë, askush nuk do të shpëtonte nga shqetësimet e asaj dite. Ne s’kemi zgjidhje tjetër, veçse të mbështetemi në mëshirën e Tij. Bashkë me këtë, duhet të bëjmë punë të atilla, që të meritojmë mëshirën e Zotit, që të kemi fytyrë t’i kërkojmë ndihmë. Sa herë që e lexojmë suren Fatiha, themi: **“Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë.”** Kjo do të thotë që, pikësëpari, duhet ta adhurojmë njëherë, pastaj t’i kërkojmë ndihmë. Të paktën, krahu i sevapeve në peshore duhet të jetë më i rëndë sesa krahu i gjynaheve. **“Sa i përket atij, veprat e (mira të) të cilit do të rëndojnë në peshore, ai do të ketë një jetë të kënaqur (në Xhenet). E sa i përket atij, veprat e (mira të) të cilit nuk do të rëndojnë në peshore, Ai do të ketë si strehim Humnerën (e Xhehenemit).”** (Karia, 6 - 9)

Sipas disa mufessirëve, ajeti që është shpallur i fundit është: **“Si mund ta mohoni Allahun, ndërkohë që keni qenë të pajetë e Ai ju dha jetën? Pastaj Ai do t’ju bëjë të vdisni, më pas do t’ju ringjallë e, në fund, do të ktheheni tek Ai!”** (Bekara, 28). Përderisa theksohet dita e fundit edhe në ajetin e fundit të Kuranit, atëherë ne duhet patjetër të bëjmë kujdes për të gjitha fjalët dhe sjelljet

tona.

tona.

Ajo ditë nuk është e largët. Në Kuranin Famëlartë ajo shprehet me fjalën **“nesër”**. **“O besimtarë, frikësojuni Allahut dhe çdo njeri le të shikojë se ç’ka përgatitur për të nesërmen! Kijeni frikë Allahun, sepse Ai di çdo gjë që bëni ju!”** (Hashr, 18)

Ata që bëjnë mirë llogarinë e një dite të kësaj bote, duke harruar Ditën e Madhe dhe më të rëndësishme, janë në një gaflet të tmerrshëm. Zoti i Madhëruar i qorton në këtë mënyrë ata që tregohen gafilë: **“Ne sot po ju braktisim në harresë, ashtu siç e keni harruar ju takimin e kësaj dite.”** (Xhathije, 24). Natyrisht, për Zotin nuk bëhet fjalë për harresën. Atij që Zoti nuk i jep rëndësi, padyshim që ai nuk ka rëndësi. E gjithë çështja është të bëhemi njerëz, që Zoti i pëlqen dhe u jep rëndësi. Kjo gjë ndodh atëherë kur ne i kushtojmë vëmendjen e duhur Zotit dhe Ditës së Madhe.

Ata që bëjnë mirë llogarinë e një dite të kësaj bote, duke harruar Ditën e Madhe dhe më të rëndësishme, janë në një gaflet të tmerrshëm. Zoti i Madhëruar i qorton në këtë mënyrë ata që tregohen gafilë: **“Ne sot po ju braktisim në harresë, ashtu siç e keni harruar ju takimin e kësaj dite.”** (Xhathije, 24).

# Arafati

vendi ku monumentalizohet

# Tevhidi

Dr. Kerim Bulladë

Arafat është emri i malit ku qëndrojnë haxhinjtë në vakfe ditën e Arefesë. Fjala “Arafat”, nga kuptimi etimologjik, do të thotë: të dish, të njohësh, aromë e këndshme etj. Disa nga veçoritë e malit Arafat, ndër të tjera, janë: ai është vendi ku u takuan dhe u njohën Ademi me Havanë; vendi të cilit Ibrahim i kishte kuptuar menjëherë veçantinë e përshpirtshme që e karakterizonte; pikërisht në këtë vend ishte bërë edhe ndarja mes Ismailit dhe së ëmës, Haxheres dhe po aty ishte bërë edhe ritakimi i tyre.

Haxhinjtë në Arafat rrëfejnë se Allahu i Madhëruar është i vetmi Zot dhe e kuptojnë se Ai është i pavarur nga asgjë dhe gjithçka është e varur prej Tij. Aty kuptojnë po ashtu edhe paaftësinë, dobësinë dhe mjerimin e tyre dhe, si pasojë, gjyqet që kanë bërë, ngaqë kuptojnë se njeriu duhet të bëjë kujdes që të meritojë aromën e këndshme të xhenetit.<sup>1</sup>

Kur është pyetur Pejgamberi: “Si është haxhi?”, ai është përgjigjur: “Haxhi është Arafat. Ai që mbërrin Arefenë, ka mbërritur edhe haxhin.”<sup>2</sup> Ashtu siç mund të kuptohet haptazi nga hadithi, nuk mund të quhesh haxhi e as mund të quhet i përfunduar një haxh pa qëndruar në Arafat ditën e Arefesë. Qendrimi në Arafat është kushti i parë dhe kryesor. Ndaj dhe miliona njerëz nxitojnë për në Arafat, që të kryejnë siç duhet kushtin themelor të haxhit. Kështu, të gjithë së bashku bëjnë vakfe në ditën dhe kohën e përcaktuar dhe bëjnë përpjekjen maksimale të realizohet siç duhet kjo detyrë.

Arafati është vendi ku njeriu njeh veten, vendi ku kupton asgjënë dhe ku manifeston robërinë e tij ndaj Zotit me plot kënaqësi. Haxhiu qëndron në vakfe, në atë plate të sheshtë të rrethuar me gurë të mëdhenj në një rrethë kafeje të mbylltë dhe nis të reflektojë thellë mbi atë se përse dhe nga ka ardhur në këtë botë. Reflekton mbi shkakun e ekzistencës dhe se për ku po e shpie rrugëtimi që ka nisur. **“Vërtet që njeriu do të dëshmojë kundër**



**vetvetes.**<sup>3</sup> Njeriu është syri i zemrës së vet. Ky ajet duhet lexuar me shumë vëmendje. Njeriu duhet të reflektojë mbi atë se çfarë thuhet në këtë ajet.

Njeriu nuk është thjesht një materie që nuk di se çfarë bën; ai ka ndërgjegje dhe ka intelekt. Çdonjëri ndjen gjithçka që i ndodh dhe gjithçka lidhet me veten. Ai është dëshmitar i të gjitha punëve që ka bërë dhe i të gjitha sjelljeve.<sup>4</sup> Në Arafat i ka të gjitha mundësitë t'i bëjë një llogari të kaluarës dhe të tashmes së vet. Mund të hedhë një shikim thellë në ndërgjegje. Mund ta matë sinqeritetin e vet. Mund të bëjë një llogari në lidhje me atë çfarë ka bërë dhe ato çfarë mund të kishte bërë. Mendon mbi gjynahet dhe mbi të shkuarën e tij që njollosin zemrën e vet.

Arafati është vendi më i rëndësishëm ku mund të pendohet një njeri. Duke lotuar shpreh pendimin e vet. Kërkon mënyrat për t'u pastruar, për t'u kthjelluar e për t'u ndriçuar. Shkurtimisht, duke lënë mënjane të gjithë negativitetin që gjendet në ego, përpiqet të meritojë nderimin e robërisë ndaj Allahut. Digjet me vuajtjen e gjetjes dhe njohjes së vetvetes.

Arafati është vendi i barazisë. Të gjithë haxhinjtë aty janë të barabartë. Ata përjetojnë shijen e të qenit "abdullah" (robër të Zotit) në audiencë të Allahut. Tashmë, vendin e posteve, ofiqeve, gradave dhe hierarkive e ka zënë vetëm barazia. Aty ka vetëm garë mes sinqeritetit, çiltërsisë dhe modestisë. **"O njerëz! Në të vërtetë, Ne ju krijuam ju prej një mashkulli dhe një femre dhe ju bëmë popuj e fise, për ta njohur njëri-tjetrin. Më i nderuari prej jush tek Allahu është ai që i frikësohet më shumë Atij. Vërtet, Allahu është i Gjithëdijshëm dhe për Atë asgjë nuk është e fshehtë."**<sup>5</sup> Ky është revolucioni më i madh, që ka realizuar Kurani në jetën e njerëzimit. Nuk ka pasur më pas asnjë lloj formule, që të mund ta ketë ketë bërë sunduese ndonjë ide tjetër mbi këtë parim kaq universal. Të gjithë janë të barabartë në audiencën e Allahut. Ata që janë më lart në Syrin e Tij, janë vetëm ata që e respektojnë më shumë Atë dhe që frikësohen më shumë prej Tij. Në Arafat ky parim universal përjetohej më së miri. Aty është vitrina e ekspozimit të takvasë dhe respektit ndaj Allahut. Ky ekspozim i bëhet vetëm Allahut. Aty do të dalin të fituar ata që i drejtohen Atij me durim, me qëndresë dhe me sinqeritet. Aty do të jenë të suksesshëm ata që shfrytëzojnë kohën maksimalisht duke medituar, duke bërë dhikër, duke u lutur, duke u penduar dhe duke lënë mënjane gjithçka që ka të bëjë me këtë botë. Ata që do ta pranojnë si periudhën më të qetë dhe më të rehatshme, nën çadra dhe mbi rërë, ata janë të lumturit dhe atë që do ta shijojnë vërtet shpërblimin e Tij. Kurse ata që do të kërkojnë aty rehatinë e vendit nga vijnë apo të shtëpisë dhe ata që përjetojnë mërzë në zemrën e tyre, do të mbesin aty duke u munduar dhe ndoshta do të ndahen nga Arafati pa përfutur aq sa duhet, pasi haxhiu nuk ka shkuar në haxh për ta pëlqyer atë vend, por për t'u pëlqyer ai nga Zoti. Arafati është vendi ku harrohet gjithçka që ka të bëjë me këtë botë, vend në të cilin lartësohen të gjithë duatë dhe përgjërimit në Arsh. Arafat është emri i vendit ku shpirtat pastrohen nga gjynahet përmes lotëve. Fëmijët e Ademit (a.s.), bëjnë provën e mahsherit, duke u veshur me ihramin dhe duke u shkëputur nga të gjitha





diversitetet e botës. Secili përpiqet të qajë me pasion dhe emocion, të cilin e merr nga zemra e vet me përpjekjen dhe shqetësimin e përballjes me veten. Secili përpiqet që Arafatin ta bëjë dëshmitar të robërisë dhe nënshtrimit të tij. Secili është kokë më kokë me imanin dhe takvanë e vet. Secili ka hapur duart drejt mëshirës, me shpresën që të falet e të pastrohet. Njeriu, aq sa mund t'i shmanget tekave të kësaj bote, është i zgjuar, i thellë dhe i shqetësuar. Secili bën përpjekje që të arrijë në urtësinë e ajetit: **“Kur robërit e Mi (besimtarë) të pyesin për Mua, (thuaju se) Unë jam afër, i përgjigjem lutjeve të lutësit, kur ai më lutet Mua. Prandaj, le t'i përgjigjen thirrjes Sime dhe le të më besojnë Mua, për të qenë në rrugë të drejtë.”**<sup>6</sup>. Kërkon rrugët për t'iu afruar Allahut. Shpreson që të kalojë kohën më të veçantë dhe më të vyer duke bërë sakrificë nga rehatia e tij, nga ngrënia dhe pirja e tij. Duron, nuk e bën të ditur vuajtjen, nuk ankohet, ka kuptuar se gjendet përballë një provimi të madh. Kërkon të gjitha mënyrat e suksesit dhe vazhdon pritjen. Ja pra, ky është edhe një kuptim i të qenit në Arafat. Arafati nuk është zonë me liqene, nuk është një “linjë blu”, një zonë pyjore a një zonë turistike. Arafati është një vend ku matet imani, qëndresa, vendimarrja, sinqeriteti, vetëdija e besnikëria. *Vakfeja* në Arafat është një tregues i qëndrimit religjionar dhe njerëzor i haxhinjve ndaj Allahut, ndaj egos, shokëve dhe ndaj njerëzve të tjerë. *Vakfeja* në Arafat është shprehja e dashurisë në mënyrën më brilante, shprehja e respektit dhe vëllazërisë ndaj njerëzve, si dhe shprehja e sinqeritetit dhe e vendosmërisë në iman. Aty shfaqet humanizmi që gjendet tek njeriu, sakrifica dhe besnikëria. *Vakfeja* në Arafat është vendi ku është monumentalizuar *tevhidi*. Të gjithë haxhinjtë, gjenden aty nën flamurin e tevhidit, për të përfaqësuar veten e tyre, myslimanët e vendit ku jetojnë, madje të gjithë myslimanët. Që të gjithë janë mbledhur nën fjalën e shenjtë: **“La ilahe il-Allah, Muhammedur-Rasulull-llah”**: Nuk ka zot

tjetër përveç Allahut, Muhamedi është i Dërguari i Tij! Ata gjenden në “Kongresin e Tevhidit”. Ata vazhdojnë të qëndrojnë duke u përqendruar në ndjenjat, mendimet, duatë, përgjërimet, këshillat ndaj njëri-tjetrit dhe për qetësinë e të gjithë njerëzimit. *Vakfeja* në Arafat është emri i një përpjekjeje që ta kujton dhe lehtëson rrugëtimin drejt së përfundimit. Ata që besojnë se do të mbledhen në audiencën e Allahut të Madhëruar, janë emri i një qëndrese dhe pritjeje të rëndësishme të parapërgatitur. Ata që bëjnë vakfenë në Arafat me një iman dhe vetëdije të tillë, natyrisht që do të dalin fitimtarë dhe do të arrijnë në prehje shpirtërore. Ata haxhinj që mund të përmenden në këtë vend ku kanë qëndruar Resulullahu (a.s.), Ibrahimimi dhe Ademi (a.s.); ata haxhinj që duke mos pasur frikë nga autokritika e shikojnë me një sy kritik të shkuarën, të sotmen dhe të ardhmen e tyre, pikërisht për ata është dhënë sihariqi i hapjes së dyerve të mëshirës, pendimit dhe faljes. Arafati është zona ku kalon testimin. Ndaj dhe përbëjnë shumë rëndësi sinqeriteti i nijeteve dhe shpëtimi nga çdo lloj cytjeje dhe dileme. Lum për ata që gjenden aty dhe që dinë t'iu përgjigjen pyetjeve: “Përse erdhe, përse gjendesh aty, çfarë shpresojë dhe çfarë gjete?”, duke u përgjigjur: ç'nuk gjeta në emër të robërisë, të humanizmit, në emër të edukimit për nefsën, në emër të bërjes dua për nënën, babain, fëmijët, për ymetin e Muhamedit dhe për të gjithë njerëzimin! Me çfarë nuk u bëra dëshmitar në emër të njohjes së vetes dhe të kthimit në vetvete! Ç'nuk pashë në emër të arritjes së kuptimit të asgjësë sime, të egos sime të naivitetit tim!

**Shënimet: 1)** Elmallëllë, Muhammed Hamdi Jazar, Hak Dini Kur'ân Dili, İstanbul, 1971, I, 722; Ibn Manzûr, Lisânu'l-Arab, Bejrut, 1999, IX, 157. **2)** Tirmidhî, Tefsîr, 2/22; Ebû Dâvûd, Menâthik, 68; Ibn Mâxhe, Menâthik, 57; Dârimî, Menâthik, 54. **3)** Kijâmet, 14. **4)** Shih. Jazër, Muhammed Hamdi, po aty, VIII, 5479. **5)** Huxhurât, 13. **6)** Bekare, 186.

# EBU REZINI

## Sahabi i pasionuar pas diturisë

Mustafa Erish



Ebu Rezini (r.a.), ishte njëri nga sahabët e Suffes.

Ai ishte një burrë që e kishte flijuar jetën e vet për diturinë, irfan dhe dhikër për Allahun!..

Ishte një fatlum që përpëlitej për dashurinë për Allahun dhe kishte merituar komplimentet e të Dërguarit të Allahut (a.s.)!..

Ai ishte babai i Abdullah ibn Ebu Rezin (r.a.).

Nuk njihen shumë si baba dhe bir.

Nuk dihet se cili fis i përkisnin dhe nga e kishin prejardhjen.

Nuk dihet se kur dhe si ishte bërë mysliman Ebu Rezini (r.a.).

Apo se kur ishte bërë pjesë e shoqërisë Suffe.

Nuk ka shumë të dhëna për asnjërin.

Në burime të ndryshme kalojnë vetëm disa kujtime të Ebu Rezinit (r.a.), me Resulullahun (a.s.).

Njërin prej këtyre kujtimeve, Ebu Seleme ibn Abdurahman (r.a.), e raporton në këtë mënyrë:

"Një ditë, Resulullahu (a.s.), iu drejtua me këto këshilla njërit prej sahabëve të Ehli Suffes, të njohur me llagapin Ebu Rezin:

- O Ebu Rezin! Kur je vetëm, lëvize gjuhën duke thënë: Allah! Allah! Pasi përsa kohë që përmend Zotin, je sikur të jesh në namaz.

Nëse gjendesh në mesin e njerëzve (duke u përpjekur t'u shërbesh atyre), je sikur të jesh në një namaz, suret e të cilit lexohen me zë (pra, do të kesh më shumë shpërblim).

Atëherë kur njerëzit janë duke u falur natën apo duke agjëruar, përpiqu t'i këshillosh myslimanët! Kërko të mirën prej tyre! Kurrë mos e harro "Emri bil Maruf ve nehji anil munker!"

- O Ebu Rezin! Kur njerëzit shkojnë për xhihad dhe ti nuk mund të bëhesh bashkë me ta për ndonjë arsye, atëherë nisu për në xhami, që të marrësh të njëjtat sevape me ta! Që herët shko në xhami dhe përpiqu të këndosh ezanin, pa marrë ndonjë shpërblim dhe pa prituri që të vlerësohesh prej të tjerëve! Kështu vazhdo!.. (Istiab, 4/2657; Isabe, VII, 139; Hiljetul Evlija, 1/366)

Kur Ebu Rezini (r.a.), jetonte në mesin e sahabëve të Suffes, pyetjet që i ngacmonin trurin ia drejtonte me-

njëherë Resulullahut (a.s.).

Ai ishte i pasionuar pas diturisë. Përpiqej të mëson-te gjëra të reja. Një ditë pati shkuar pranë Resulullahut (a.s.) dhe i pati drejtuar këtë pyetje:

- O Resulullah! Gjatë rrugës që bëj, më duhet të kaloj pranë varrezave. A duhet të them diçka kur kaloj aty?

Resulullahu (a.s.), i dha një përgjigje të tillë:

"O Ebu Rezin! Kur të kalosh aty, duhet të thuash këto: "Esselâmu alejke yâ ehle'l-kubur! Entum selefuna ve innâ inshaallahu bikum lâhikun", që do të thotë: Selami i Allahut qoftë mbi ju, o banorë të varreve. Ju ikët para nesh. Edhe ne do të vijmë pas jush!.."

Ndërkohë, Ebu Rezini (r.a.), sërish iu drejtua Resulullahut (a.s.):

"O Resulullah! A na dëgjojnë ata ne?"

Krenaria e Gjithësisë, Resulullahu (a.s.), i ktheu këtë përgjigje:

"O Ebu Rezin! A nuk do të kishe dashur të të kthenin përgjigje aq engjëj sa numri i të vdekurve që gjenden aty?" (Isabe, 9888. Sahabe)

Në një rast, Ebu Rezini (r.a.), ato këshilla që Resulullahu (a.s.), ia drejtonte atij, i transmetoi vetë ai, në këtë mënyrë:

"Resulullahu (a.s.), m'u drejtua me këto këshilla:

- O Ebu Rezin! A do të të them veprat që bëjnë të fitosh mirësinë e kësaj bote dhe të tjetrës?

Vazhdo të qëndrosh në mexhliset e njerëzve të dhikërit!

Kur të qëndrosh vetëm, i ndarë prej tyre, përmende Allahun sa të kesh mundësi!

Dashuro për hir të Allahut! Urre për hir të Allahut!

O Ebu Rezin! A e di ti se kur një njeri nisat nga shtëpia e tij për t'i bërë vizitë një vëllai mysliman, e shoqërojnë shtatëdhjetë mijë engjëj?

Që të gjithë i bëjnë salat dhe i bëjnë dua, duke thënë:

"O Zoti ynë! Ai i bëri vizitë vëllait të tij për hatrin Tënd. Edhe Ti pranoje në rizanë Tënde!"

Nëse mund ta bësh, bëju vizitë vëllezërve tuaj, për hir të Allahut! (Hiljetul Evlija, 1/367)

# Haxhi si një mysafirhane e madhe

Dr. Veysel Akkaja

Njeriu ka ardhur nga Allahu, ai është gjithnjë me Atë dhe i është drejtuar Atij. Ky është një rrugëtim i madh. Ky rrugëtim është në trajtë vertikale. Kurse ai në jetën tonë manifestohet në qindra mijëra trajta horizontale. Brenda këtyre, haxhi është rrugëtimi horizontal, që përfaqëson më denjësisht rrugëtimin vertikal.

Në Mekë dhe në Medine shkohet fizikisht. Kurse shpirtërisht shkohet tek Allahu dhe i Dërguari i Tij. Ky është një udhëtim i shenjtë, ndryshe nga udhëtimet e tjera horizontale. Është një rrugëtim drejt dashurisë, drejt të Dashurit. Është një rrugëtim drejt ibadetit, drejt devotshmërisë.

Për të nisur një udhëtim të shenjtë, duhet një nijet me një zemër të sinqertë. Duhet të bëhet një nijet me një zemër të vetëdijshme se po viziton Qaben dhe të Zotin e Qabesë.

Për këtë udhëtim të shenjtë duhet një veshje e posaçme, që quhet "ihram". Njeriu heq rrobat dhe mbështillet me një copë, që përbëhet nga dy pjesë. Në fakt, ajo çfarë synohet me këtë praktikë simbolike, është

që të braktisim pasurinë, postin e famën që gjendet thellë tek ne dhe në vend të tyre të vishemi me rrobën e devotshmërisë. Kështu bëjmë të ditur se braktisim disa vepra që janë të lejuara kur jemi me ihram, që nuk u afrohem veprave të ndaluara dhe që i jemi kushtuar tërësisht vetëm Allahut.

Kjo është pjesë e përgatitjes për të qenë mysafirët e denjë të të Plotmëshirshmit. Nderi për mysafirin është në varësi të bujtësit që e pret. Nëse ftesa vjen nga një vend i madh, edhe mysafiri përgatitet sipas asaj. Të jesh mysafir i Allahut dhe i të Dërguarit të Allahut, është të kesh nderin, respektin dhe mirësinë më të madhe të mundshme. Sa i madh që është shpërblimi për ata që sillen sipas edukatës së mysafirit!

Mysafirllëku fillon që kur nis të dalësh nga shtëpia. Zoti i Madhëruar, çdo hap që hidhet e vlerëson me sevape, si dhe njëkohësisht i shlyen nga një gjynah.<sup>1</sup> Me çfarëdolloj mjete që të shkojë njeriu nga vendi i tij për në Qabe, ajo distancë përbën qindramijë hapa. Madje, që në rrugë Zoti e shpërblen njeriun me qindramijë sevape dhe i fal qindramijë gjynahe. Kur bëjmë





haxhin, bëhet një pastrim i tillë që, “njeriu pastrohet nga gjynahet, sikur ditën që ka lindur nga e ëma.”<sup>2</sup> dhe na jepet sihariqi se do të arrijmë pasurinë materiale dhe shpirtërore përmes begatisë së Qabes.<sup>3</sup>

Çdo ditë që kalon në Mesxhidi Haram është e vlefshme sa një jetë. Një ditë me ibadet aty, vlerësohet si njëqind mijë ditë ibadet. Kjo do të thotë: një jetë e njeriut. Ndaj dhe udhëtarët e shenjtë e investojnë kohën e tyre me ibadete, duke arritur kështu kapital të madh shpirtëror.

Haxhi është të mbështillesh me takva. Takva-ja është t’i mbështetesh Allahut dhe të ruhesh nga shirkun, gjynahu dhe madje nga gjithçka tjetër që prish identitetin islam. Është një shprehje e dashurisë dhe respektit për Allahun. Takva-ja është çelësi i të qenit njeri i kushtuar ndaj Zotit. Njerëzit që Allahu do, janë njerëzit që i janë përkushtuar Allahut. Vendet e veçanta në Mekën e Bekuar, si Qabja, kodrat Safa dhe Merve, Mina dhe Arafati, zënë një vend të veçantë në përvorjen e një haxhiu. Në ajetin kuranor thuhet kështu: “... **Ndërsa kush madhëron shenjat e fesë së Allahut, tregon përkushtimin e zemrës së tij.**” (Haxh, 32) Gjatë haxhit besimtari i kushton një vëmendje tjetër namazit, mesxhidëve, Kuranit dhe ezaneve, si pasojë e takvasë në rritje. Bukuritë që merr aty nis e i reflekton në jetë.

Përmes këtij udhëtimi, njeriu sikur ecën në tunelin e kohës. Sikur shkon drejt së shkuarës, drejt zanafillës së historisë së njerëzimit. Drejt një vendi të sigurt, që është vendi i Ademit dhe Havasë; në Mekë, sikur takohet me atmosferën shpirtërore të tyre. Ata ishin të

parët që patën bërë ibadet në Qabe. Tani, duke ndjekur prindërit e vet, erdhi në Shtëpinë e Allahut. Sikur në tunelin e kohës u takua me Shitin (a.s.), i cili pati ndërtuar Qaben. Ndërkohë që vazhdon udhëtimin, kësaj here takohet me Ibrahimin, me Ismailin dhe Haxheren. Bëhet dëshmitar i ndjenjës së mëshirës së shfaqur nga nëna jonë Haxherja, tek përpiquej të gjente ujë për të birin, Ismailin, mes kodrave Safa dhe Merve. Edhe ai vetë është gjithnjë në kërkim të ujit të jetës, për të gjetur jetën shpirtërore. Pasi të ketë bërë Sa’j-in, duke rruar kokën, tregon se ai pranon vetëm një autoritet të vërtetë: Allahun.

E përfytyron Ibrahimin pasi ka ndërtuar Qaben, të ftojë njerëzit në rrugë të drejtë. Është pikërisht ai momenti kur shpirti i tij, në mesin e shpirtave të tjerë, thotë: “Lebbejk! Iu përgjigja ftesës Tënde, ja ku jam!” I rrjedhin nëpër faqe lotët e gëzimit, që iu bë e mundur t’i përgjigjej ftesës së Tij. I bie në sy *Makami Ibrahim*. Duhet t’i dorëzohet Zotit, sikurse iu dorëzua Ibrahim. Duke falur dy rekat namaz, përforcon kështu nënshtrimin ndaj Tij. Në qoshen e Qabes vëren *Haxherul-Esvedin*. Nëse nuk ka dyndje, e puth atë, pasi është simboli i dorës së djathtë të Allahut të Madhëruar. Nëse ka dyndje, vetëm e përshëndet nga larg dhe e puth dorën e tij të djathtë... Kështu, rinovon besën e të qenit rob i Zotit.

Gjatë tavafit, lëvizjen që e nis nga *Haxherul Esvedi*, e përfundon po në të njëjtën pikë. Përjeton të vërtetën e asaj çfarë thuhet në ajetin kuranor: “**Të Allahut jemi dhe vetëm tek Ai do të kthehemi!**”. Përmes tavafit bën vetëdijësimin e të qenit nën Vëmendjen Hyjnore.



Qabja është një. Edhe ajo vazhdimisht rrotullohet përreth Njëshit. Përmes këtij rrotullimi, në mënyrë fizike bëhet e ditur se nuk ka zot tjetër përveç Allahut. Rrotullimi shtatë herë përreth Njëshit, është tregues i shkallëve të imanit të përsosur. Ndaj dhe çdo çast, nga aspekti besimor ai është gjithnjë në një progres. Nga *imani taklidi* (besimi imitues) përmirësohet drejt *imanit tahkiki* (besimi vërtetues), apo thënë ndryshe: në *imanin shuhudi* (besimi dëshmuar).

Në tunelin e kohës, kësaj here takohet me Krenarinë e Gjithësië, Resulullahun (a.s.). I kalon para syve jeta prej 53 vitesh, koha kur ka bërë betim ndaj Allahut të Madhëruar. Përpiqet të ndjejë atmosferën shpirtërore të Resulullahut (a.s.), në Qabe, në Arafat, në Muzdelife, në Mina, në malin Nur dhe në shpellën Theur. I shfaqet para syve tubimi i sahabëve në shtëpinë e Erkamit, që gjendej pranë Qabes. Zemra e tij vëren Profetin e dashur (a.s.), tek fal namaz, tek bën dua poshtë ullukut të artë në Qabe.

Papritur i manifestohet ngadhënjimi i Mekës së Resulullahut, i shfaqet duke thënë ajetin **“...E vërteta erdhi, ndërsa e pavërteta u shkatërrua...”** (Isra, 81) dhe duke shkatërruar idhujt në Qabe. Në atë çast i kujtohet se zemra e tij është Qabe. Përpiqet të gjallërojë tevhidin, duke shkatërruar idhujt e pasioneve dhe ndjenjave ephshore.

Në ato momente e shpien gjatë qendrimi me *ihram* në Arafat, *vakfe*-ja. Mendon se edhe kur të vdesë do të veshë një veshje të ngjashme. Tubimin e haxhinjve në atë shesh e mendon si tubimin në sheshin e ahiretit. Dhe kur shikon në jetë përmes dritares së ahiretit, nis të pendohet, të përgjërohet e të lutet, përse kohë e ka këtë mundësi... Pendimi është një rrefim i të metave dhe paaftësisë. Edhe Ademi qe penduar, duke thënë: **“O Zoti ynë! Ne e kemi futur veten në gjynah, pra ndaj, nëse Ti nuk na fal dhe nuk na mëshiron, ne vërtet që do të jemi nga të humburit.”** (Araf, 23)

Pas *Vakfe*-së, mbërrin në Muzdelife. Muzdelifeja është vendi i afrimit me Allahun dhe i veshjes me rrobën e dashurisë. Këtu bëhet fjalë edhe për një tjetër përgatitje. Këtu është vendi ku mblidhen gurëzat, që të gjuhet shejtani, si armiku i përbetuar i njeriut. Pasi miqësia me Allahun shprehet duke gjuajtur shejtanin.

Ndërkohë që në Mina gjuan me gurë shejtanin, i kujtohet Ibrahim dhe i biri i tij Ismaili. Asnjëri prej tyre nuk u bënë pre e mashtrimeve të shejtanit lidhur me urdhrin e Allahut mbi flijimin. Ndërkohë që shejtani jep cyjte dhe përpiqet t'i mashtrtojë ata, i shfaqet Ibrahim tek gjuan shejtanin me gurë. Ai gjuan shejtanin, por në

fakt ai po gjuan me gurë gjynahet e veta. I përforcohet vetëdija e të qenit kundër shejtanit. I kujtohet se gjatë tërë jetës i duhet të gjuajë shejtanin, që të injorjë çdo cytje që vjen prej tij dhe që duhet mbështetur Allahut.

Tashmë, Mekën e Bekuar e ka mbështjellë sinqeriteti, çiltërsia, tevhidi, nënshtrimi, dashuria dhe devotshmëria. Tashmë, zemra është pastruar tërësisht nga ndotjet.

Dhe tani vjen koha që të takohet me Resulullahun (a.s.), në Medinë. I jehon në vesh sihariqi: *“Ai që më bën vizitë pas vdekjes sime, është sikur të më ketë bërë vizitë kur isha gjallë!”*<sup>4</sup> Ndaj dhe Pejgamberit (a.s.), i bën vizitë pors i një sahab, plot respekt dhe nderim. Kur gjendet përballë me vendin *Muvaxhehur-Resul*, e përshëndet atë me selam. Sikur e dëgjon përgjigjen *“Alejkum selam!”* dhe duke i dërguar salavat, ia shpreh mallin, dashurinë dhe respektin atij.

Ndjek gjurmët e të Dërguarit të Allahut në Medinen e Përndritur. I shfaqet para syve periudha e Medines në kohët islame. Kur viziton Uhdin, kujton kujtimet e hidhura dhe se çfarë do të thotë të harrosh urdhrin e Pejgamberit (a.s.). Aty betohet për lidhjen e fortë me urdhrat e tij. Fal dy rekat namaz në Mesxhidul Kibletejn. Aty, në vendin e dy kibleve, kujton se edhe sikur t'i ndryshojë kibleja e trupit, kurrë nuk do ta ndryshojë kiblen e zemrës, që është vetëm i Vërteti. Duke bërë vizitë në xhaminë Kuba, rifreskon vetëdijen e ndërtimit të xhamive me bazë devotshmërinë. Madje, sipas sufiëve, trupi është xhami, ndaj dhe trupin duhet ndërtuar gjithnjë me bazë devotshmërinë. U bën vizitë edhe vendeve ku është zhvilluar beteja e Hendekut, aty kujton sesi iu dhurua triumfi myslimanëve pas një beteje tejet të vështirë.

Haxhi është një shkollë më vete. Ai haxhi që përfundon me sukses këtë shkollë, kthehet me një identitet krejtësisht të ri. Në Qabe ka përjetuar pjesën e parë të Fjalës së Njësisë: *“La ilahe il-Allah!”* Kurse në Medinë shijon *“Muhammedun Resulullah!”* Porsi sahabët, u mbush me bukuritë e Islamit. U mbështoll me veçoritë e myslimanit të devotshëm. U dogj me dashurinë për Allahun dhe të Dërguarin e Tij. Kuranin dhe namazin e bëri boshtin e jetës së vet. U kthye në vendin e vet porsi një delegat i miqve e të afërmve të tij. Dhurata më e çmueshme e tij për ata është të manifestojë gjatë tërë jetës së vet bukuritë shpirtërore që ka fituar nga ajo përvojë e mrekullueshme.

**Shënime:** 1) Ibn Hibban, Musned, nr. 1884. 2) Shih. Buhârî, Haxh, 4. 3) Shih. Nesaî, Meârnasik 6; Ahmed b. Hanbel, I, 25. 4) Dârekutnî, Sunen, II, 278.

# Kush është i suksesshmi



Nuredin Jëlldëz

Le t'i kthejmë një përgjigje pyetjes: "Kush është i suksesshmi?", pa e lokalizuar medoemos me fjalët "në dynja" apo "në ahiret", pra, le t'i fusim në një qese dynjanë dhe ahiretin dhe duke bërë një analizë mes dynjasë dhe ahiretit, le t'i përgjigjemi pyetjes: "Kush është i suksesshmi?", meqë i njëjti njeri do t'i përjetojë të dyja. Nuk mund të jesh i mjerë në dynja e i shenjtë në ahiret, sepse mjerimi në dynja nuk duhet të matet me një masë matëse të urisë, shqetësimit dhe varfërisë. Nëse një njeri e ka fituar ahiretin, atëherë, edhe sikur të ketë një të shkuar duke u kacafytur me shqetësimet dhe me skamjen e "dynjasë" së tij, sidoqoftë ajo, kjo do të thotë se ai nuk ka jetuar në një botë mjerane. Përkundrazi, dynjaja e tij është një dynja konstruktive, një dynja ndërtuese. Është një dynja që ndërton ahiretin. Ndonëse ka përfunduar me vdekje, sido që të jetë, nuk ka si të jetë një dynja e mjeruar.

Kur i hedhim një sy, duke i parë si të ndërlidhura dynjanë me ahiretin, njeriu i vetëm që suksesin e ka të garantuar është ai që Allahu ka rezervuar për të suksesin. Njeriu që ka merituar suksesin e Allahut, është ai njeri që i është bërë i dashur imani dhe ibadeti dhe që i është bërë i urryeshëm femohimi dhe gjynahu. Është ai që ka frikë nga kundërvënia ndaj fesë si frika nga zjarri. Sa e sa njerëz jetuan në këtë mënyrë të suksesshme, me në krye sahabët besnikë... E braktisën këtë botë, duke e shijuar ngopjen me këtë lumturi. As varfëria, as uria e as vuajtjet nuk ndikuan negativisht në lumturinë e tyre.

Sipas qasjes që konsideron bashkë dynjanë me ahiretin, sekret i suksesit është adhurimi i Allahut. Ndaj dhe vetë sukcesi përherë ka qenë një dhunti që është kërkuar vetëm nga Allahu. Ai bën të suksesshëm atë që Ai vetë dëshiron. Dhe ai bëhet i suksesshëm në iman, në ibadet, në sjellje, në ide e në qasjen ndaj jetës.

Një njeri i suksesshëm, kur fillon të bëhet i zoti i një posti, atë post nuk e kthen në objektivin final të vetes së vet. Ai njeri; si veten, po ashtu edhe postin e tij e konsideron se nuk është gjë tjetër veçse një mundësi kalimtare. Ai i mbështetet Allahut që të mos ia dhurojë ndonjë post që e bën të harrojë se është rob i Zotit.

Përkundrazi, postin mbi të cilin është ulur dhe gradat e tij i përdor në shërbim të kauzës së madhe. Pasurinë që ka në dorë e përdor si pasuri dhe nuk bëhet pre e saj; nuk e shkatërron veten e vet për shkak të pasurisë; pra, nuk e prish personalitetin e tij. Nuk e pengon veten që ta harxhojë në rrugë të Allahut pasurinë që fiton përmes hallallit. Si pasuria e tij, ashtu edhe ai vetë janë në shërbim të Zotit. Kur ai krijon një familje edhe familja e tij bëhet një oxhak për fenë e tij.

Njeriu i suksesshëm është ai që arrin të jetojë brenda trekëndëshit: mirënjohje, durim dhe pendim. Nëse vjen ndonjë dhunti nga Allahu, e falënderon Atë dhe përmes falënderimit çel dyert e suksesit. Nëse i vjen ndonjë sprovë nga Allahu, duron. Durimi do t'i japë atij kodin e lumturisë. Nëse bën ndonjë gabim, si pjesë e natyrës së njeriut, menjëherë pendohet. Pendimi do ta shpjerë në një gjendje të kulluar. Në çdo situatë që të jetë, ai është i fituar. Pasi nuk ka humbje, sepse, si pasojë e përpjekjes që tregon dhe qëllimit që ka synuar, është i suksesshëm.

Për njeriun e suksesshëm Allahu ka dëshiruar mbarësi. Kjo mbarësi i shfaqet në fytyrën e tij. Njerëzit kujtojnë vetëm gjëra të bukura për të. Ai bëhet shkak vetëm për mbarësi, bëhet çelësi dhe ura e mbarësisë.

Një njeri që i është përkushtuar mirësisë, nuk mund të dalë në pension në mirësi. Edhe në fundin e jetës së tij bëhet mjet për mbarësi. Edhe në vdekje bëhet shkak për një vepër të mbarë. Edhe në veprat që duken të vogla, ka bukuri të mëdha. Edhe sikur të mos bëjë asgjë, së paku mendon mirësinë, mbushet plot shpresë. Ai është një tip që bën pak, por fiton shumë, pasi është i sinqertë në atë që bën; sinqeriteti është busulla e tij.

Njeriu që Allahu e bën të suksesshëm, që ka zemrën plot emocion; ndonëse nuk i mbajnë këmbët, është i gatshëm të ecë; ndonëse nuk i sillet gjuha, mund të flasë me fytyrën e tij. Zemrën e ka të hapur drejt Zotit të vet. Pikërisht ky njeri është njeriu që Zoti nuk e lë vetëm. Në ditën dhe natën e tij ekziston një tjetër harmoni. Ai ka sy që dritësojnë natën, ka mprehtësi që lexohet në sy. Kë ndjek ai dhe se ku do të shkojë, është më se e qartë.

Ai është i suksesshmi, ai është fitimtari.



Xhafer Durmush

# Përse është i rëndësishëm

# Tevekkuli

Tevekkuli në fjalor kalon në këtë mënyrë: *"T'ia lësh në dorë Allahut pasojën, pasi t'u kesh bërë ndërmjetësim shkaqeve. Të jesh i kënaqur me atë çfarë të vjen nga Allahu. Të kërkosh nga Allahu mbarësinë e përfundimeve, pasi të bësh detyrat që të bien përsipër. Të jesh i kënaqur me atë çfarë të ka përcaktuar Zoti dhe t'i besosh Zotit."*

Në Kuranin Famëlartë gjenden plot ajete që nxisin veshjen e besimtarëve me parzmoren e tevekkulit. Në njërin prej tyre, në suren Teube ajeti 51, thuhet kështu:

**Thuaj: "Do të na godasë vetëm ajo që na ka caktuar Allahu; Ai është Mbrojtësi ynë dhe vetëm tek Allahu le të mbështeten besimtarët!"**

**Hamdi Jazëri** e komenton në këtë mënyrë këtë ajet që u shpall gjatë ngjarjeve që u zhvilluan në kohën e Betejës së Tebukut: *"Nuk na ndodh asgjë përveç asaj çfarë Allahu ka shkruar për ne. Të hidhura apo të këndshme qofshin, gjithçka çfarë përjetojmë janë brenda Planit Hyjnor dhe asgjë nuk është në dorën e dikujt tjetër, përveçse në Dorën e Tij. Sidoqoftë, gjithçka çfarë ndodh është në favorin tonë; si në dynja ashtu edhe në ahiret është vetëm për mirësinë tonë. Pasi Ai është Zoti ynë, Ndihmëtari ynë. Ai është Krijuesi që i kemi bërë tevekkul përmes besimit ndaj Tij mbi mbarësinë e veprave tona. Ai vepron mbi ne çfarëdo që dëshiron dhe çfarëdo që Ai vepron, realizohet vetëm për të mirën tonë. Ai për ne është më parësor se gjithçka në këtë jetë."*

Kështu që besimtarët le t'i besojnë dhe t'i dorëzojnë vetëm Atij. Duhet besuar Atij duke qenë të bindur se e gjithë fuqia dhe pushteti gjenden vetëm tek Ai. T'i dorëzohen dhe ta pranojnë me dëshirën e tyre atë çfarë ka planifikuar Ai për ta dhe të vazhdojnë de-

tyrën e tyre siç duhet. Pasi, sa më shumë që i bëhet tevekkul Allahut dhe i besohet Atij, sadoqoftë, Ai pa dyshim meriton edhe më shumë dhe nuk ka pikë tjetër që duhet besuar dhe mbështetur përveç Tij. Ata që e mohojnë, ngaqë nuk e dinë këtë të vërtetë, mendojnë se vetja e tyre ka fuqi dhe siguri aq sa t'i mbështeten. Ndaj dhe mburren duke thënë: *"E morëm vetë në dorë punën tonë."* Kështu shfaqen sikur secili prej tyre është i zoti i punës së vet. Mirëpo, ata në fakt nuk bëjnë gjë tjetër përveçse përpiqen të marrin diçka nga hyjnorja. Ndaj dhe jeta u kalon në hipokrizi dhe në polemikë të vazhdueshme. Një tendencë e tillë nuk është asgjë tjetër veçse një vegim shëmtaraq. Femohuesit që mburren duke i besuar vetes së tyre, si përfundim do ta humbasin këtë besim atëherë kur të dështojnë përballë ngjarjeve të jetës. Vetëm besimtarët që nuk i bëjnë tevekkul asgjëje tjetër, përveç Allahut, duke mos pasur frikë as nga vdekja, mbërrijnë te Zoti me besim të plotësuar.

Nuk duhet harruar kjo:

Tevekkuli nuk është t'ia transferosh Allahut punën që duhet të bësh ti, por të jesh i kënaqur me përfundimin e përcaktimit të Tij, që do të ndodhë pasi të kesh bërë detyrën tënde. Tevekkuli nuk është të mos marrësh masa ndaj asaj që të bie përsipër, sikurse e mendojnë disa nga padituria. Tevekkuli është besimi me siguritë të plotë tek ajo se çfarë Allahu i Madhëruar ka parë të arsyeshme të bëhet, bëhet me qëllim që të ndikojë pozitivisht në dynjanë dhe ahiretin e njeriut dhe ato çfarë nuk ka parë të arsyeshme, ndikojnë negativisht në dynja dhe ahiret. Iman është të besosh se nuk ka asgjë tjetër më të fuqishëm dhe më të pushtetshëm se Zoti. Në këtë kontekst, tevekkuli nuk është një gjendje që bie ndesh me punën e bërë

për të përfituar shkaqet që ka përcaktuar Allahu i Madhëruar. Ndaj dhe në ajetin kuranor thuhet: **"...dhe do t'i japë risk prej nga nuk e pret. Allahu i mjafton kujt do që mbështetet tek Ai. Allahu e përmbush me siguri vendimin e Tij dhe për çdo gjë Ai ka caktuar masë."** (Talak, 3)

Zoti i Madhëruar, duke thënë: **"Vërtet, Allahu i do ata që mbështeten tek Ai."** (Al 'Imran, 159), njerëzve të tevekkulit u jep sihariqin se do të kenë dashurinë e Allahut dhe lidhur me këtë i siguron besimtarët duke thënë: **"Allahu i mjafton kujt do që mbështetet tek Ai."** (Talak, 3). Sipas asaj çfarë ka përcjellë Ibn Abbasi (r.a.), Pejgamberi ynë (a.s.), ka thënë: **"Ai që dëshiron të bëhet njeriu më i fortë në mesin e njerëzve, le t'i bëjë tevekkul Allahut!"** (Ibn Ebud-Dunja, Tevekkul, 9.) dhe në duatë e tij përgjerohej duke thënë: **"Allahu im! Më bëj mua prej atyre njerëzve që të bëjnë tevekkul Ty dhe që mjaftohen me Ty!"** (Ibn Ebud-Dunja, Tevekkul, 4.)

Përgjigjen e pyetjes: "Përse është i rëndësishëm tevekkuli?", mund ta japim në këtë mënyrë: tevekkuli është një komponent plotësues i imanit. Për një besimtar do të ishte një minus i madh të mos ia dinte

kuptimin tevekkulit apo të mos e brendësonte si një kusht të domosdoshëm të imanit. Aq sa gabim dhe mangësi do të ishte sikur tevekkuli të artikulohej, pa ia kryer kushtet që bëjnë të realizohen një punë, po aq gabim dhe mangësi do të ishte sikur të ndërmerren përpjekje që shfaqin mospajtimin me përfundimin që është realizuar me vullnetin e Allahut.

**I nderuari Ibrahim Hakkiu**, në veprën e vyer të tij "Marifetname", i ka kushtuar një hapësirë të gjerë tevekkulit të plotë. Ai bën shpjegimet e duhura, përmes ajeteve kuranore, haditheve dhe fjalëve të urta të evliljave, për të shpjeguar tevekkulin e plotë. Ai thotë: **"Tevekkuli nuk është as të nxitosh me ambicie pas fitesës e as të braktisësh punën. Përkundrazi, tevekkul është të ndihesh në audiencë të Zotit të Madhëruar dhe të lidhësh zemrën me Të. Tevekkuli është një e fshehtë sublime mes robit dhe Zotit..."**

Ne duhet që, për bindjen e zemrës dhe për gjykimin e botës së brendshme, fillimisht të mund të zëmë vend në limanin e tevekkulit dhe t'ia fillojmë çdo punë me qetësinë që marrim aty.



Lexo  
Mendo

## Një qortim i rëndësishëm nga Kurani



Në Kuranin Famëlartë thuhet kështu: **"Mos i shani idhujt që ata i adhurojnë në vend të Allahut, në mënyrë që ata të mos e shajnë Allahun armiqësisht nga padija."** (En'am, 108)

Edhe **Ruhul-Bejan** thotë: "Mos shani idhujt që ata bëjnë ibadet, duke thënë: 'Allahu ju mallkoftë ju dhe ato që ju adhuroni!', që as ata të mos shajnë Allahun, si reaksion ndaj fjalëve tuaja, që të mësojnë sesi duhet përmendur Allahu i Madhëruar."

**I ndjeri Hamdi Jazari**, thotë: "Nuk është virtyt të flasësh duke sharë. Ndaj dhe, ndonëse duke pasur justifikim, të nënçmoh duke poshtëruar të gabuarën dhe femohimin. Kështu që, duhet bërë kujdes të mos bëhen sjellje që nxisin të shtohet femohimi." Thuajse në të gjithë librat e fikhut, pa dashur të detajohemi, është krijuar një formulë e tillë: **"Sharja është pjesë e fjalorit të femohimit."**


Një qasje e tillë ndaj vlerave të tilla të respektuara ndikon në ndjenjat e bashkëbiseduesit dhe bën efekt të kundërt dhe ndoshta bëhet shkak të largohet nga ju dhe nga klima e këndshme e Islamit.



M. Sami Ramazanollu

# Haxhi

## sipas rregullave



Resulullahu (a.s.), ka thënë:

*"Kush bën haxh për hir të Allahut, nëse nuk bën as refes e as fisk, kthehet (në vendin e tij, në shtëpinë e tij) i pastër dhe pa gjynahe, si ditën që ka lindur nga nëna e tij." (Buhariu)*

Kuptimi i **refes**-it është marrëdhënia seksuale, të biesh pre e çfarëdolloj gjëje epshore dhe të thuash fjalë të shëmtuara. Kurse **fisk**-u është të bësh gjynah, të ngatërrohesh; pra të dalësh nga kufijtë dhe nga kontrolli në sjellje dhe situata të ndryshme. Këto janë gjynahe, që bëhen pengesë të pranohet haxhi.

\*\*\*

*"Çdo umre është kompensuese e gjynaheve të bëra deri në umren e mëparshme. Haxhi i pranuar, pra haxhi që është bërë për të shpëtuar nga gjynahet dhe haxhi i bërë vetëm për hir të Allahut, ka vetëm një shpërblim: Xhenetin." (Buhariu, Muslimi)*

Umreja është vizita që bëhet në Qabe jashtë ditëve të caktuara për haxhin.

\*\*\*

*"Bëjini njëri pas tjetrit edhe haxhin, edhe umren, pasi këto, ashtu sikurse gjyryku heq të ndoturën nga hekuri, floriri dhe argjendi, po ashtu edhe umreja me haxhin heqin gjynahet dhe varfërinë nga besimtari. Nuk ka shpërblim tjetër përveç xhenetit për një haxh të pranuar. Pra, shpërblimi për të është vetëm xheneti." (Ahmed bin Hanbel, Tirmidhiu.)*

Sipas asaj çfarë ka përcjellë **Ibn Omeri**, radijAllahu anhu, të transmetuar nga **Darekutniu** dhe **Taberiu**, nëse haxhi dhe umreja bëhen njëra pas tjetrës, shtohet edhe jeta edhe furnizimi i Allahut për besimtarin.

\*\*\*

**Ebu Hurejra**, (r.a.), ka thënë:

Resulullahu, (a.s.), na tha:

*"O njerëz! Allahu ka obliguar për ju haxhin. Atëherë, bëni haxh." Një i pranishëm, u drejtua duke pyetur të Dërguarin e Allahut:*

*"O Resulullah! Çdo vit duhet ta bëjmë këtë?" I Dërguari i Allahut (a.s.), heshti. Por, kur personi në fjalë e përsëriti këtë pyetje tri herë, atëherë Resulullahu (a.s.), u përgjigj:*

*"Sikur të thosha 'po', atëherë çdo vit do të ishte obliguar. Dhe ju natyrshëm, nuk do të mund ta kryenit këtë gjë." Pastaj shtoi edhe këto:*

*"Për sa kohë që unë të kem hequr dorë nga urdhrat dhe ndalesat, edhe ju hiqni dorë nga pyetjet e panevojshme. Popujt para jush u shkatërruan, ngaqë bënin pyetje të tilla të padobishme dhe, ngaqë binin në dilema të ndryshme. Kësisoj, nëse unë ju urdhëroj diçka, ju atëherë duhet të përpiqeni ta realizoni aq sa keni mundësi. Si dhe, nëse ua ndaloj diçka, braktiseni atë" (Ahmed bin Hanbel)*

**"Me të vërtetë, Faltorja e parë e ngritur për njerëzit, është ajo në Bekkë (Mekë), e bekuar dhe udhërrëfyese për popujt." (Al 'Imran, 96)**

Sipas asaj çfarë shpjegohet në një hadith të përcjellur nga **Ebu Dheri** (r.a.), të raportuar nga **Buhariu** dhe **Muslimi**, qëllimi i haxhit është Qabja e Madhërueshme. Ajo shtëpi është më e vjetër se Mesxhidi Aksa. Ajo është faltorja më e lashtë e gjithë botës.



# Puno!

Abdulkadir Gejlaniu ka thënë:

“Puno e përpiqu, pa punuar e pa u përjekur nuk shkohet gjekundi. As në shkallët shpirtërore nuk mund të hedhësh hapa. Padyshim që duhet të punosh dhe të përpiqesh që të futesh sa më thellë në rrugë të Allahut. Mblidhe të gjithë forcën, energjinë dhe përpjekjen dhe shfaq! Atëherë ty do të të vij në mbarësitë. Kush përpiqet të kërkojë, padyshim që do të gjejë. Gjithnjë përpiqu të hash kafshatën hallall. Padyshim që kafshata prej hallallit të ndriçon zemrën tënde. Të ndriçon shpirtin tënd. Dhe t’i nxjerr ato nga errësira në dritë. Angazhohu me to, mos u merr me cytjet e tyre.”

Ndërkohë, Abdulkadir Gejlaniu e pati pyetur njëri që ishte i pranishëm aty:

“Cili është ilaçi për këtë? Cila është mënyra e zgjidhjes së këtij problemi?”

Abdulkadir Gejlaniu i qe përgjigjur:

“Ilaçi i parë dhe më kryesori është mospërzierja e haramit me kafshatën e hallallit. Të mos përziësh gjëra të dyshimta. Të ushqehesh me fitesë hallalli. Kurse e dyta është të mos bësh gjërat që Allahu i ka ndaluar.”

Resulullahu, (a.s.), ka thënë:

“Nëse një njeri nuk e vret mendjen se çfarë po ha dhe çfarë po pi, atëherë as Allahu nuk do e vrasë mendjen se nga cila derë e xhehenemit do ta fusë.”

Abdulkadir Gejlaniu ka thënë:

“Duhet ngrënë nga hallalli, duhet pirë nga hallalli

dhe, edhe pakica e hallallit është e mjaftueshme. Pasi atëherë bëhet ibadet me një prehje shpirtërore. Hallalli është nur mbi nur. Harami është ndyrësi-rë mbi ndyrësi-rë. Edhe hallalli duhet ngrënë sipas rregullave që ka vendosur Allahu. Përndryshe, është shpërdorim (israf).” (Nga “Fet’hul-gajb”)

Ibrahim Dursuki ka thënë:

“E dini ç’do të thotë të ushqehesh me haram? Do të thotë të ndalësh veprat e mira, t’u japësh fund atyre. Pasi harami bëhet pengesë që veprat e mira të ngjiten lart. Kurse zotëruesin e haramit e bën të zvogëlohet nga aspekti fetar.”

Veçanërisht duhet ruajtur nga ushqimet haram. Nuk ka asnjë rezultat tjetër përveç shkatërrimit për ata që ushqehen me haram.

Të ulesh e të ngrihesh pranë njerëzve që i ka zënë sëmundja e gjynahut, madje vetëm t’u gjendesh pranë atyre, bën që të pengojë suksesin dhe mendjemprehtësinë.

Në “Tabakatul-Kubra” thuhet:

“Njerëzit që Allahu do më shumë janë ata që janë të pastër në zemër... Ata që ruajnë nderin e tyre... Ata që ruajnë gjuhën nga e keqja... Ata që ruajnë dorën që të mos zgjatet tek e keqja... Ata që janë më me ndershmëri dhe ata që pëlqejnë të falin... Si dhe ata që nxitojnë të bëjnë mirësi dhe dhurata.”

Abdullah bin Mubarek ka thënë:

“Refuzimi i një dirhemi të vetëm, vetëm pse është përzier dyshimi, për mua është më i dashur sesa të ndaj sadaka gjashtë milion dirhemë.”

# Përse dubet lavdëruar Allahu?



Allahu i Madhëruar në shumë ajete të Kuranin Famëlartë ka lëvduar veten, pasi Allahu i Lartmadhëruar është ai që meriton më së shumti lavdinë. Ndaj dhe besimtarët duhet ta falënderojnë dhe lëvdojnë Allahun e Madhëruar në çdo kohë dhe në çdo vend. Në shumë hadithe, Resulullahu, (a.s.), na ka urdhëruar ta falënderojmë dhe na ka mësuar se si t'i bëjmë lëvdata Zotit Fuqiptotë. Nëse një besimtar rigoroz i bën lëvdata Allahut dhe e falënderon vazhdimisht Atë dhe këtë e bën si një parim jetik dhe si një kusht të patjetërsueshëm, ai do të jetë pjesë e "hamid-ëve" që përmenden në hadithe, pra do të bëjë pjesë në grupin e njerëzve që falënderojnë shumë Allahun dhe të atyre fatlumëve që kanë mbërritur në lumturinë e të dy botëve.

Këtu duhet shtruar kjo pyetje: Vallë, përse Allahu i Madhëruar kërkon prej nesh që ta falënderojmë dhe t'i thurim lëvdata në mënyrë të vazhdueshme? Sikur, meqë kërkon prej nesh në mënyrë këmbëngulëse, Ai -hasha!- të ketë nevojë për këto falenderime dhe lëvdata. Ky hadith na ndriçon mbi këtë çështje: Imam Buhariu, lidhur me tefsirin e ajetit 151 të sures En'am "**... Mos iu afrohuni veprave të turpshme, qofshin ato të hapëta apo të fshehta...**", ka thënë:

Sipas asaj çfarë transmeton Abdullah bin Mesudi, (r.a.), Resulullahu, (a.s.), ka thënë: "*Besimtarët nuk i ruan askush tjetër përveç Allahut. Ngaqë Allahu i Madhëruar është mbrojtësi më i madh, ka ndaluar çdo vepër të shëmtuar, të fshehur apo të hapur dhe askush tjetër përveç Allahut nuk do falënderime dhe lëvdata. Ndaj dhe Zoti i Madhëruar ka lëvduar veten.*" (Buhariu, Kitabut-Tefsir). I ndjeri Kamil Mirasi, gjatë analizës që po i bënte hadithit të sapocituar të vepërës së përkthyer "Texhridi Salih", e kishte shpjeguar në këtë mënyrë: Dëshira që ka Allahu të lëvdohet, e cila përmendet në pjesën e dytë të hadithit, nuk është në kuptimin e lëvdatës që bën njeriu për njeriun, pra nuk ka të bëjë me një nevojë a interes që mund të na shkojë ndërmend. Përkundrazi, dëshira që Allahu ka të lëvdohet a falënderohet lidhet me sevapet dhe shpërblimet që mund të marrë një njeri, nëse i bën këto sipas një rregulli të caktuar. Ndaj dhe Allahu në Kuran e ka përr-

mendur veten me emra të bukur, Semi, Basir etj. dhe me fjalë lartësuese "elhamdulillah" apo "Allahu ekber", që njerëzit që i drejtohen me lutje përmes këtyre cilësive, të fitojnë sevape dhe mirësi.

Nga ky sqarim kuptohet: Lëvdata që i bën Allahu i Madhëruar vetes së vet, në fakt s'është gjë tjetër veçse një mjet mëshire dhe faljeje për ne, robërit e Tij. Sërisht në komentin e të njëjtit hadith, të bërë nga komentatori i madh i Buhariut, Bedreddin Ajni, rahimehull-llah, në veprën e mrekullueshme të tij "Umdetul Kari", bën të ditur se fjala që kalon në hadith është "xheloz" dhe kjo xheloz është pikërisht simpatia e shumtë dhe mëshira që Allahu ka për robërit e Tij. Allahu i Madhëruar na do aq shumë, saqë na mbron nga veprat e këqija duke mos dëshiruar të përfitojmë ndonjë dënim, që si pasojë të hyjmë në xhehenem. Pra, Ai duke na mbështjellë me dashurinë dhe mëshirën e Tij, na ruan nga çdo e keqe. Kështu, duke na bërë njerëz të përkushtuar ndaj Tij, thuajse na xhelozon.

Një tjetër manifestim i kësaj dashurie dhe xhelozie të Allahut ndaj njerëzve të Vet, është edhe falënderimi dhe lavdia që i bëhet Atij. Përsëri nën dritën e shpjegimeve të Ajniut, rahimehull-llah, Allahu i do aq shumë njerëzit e Vet dhe i xhelozon aq shumë, saqë kërkon që të gjithë ato lëvdata të vërteta t'i drejtohen vetëm Atij. Kështu, Ai do t'i shpërblejë njerëzit e vet kundrejt lëvdatave që njerëzit ia drejtojnë Atij.

Si përfundim, lidhja mes njeriut dhe Allahut, ashtu siç shpjegohet edhe në hadith, është me qendër dashurinë dhe pëlqimin. Njeriu duhet të ndjejë aq shumë dashuri për Allahun, saqë duhet ta përmendë në çdo çast Atë dhe t'i bëjë lëvdata. I gjithë synimi i tij duhet të jetë që të arrijë të meritojë pëlqimin e Allahut të Madhëruar, duke kaluar një jetë të tërë në rrugën e Tij. Pasi ai e di se njeriu që është pëlqyer nga Allahu i Madhëruar, do të arrijë të ketë një nefis "mutmain". Ashtu siç bëhet e ditur edhe në ajet, për miqtë e Allahut nuk ka as frikë e as dëshpërim, pasi ata janë njerëzit e veçantë që do Allahu i Lartmadhëruar.



# Përballë fëmijërisë sonë

Mehmet Dinç

Edhe ne dikur ishim fëmijë. Edhe ne kishim një periudhë të pastër në të cilën mendjen nuk e kishim të zënë me dituri të panevojshme e as zemrën të mbushur me urrejtje e paragjykime të pavend. As ne nuk e kuptonim se përse paraja, një copë letër, kishte vlerë më shumë se sa akullorja dhe as që e kuptonim se përse njerëzit vraponin pas asaj copë letre dhe jo pas lodrave.

Edhe ne dikur dëgjonim këngët e shiut dhe blegërimat e qengjave. Edhe ne dikur kishim ditë që ngazellenin shpirtin dhe preknim flokët e dëborës plot kënaqësi. Edhe ne kemi jetuar kohët kur pranverat ishin hare, çdo dimër ishte gëzim dhe verat ishin të qeshura. Kishim çaste aq emocionale kur merrnim karamelet fshehurazi... Por ja që kaluan ato vite të mrekullueshme. Tashmë jemi rritur.

Sa më shumë që jemi rritur, aq më shumë na është zvogëluar zemra. Dikur, në fëmijërinë tonë, ishim të buzëqeshur, mirëprisnim të gjithë, e donim aq shumë edhe fqinjën xhaxhi Qemalin, me huqet e të cilit qeshnim gjithmonë, porse ai vazhdimisht nxehej prej nesh; sot s'po mund t'i mbajmë në zemër një grusht njerëzish, që i kemi pakësuar pas shumë e shumë filtrash që u kemi bërë. Më parë, qeshnim me gjithë shpirt, kurse tani qeshja me vështirësi vërehet në buzët tona. Veçanërisht gëzimi, sikur është bërë diçka tepër e largët për ne dhe shumë e mundimshme për t'u arritur. Tashmë, as që mund të marrim kënaqësi duke vrapuar pas një fluturë dhe as kur blejmë këpucët e reja. Sikur diçka gabimisht (!), të na lumturojë për pak çaste, përmendemi menjëherë, kontrollojmë të shqetësuar nëse e kanë kuptuar apo jo shkakun e lumturisë sonë dhe sërish vendosim atë çehren e vrenjtur në fytyrë dhe përpiqemi të mos e bëjmë shumë të ditur lumturinë tonë.

Ne u rritëm, ndërkohë ëndërrimet tona u venitën. Më parë dëshironim të bëheshim ushtarë, që me disa

plumba mendonim se do të shpëtonim rruzullin tokësor; të vendosur që do të ngopnim të gjithë të uriturit apo të bëheshim mjekë, që të gjenim ilaçin e të gjitha sëmundjeve vdekjeprurëse. Ndërkohë që kur ishim të vegjël, i patëm dhënë fjalën vetes që nuk do të silleshim me fëmijët tanë e as që do t'u themi fjalë lënduese, siç bënin prindërit tanë me ne. Ja që u rritëm dhe u bëmë nga një kopje identike e prindërve tanë dhe po ato sjellje që nuk pëlqenim prej tyre kishim filluar t'i bënim vetë; ato fjalë prej të cilave lëndohehim, pikërisht ato nisëm të përdornim edhe ne. Kur babai mërziste nënën, apo kur nëna mërziste babain, unë mendoja me vete: "kurrë nuk do ta mërzis bashkëshorten time në sytë e fëmijëve", mirëpo po atë sjellje po bëjmë edhe ne.

Pa mendoni sikur fëmijëria juaj është ulur aty përballë jush dhe po ju kërkon llogari. Do që të dijë gjithçka rreth jush; me kë jeni martuar, sa fëmijë keni, si i keni marrëdhëniet me gruan dhe fëmijët, çfarë pune po bëni, si po e kaloni jetën, si e shfrytëzoni kohën e lirë etj. A do të mund t'i ktheni përgjigje pa pikë problemi dhe pa ju nxirë fytyra? Po sikur të nisë t'ju pyesë për ëndërrimet tuaja, duke e ditur se cilat ishin aspiratat tuaja që në fëmijëri, a do të mund t'i kthenit përgjigje pa u mërzitur dhe pa u shqetësuar, megjithëse çdo ditë që kalon po ju veniten ëndërrat?

Jeta ndryshon për aq kohë sa njeriu jeton. Ndaj dhe kurrë mos thoni ka ikur ajo kohë. Për sa kohë që ju mund të jepni llogari me qetësinë më të plotë para fëmijërisë suaj, përpiquni që jetën tuaj ta rregulloni, nëse është e nevojshme edhe ta ndryshoni. Punoni që fëmijëria juaj, e cila para shumë vitesh ju bënte të lumtur sikur të kishit pirë një eliksir gëzimi, sot ajo t'ju drejtojë në rrugët e lumturisë.

# Vetëdija e miqësisë

Sabahudin Tyzyn

Thuhet se Zoti i Madhëruar i qe drejtuar Musait (a.s.), në këtë mënyrë: **“O Musa! Çfarë ke bërë për mua?”** Dhe Musai (a.s.), qe përgjigjur: **“Zoti im! Për ty kam agjëruar, kam falur namaz, kam bërë xhihad etj.”** Mirëpo, Allahu i Madhëruar i pati thënë kështu: **“O Musa! Agjërimi është dritë në errësi të varrit.**

**Xhihadi është mbrojtës për zjarrin e xhehenemit. Namazi është ajo mbi të cilën do të hipësh në Sirat. Që të gjitha këto janë për ty. Po për mua, çfarë ke bërë?”** Musai (a.s.), iu drejtua Zotit të Madhëruar, duke e pyetur: **“Zoti im! Cila është vepra që duhet bërë për ty?”** Allahu i Madhëruar përgjigjet: **“O Musa! Nëse bëhesh mik me miqtë e mi dhe armik me armiqtë e mi, atëherë bën ibadet për mua dhe si rrjedhojë fiton miqësinë Time.”**

Kuptohet qartë se kriteri i të qenit mik i Allahut është të duash për hatër të Tij dhe të urresh po për hatër të Tij. Të jesh rob i Tij dhe të jesh mik i Tij janë gjëra krejtësisht të ndryshme. Të kryesh siç duhet detyrat dhe urdhrat e Tij është pjesë e obligimeve si rob i Zotit. Mirëpo, krahas kësaj, përpjekja dhe dëshira për t'u afruar edhe më pranë Tij është një vepër që shërben për të forcuar miqësinë. Tek fjalia e Muhamedit (a.s.): **“O Aishe! A mos të jem një rob i Tij që është shumë falënderues?”**, të cilën ia drejton së shoqës që e donte aq shumë, pikërisht për miqësinë bëhet fjalë. Ndonëse ishte i pastër nga të gjitha gjynahet e mëparshme dhe nga ato që do të vinin, shkak i vetëm i këtij shqetësimi, i kësaj vuajtjeje dhe i këtij përmallimi ishte dashuria. E gjitha kjo ndodh si pasojë e kujdesit që kishte ndaj miqësisë së vërtetë.

**“O besimtarë! Mos i pranoni për mbrojtës baballarët dhe vëllezërit tuaj, nëse ata e duan mosbesimin më shumë sesa besimin. Kushdo prej jush që i merr ata për mbrojtës, është keqbërës.”** (Teube, 23) Dhe sërish në suren Maide, në ajetin 51, Zoti i Madhëruar na drejtohet kështu: **“O besimtarë! Mos i bëni miq e mbrojtës hebrenjtë dhe të krishterët! Ata janë mbrojtës të njëri-tjetrit. Kushdo prej jush që i bën ata miq, është me ata. Vërtet, Allahu nuk i udhëzon në rrugë të drejtë keqbërësit.”** Këtu, sikur të vërehet me kujdes, bëhet fjalë për një dallim të hollë. Përmes këtyre ajeteve nuk synohet ndërprerja e të gjitha marrëdhënieve sociale, politike, ekonomike etj., me ata që nuk besojnë. Përkundrazi, nxiten marrëdhënie të tilla që të ftohen edhe ata në mesin e besimtarëve. Qëllimi i Zotit është mjaft i qartë. Është: miqësia, bashkëpunimi dhe dashamirësia. Pasi miqësia është një vepër shpirtërore. Shpirti, si rrjedhojë e natyrës së vet, kërkon një vend për vete. Nëse shpirti nuk kanalizohet në vende të drejta, atëherë do të drejtohet në vende të gabuara. Vendi i duhur është vendi që është në përputhshmëri me natyrshmërinë hyjnore (fitra). Zoti nuk ka ndonjë përfitim nga kjo miqësi. E do këtë, por nuk ka nevojë për të. Pasi Ai është larg nga gjithçka që mund të shkojë mendja e njeriut dhe i pastër nga çfarëdo cilësie e të mete. Allahu i Madhëruar i urdhëron njerëzit, ngaqë dëshiron lumturinë e tyre në të dyja botët. Allahu

i Madhëruar urdhëron njerëzit që ata të mos bëhen skllëvër as të vetë llojit të tyre e as të ndonjë objekti të caktuar. Ai dëshiron t'ua garantojë lumturinë e të dy botëve.

Kur mjeku i zemrave tona, Muhamed Mustafai (a.s.), thoshte: *"Thoni: La ilaha il-Allah dhe shpëtoni"*, e dinte më së miri se sa recetë shpëtimtare ishte kjo fjalë. Meqë zemra do t'i drejtohet një dere, atëherë le t'i drejtohet derës së vërtetë dhe të përjetshme. Dhe jo atyre që janë false dhe të gabuara. **"Allahu është Mbrojtësi i atyre që besojnë. Ai i nxjerr ata nga errësira në dritë. Sa për ata që nuk besojnë, mbrojtësi i tyre është djalli, i cili i nxjerr ata nga drita dhe i shpie në errësirë."** (Bekare, 257)

Allahu i thoshte Ibrahimit **"Miku im!"**. E kishte pranuar atë si mik. Sepse, ai ishte një njeri që i ishte dorëzuar tërësisht Allahut, me gjithë qenien e tij. Ai ishte një njeri që bënte mirësi vazhdimisht vetëm për hir të Tij dhe një mik "Halil", që u kishte sjellë shpinën të gjitha bestytive.

Sepse ai edhe atë që e donte edhe atë që nuk e donte, e respektonte për hatër të Zotit. Ibrahim, vetëm pse **"Allahu nuk i donte femohuesit, zullumçarët, mashtruesit, hipokritët, njerëzit kameleonë, kopracët, shpërdoruesit etj."**, s'i donte as ai. Dhe vetëm pse **"Allahu i donte besimtarët, bamirësit, besnikët, të drejtit, bujarët etj."**, i donte edhe ai. Ndaj dhe Pejgamberi ynë i dashur (a.s.), thoshte: *"Zoti im! Dhuro ma dashurinë Tënde në zemrën time. Jep ma dashurinë që u ke dhënë atyre që do. Si dhe, dhuro ma dashurinë ndaj veprës dhe gjërave që më bëjnë të afrohem më pranë Teje."* Pasi kjo ishte edhe një nga kushtet e miqësisë. I dashuruari i do edhe veprat dhe ata që do i dashuri i tij. Sikurse Mexhuni. Me një dashuri të pashembullt, kur përkëdhelte kokën e një qeni, nga goja e tij rridhnin këto fjalë: "Hëm! Domethënë që ti na paske ardhur nga mëhalla e Lejlasë!" Një ndjenjë e tillë është miqësia. Ai që do të trëndafilin, do edhe gjembin. S'ka të bëjë fare me dashurinë e ndërsjelltë apo thënë ndryshe, me pazarin mbi dashurinë.

Allahu ka krijuar vetëdijen e miqësisë tek besimtarët përmes vahjit dhe të Dërguarit të Tij aq të dashur. Ja si e përkufizon profilin e besimtarit dhe myslimanit që ai pëlqen: *"Janë besimtarë aq të pastër, aq të veçantë, sa që vetëm pse mbajnë një qëndrim dinjitoz Allahu i do ata, edhe ata e duan Allahun. Qëndrojnë drejt dhe sytë mbur kundrejt femohuesve, kurse kundrejt njëri - tjetrit janë modestë, si dheu. Ata nuk ndikohen nga askush kur shfaqin këtë qëndrim, ata përqendrojnë zemrat e tyre vetëm tek Allahu."* Kur njëri nga sahabët pinte alkool, e sillnin shpesh pranë Resulullahut (a.s.), që ai ta dënonte atë. Në momentin kur njëri prej sahabëve tha: "Allahu e mallkoftë këtë njeri, sa shumë alkool që pi!", Pejgamberi i Mëshirës e qortoi duke thënë: *"Mos e mallko! Pasi ai e*

*do Allahun dhe të Dërguarin e Tij."* Megjithatë po i njëjti Pejgamber pati thënë vetë se **"pija alkoolike është nëna e të gjithë të këqijave"**, duke treguar kështu se zanafilla e çdo të keqeje është pija. Ky është etaloni. Etaloni është fjala e Allahut. Etaloni është jeta shembullore e Pejgamberit tonë të dashur.

Miku i vërtetë është Allahu. Ata që e përfaqësojnë Atë janë pejgamberët dhe ata që ndjekin pejgamberët. Ndaj dhe Allahu është drejtuar duke thënë: **"O ju që keni besuar! Allahu dhe engjëjt e Tij mbështesin pejgamberët përmes vahjit. Bëhuni mbështetës edhe ju të Pejgamberit përmes veprave dhe duave tuaja. Dorëzojuni Shkrimet Hyjnor që ka sjellë Ai dhe përmendeni vazhdimisht Atë."** Kjo kujtesë na rinovon vetëdijen e miqësisë, pasi ky ndërtim i vetëdijes është një recetë e shpëtimit. Na e kujton dhe na urdhëron që ta mbajmë gjithnjë në mendje. Përmes fjalës: **"Për ata që kujtojnë vazhdimisht Allahun dhe Ahiretin"**, Ai na i bën një restaurim të kujdesshëm imagjinatës sonë. Pasi Ai e di se një zemër që nuk merret me Zotin, do të pushtohet nga e keqja. Ai e di se çdo zemër do të ketë një Lejla, e di se çdo zemër do ta zërë një Lejla.

I Dërguari i Allahut, na ka lënë trashëgimi të përjetshme në këtë drejtim. Kur po jetonte ditët e fundit, prej buzëve të tij qenë derdhur këto fjalë: *"Ja Allah, ja ilahi! Er-Ra'fikul-Alla"* (Allahu im! Bëmë pjesë të miqve të Tu!) Në fakt, kjo fjalë ishte një përgjigje e plotë e ajetit-dua që themi gjithë jetën në suren Fatiha: **"I Gjithëmëshirshëm, Mëshirëplotë... Udhëzoni në rrugën e drejtë! Në rrugën e atyre që u ke dhuruar mirësi..."** Po mirë, kush ishin ata që u qenkësh dhënë dhunti? Ata që janë kureshtarë ta dinë përgjigjen e kësaj pyetjeje, Zoti i Madhëruar i ad-reson tek ajeti i 69-të i sures Nisa. Nuk ishin të tjerë, por pejgamberët, besnikët, shehidët dhe salihët ata që bënë xhihad për një jetë të tërë për hir të Allahut dhe që nuk i drejtoheshin tjetërkujt përveç Tij. Në këtë kontekst, lajmi profetik na jep një porosi të përjetshme kur thotë: **"Njeriu në Ahiret është me atë që do."** Ai nënvizon faktin se miqësia në botën tjetër mund të krijohet vetëm kur je në këtë botë. Pra, na e bën të ditur se kalon përmes kësaj bote mundësia për të qëndruar së bashku me salihët në botën tjetër. Përndryshe, do të krijohej një miqësi e atillë, si "me zemër me Husejin, por me shpatën e Jezidit në brez", që Allahu na ruajtë nga kjo lloj miqësie dhe si fjalë mbyllëse, le të lutemi siç lutej Zotëria i Gjithësisë:

*"Zoti im! Bëna që të duam ata që Ti do dhe të urrejmë ata që Ti urren!"*

Amin!

# Korniza e këshillës

All Byjykçapar

Nuk është vepër e kujt do futja e qenies së vet në formatin e njeriut që i përkushtohet Zotit, por është punë vetëm e njerëzve të vërtetë.

Ka këshilla që kanë zënë vend në zemra. Po mirë vallë, si zunë vend ato këshilla aty? Këshilla të cilat i kemi përçafuar aq fort dhe nuk na hiqen nga mendja. Vallë, në ç'rrethana na janë ngulitur kaq mirë? **"Por këshilla, se vërtet këshilla u bën dobi besimtarëve."** (Dharijat, 55) Si na ndryshoi jeta pasi jemi takuar me Urtësinë Hyjnore?

Fjala nuk i bën dobi njeriut, i cili ka harruar urtësinë e krijimit të tij.

Njeriu, të cilit i është dhuruar arsye dhe vullnet që të dallojë të vërtetën nga e shtrembëra, të mbarën nga e liga, të drejtën nga e gabuara, të mirën nga e keqja, duke shfaqur sjellje shpërfillëse e harron shpejt qëllimin e jetës dhe i kushton vëmendje vetëm jetës së kësaj bote.

Njeriu është përgjegjës për besimin, adhurimin dhe nënshtrimin.

Jeta që shijohet me qendër të vërtetën dhe përgjegjësinë, me surprizat që sjell përditë, e ruan gjallërinë e saj. Ndërkohë, kërkesa që i bëhet njeriut për iman dhe për vepra të mira me siguri nuk është e paqëllimshme.

Cili duhet të jetë udhërrëfyesi i njeriut?

Allahu, ashtu sikurse ka dhënë vetë këshilla duke i urdhëruar njerëzit që ka krijuar për të bërë vepra të mira dhe duke i penguar ata që të bëjnë vepra të keqja; edhe pejgamberëve u ka dhënë detyrë që të japin këshilla. Edhe Kurani Famëlartë është një këshillë më vete për njerëzit.

Në terminologjinë teologjike islame, fjalët që përdoren për të shprehur fjalën "këshillë", janë të shumta. Kjo gjë shpreh edhe rëndësinë e këtij termi. Disa prej këtyre fjalëve janë: vaaz, nasiha, tausije, daua, irshad,

hidaje, tebshir, emri bil ma'ruf nehji anil munker, ilan, teblig etj.

Kush duhet ta mbajë mbi supe përgjegjësinë e këshillimit?

Pejgamberi ynë i dashur (a.s.), i ka këshilluar njerëzit përmes Kuranit Famëlartë. Duke e sqaruar atë, e ka bërë udhërrëfyese për njerëzit, që t'i drejtojnë drejt veprave të mira dhe t'i shmangë nga veprat e këqija. Pas vdekjes së tij, kjo detyrë u ra përsipër besimtarëve, veçanërisht dijetarëve myslimanë. Ekzistojnë disa parime që duhen bërë kujdes lidhur me këshillimin, pasi duhet pasur parasysh se struktura sociale e çdo kohe është e ndryshme.

Parimi i parë është që personi i cili bën këshillimin fetar, pikësëpari duhet të njohë teologjinë islame. Duke bërë synim pëlqimin e Allahut, gjithnjë duhet mbajtur në mendje metoda hyjnore që nxirret nga Kurani Famëlartë. Duhet ftuar njerëzit përmes lajmeve të gëzueshme, sihariqeve.

Nuk duhet harruar se, duke bërë njëfarë klasifikimi të bashkëbiseduesve, njerëzve u duhet qasur në varësi të natyrave të tyre; disave përmes urtësisë, disave përmes argumenteve shkencore dhe disave përmes qortimeve të drejtpërdrejta.

Nuk u duhet qasur njerëzve duke i kategorizuar ata si të ligj, hipokritë apo të pandreqshëm që në lindje; por duke pasur parasysh se që të gjithë janë të përshtatshëm për t'u përballur me të drejtën, besimin dhe nënshtrimin. Vetëm kështu mund të bëjmë përpara. Sa urtësi të mëdha që shpreh hadithi: **"Lehtësoni, mos vështirësoni! Jepni sihariqe dhe mos tmerroni!"**

Çdo ditë që kalon, feja na e shpjegon më së miri të vërtetën e këshillës, ndaj dhe ne duhet t'i kemi në zemër dhe në gjuhë fjalët ngazëllyese për njerëzit, lajmet e mira, sihariqet.



Idris Arpat

# Çfarë dhe përse duhet të mësoj?

Kush do ma mësojë gjuhën e shpendëve? Të më mësojë që të mund t'u jap bukë atyre dhe të mund të miqësohem me ta... Kush do ma mësojë se edhe një fidan, sikurse një fëmijë, ka nevojë për kujdes dhe dashuri?

Që kur isha i vogël më pati treguar mësuesi i matematikës së si mund të fitoja para duke përdorur numrat, kurse mësuesi i kimit më pati mësuar se si mund të helmohem, nëse përziej ujin e ndotur të lavatriçes me kripë. Mësuesi i fizikës më pati mësuar se ekziston një ligj që quhet ligji i gravitetit dhe më pati thënë se për të qëndruar në ekuilibër, këmbët duheshin hasur gjithmonë në tokë.

Mësuesi i psikologjisë? Atë e kam njohur vetëm kur përgatitesha për provime, ai më thoshte se unë duhej të përgatitesha mirë për provime dhe më mësoi se si unë duhej të mësoja për provimet. Si dhe më mësoi se unë duhej të fitoja medoemos universitetin, përndryshe do më pinte e zeza...

Unë akoma s'e kam mësuar jetën. Unë dua të mësoj jetën. Dua të jem brenda jetës, bashkë me ata që janë në jetë.

Të shkosh nga kursi i kitarës tek fusha e tenisit dhe nga aty për në teatër, për në kinema apo të bredhësh është të jesh njeri social? Ky është gëzimi i jetës suaj?

Po mirë, kush do ma mësojë mua solidaritetin? Kush

do ma mësojë që ndërkohë që po shëtis nëpër rrugë, ato pak të holla që mund t'i jap një nëne që po lypën pak para për bukën e fëmijëve të saj, do të më dhurojë një lumturi të jashtëzakonshme dhe që duhen mbajtur gjithnjë para të vogla në xhep?

Kush do ma mësojë se të jesh vërtet njeri social është të mund të ndihmosh dike, nëse është e nevojshme dhe të mund të ndihmohesh nga ndonjëri edhe pa ia kërkuar një gjë të tillë?

...Mua... Kush do ma mësojë gjuhën e shpendëve? Të më mësojë që të mund t'u jap bukë atyre dhe të mund të miqësohem me ta... Kush do ma mësojë se edhe një fidan, sikurse një fëmijë, ka nevojë për kujdes dhe ujë?

Unë dua të përgatitem për jetën. Ndoshta edhe duke bërë bojaxhiun e këpucëve mund ta mbush barkun. Por, kush do ma mësojë mëshirën, dhembshurinë dhe vlerën e tyre? Kush do ma mësojë si mund të ndiej keqardhje, atë dhimbjen që vjen nga "ndërgjegjja", kur dikush ka nevojë për ndihmë, nëse nuk arrij dot ta ndihmoj?

Mësues! U mërzita duke lexuar për trigonometrinë, për logaritmin... E ç'më duhet mua se si radhitet tabela periodike!...

Nëse akoma s'e di kuptimin e jetës...

# MREKULLITË E Kur'anit

## SHTËPI LUKSOZE NË MAL

Fisi Themud bashkë me popuj të tjerë i kaluan kufijtë që u kishte vënë Zoti xh.sh. e për rrjedhojë Ai i shkatërroi duke lënë prej tyre vetëm gjurmët. Ndër gjurmët e zbuluara së fundmi janë shtëpitë luksoze brenda maleve, të cilat janë gdhendur që para mijëra vjetësh. Këtë fakt historik të zbuluar së fundmi, e ka rrëfyer Kurani: **“Dhe ju me mjeshtëri po ndërtoni shtëpi nëpër kodra shkëmbore.”** (Shuara, 149). Pyetja që lind natyrshëm është se kush e lajmëroi Profetin tonë a.s. për ekzistencën e këtyre kështjellave të gdhendura të cilat janë zbuluar vetëm tani? A nuk përbën kjo një mrekulli profetike?



### TOKA NGA LARG

Kjo është fotoja e planetit tonë, e cila është marrë nga NASA në një largësi prej 9.5 milionë kilometrash. Toka duket si një pikë e vogël bojëqielli e shndritshme, që në krah të saj ka hënën, e cila duket si një pikë shumë e vogël. Kur shkencëtarët e studiuin këtë foto, kuptuan se toka gati nuk shihet nga miliona kilometra, e si do të ishte po të largoheshim prej saj me miliarda të tilla? Pa dyshim që toka nuk duket fare. Kur kjo është situata e tokës me pyje, male, dete etj., cila është përmasa e njeriut përpara madhësisë së universit? Na lejoni të përmendim fjalën e Zotit xh.sh. që thotë: **“O ti njeri, po ç’të mashtroi ty kundrejt Zotit tënd që është Bujar e i Urtë? I Cili të krijoi, të përsosi dhe të drejtoi. Të formësoi në formën që Ai dëshiroi!”** (Infitar, 6-8)



*"Atyre që u kemi dhënë Librin dhe e lexojnë  
ashtu siç është shpallur,  
ata besojnë vërtet në të."*

(Bekare, 121)

Kurani përbën themelin kryesor të kulturës dhe qytetërimit islam. Por në dy shekujt e fundit një pjesë e vlerave dhe praktikave kuranore e kanë humbur ndikimin e tyre në shoqëri. Gjithsesi Kurani vazhdon të mbetet vlera më e çmuar e përbashkët e botës myslimane. Por siç theksohet në ajetin e mësipërm, leximi siç duhet i Kuranit konsiston në kuptimin dhe ndjekjen e mësimave të tij.

Kurani kërkon vënien në lëvizje të të gjitha mjeteve të kuptimit dhe reflektimit mbi të dhe për një libër i cili synon ndërtimin e personalitetit të myslimanit nuk mund të pritet gjë tjetër. Mund të përmendim me dhjetëra ajete të cilat inkurajojnë për lexim, reflektim dhe meditim mbi Kurantin. Megjithëse janë me dhjetëra ajete të cilët ftojnë në kuptimin e Kuranit akoma kuptimi i Tij është eklipsuar nga leximi melodioz i tij. Në botën islame zhvillohen me qindra konkurse leximi bukur të Kuranit dhe nuk zhvillohet asnjë simpozium për kuptimin e tij. Kjo gjendje e myslimanëve karshi Kuranit është e pashpjegueshme. Kjo qasje ndaj Kuranit duket qartë që i ka penguar myslimanët nga mendimi dhe reflektimi mbi të. Sa mund t'i ndihmojë kjo qasje myslimanët për të ecur përpara. Si mund të rindërtohet qytetërimi islam pa u thelluar mbi këtë libër, i cili është gur themeli i qytetërimit islam. Sot jetojmë në një botë kur garohet për prodhim mendimesh dhe diturie. Si mund të prodhojmë një atmosferë mendimi të bazuar në Kuran pa e kuptuar atë. Ne po e lexojmë shumë Kurantin, por po mendojmë pak mbi të. Ky libër nuk është libër muzike por është pasqyrim i jetës së njeriut.

Leximi i Kuranit pa menduar dhe pa u thelluar është shkak privimi nga atmosfera shpirtërore e tij. Duke u privuar nga atmosfera shpirtërore

e Kuranit besimtarit i humbet sensi i ibadetit në të gjitha fushat e jetës, si në tregti, art, kulturë politike etj. Kjo ndodh sepse ndjenjat dhe mendimi i besimtarit nuk kanë pika takimi me ajetet kuranore.

Nga ana tjetër, mosleximi i Kuranit për të nxjerrë mësim ka çuar në ngushtimin e horizontit dhe verbërimin e mendimit të besimtarit. Feja sot gabimisht po përkufizohet si një tërësi urdhëresash dhe ndalesash. Kjo i ka bërë myslimanët të harrojnë përgjegjësinë e madhe që kanë. Myslimanët kanë harruar kuptimin e thellë të krijimit.

Për të mos u bërë i huaj me Kurantin duhet ta ngremë atë në nivelin e jetësimit të mësimave të tij. Duhet që çdo veprimtari të jetës ta rregullojmë sipas mësimave të tij. Nëse jemi duke bërë tregti nuk duhet ta nxjerrim nga mendja për asnjë çast ajetin: **"Ata nuk i pengon shitblerja nga të përmendurit e Allahut..."** (Nur, 37) Kurse kur i prek ndonjë fatkeqësi thonë: **"Sigurisht që Ne do t'ju provojmë me frikë dhe urë, me dëmtim të pasurisë, të njerëzve dhe të të lashtave! Prandaj, përgëzoji të duruarit."** (Bekare, 155) në një kohë kur drejtësia është harruar besimtarët duhet të kapen fort pas ajetit: **"O besimtarë! Bëhuni të qëndrueshëm në urdhrat e Allahut dhe bëhuni dëshmues me drejtësi! Le të mos ju nxisë urrejtja ndaj njerëzve për të bërë padrejtësi!"** (Maide, 8) Kur marrin flakë ndjenjat e urrejtjes dhe armiqësisë duhet kapur fort pas ajetit **"Edhe ata që erdhën pas tyre, thonë: "O Zoti ynë, falna ne dhe vëllezërit tanë, të cilët kanë besuar para nesh dhe mos lejo që në zemrat tona të ketë asnjë të keqe ndaj besimtarëve! O Zoti ynë, Ti je vërtet i Butë dhe Mëshirëplotë!"**



Transmetohet nga Ebu Hurejra (r.a.),  
se Pejgamberi -(a.s.)-, ka thënë:

*"...Fjala e mirë është sadaka..."*

(Buhari)

Ndër organet shqisore, organi më kompleks është gjuha. Ndërsa organet e tjera, si syri, veshi, dora kanë një perceptim të anës së jashtme të sendeve ose të dukurive, që vjen si pasojë e vepërimit të drejtpërdrejtë mbi këto sende ose dukuri, gjuha është shprehëse e kumtuëse e mendimeve e ndjenjave të njeriut. Ajo luan rolin e përkthyesit të mendimeve dhe besimeve tona. Pejgamberi (a.s.), duke treguar për rëndësinë e gjuhës mbi organet e tjera, thotë: "Kur zgjohet njeriu, të gjitha gjymtyrët e tij i drejtohen gjuhës, duke i thënë: "Ki frikën Allahut edhe për ne, sepse ne jemi të varura prej teje. Nëse ti je në rrugë të drejtë, edhe ne jemi në rrugë të drejtë e, nëse ti lajthit, edhe ne kemi lajthitur." (Tirmidhiu, Zuhd, 60.)

Pejgamberi (a.s.), na informon se gjuha, në krahasim me organet e tjera, është në një pozitë më të rëndësishme, jo në aspektin e funksionit të saj biologjik, por etik. Gjuha e lartëson njeriun ose e ul përballë Allahut dhe përballë njerëzve. Një fjalë e bukur, siç bëhet shkak për të fituar kënaqësinë e Allahut, bëhet shkak për të fituar edhe mirënjohjen e njerëzve. Pejgamberi (a.s.), e shpreh kështu këtë fakt: "Njeriu për një fjalë që e pandeh të parëndësishme, por që Allahu është i kënaqur, bëhet shkak që të lartësohet nga Allahu; dhe për një fjalë të parëndësishme që thotë, por që Allahu nuk është i kënaqur me të, hidhet në xhehenem."

Kurse Kurani na mëson se një fjalë e mirë është më e vlefshme se një lëmoshë, që shoqërohet me fjalë fyese. Plaga e hapur nga gjuha, është shumë e vështirë të shërohet, sepse godet zemrën.

Muhamedi (a.s.), i ka shpjeguar Muadh ibn Xhebelit disa tema shumë të rëndësishme, që përfshijnë edhe rëndësinë e gjuhës në jetën e

myslimanit. Muadh ibn Xhebeli tregon: "Isha me të Dërguarin e Allahut, lavdërimi dhe shpëtimi i Tij qofshin mbi të dhe iu luta të më tregonte një vepër që do të më shpinte në xhenet dhe do të më largonte nga xhehenemi."

Muhamedi (a.s.), tha: "Më ke pyetur për diçka shumë të vështirë, por që është e lehtë për atë që ia lehtëson Allahu: të adhurosh Allahun dhe të mos i shoqërosh ortak, ta falësh namazin, të japësh zekatin, ta agjërosh Ramazanin dhe të kryesh haxhin."

Pastaj vazhdoi: "A dëshiron të t'i tregoj dyert e mirësisë? Agjërimi është mburojë (nga zjarri i xhehenemit). Lëmusha i shuan mëkatet, siç shuan uji zjarrin. Namazi i natës është simboli i njerëzve të mirë." Pastaj i Dërguari lexoi ajetet: "**Ata ngrihen nga shtrati, i luten Zotit të tyre me frikë e shpresë dhe japin nga ajo që u kemi dhënë Ne. Askush nuk di se çfarë gëzimesh janë fshehur për ata, si shpërblim për punët e mira që kanë bërë.**" (Sexhde, 16, 17) "Baza e çdo gjëje është Islami, ndërsa shtylla e tij është namazi, kurse kulmi tij është xhihadit!" (përpjekja për të lartësuar fjalën e Allahut)

- A të tregoj për më të rëndësishmen, nëpërmjet së cilës i zotëron të gjitha ato që përmendëm më sipër?

Ai kapi gjuhën e tij dhe tha: "Ruaje këtë!" I thashë: "A do të gjykohe mi për atë që flasim, o Pejgamber i Allahut?"

Çfarë mendon se i hedh njerëzit në zjarr në Ditën e Gjykimit, përveç gjuhës dhe të korrurave të saj?

## Mësimet që nxjerrim nga hadithi:

1. Një fjalë e bukur, thënë vëllait besimtar, është si të japësh lëmoshë për nga shpërblimi.
2. Fjala e mirë është shkak për të hyrë në xhenet.
3. Fjala e rëndë mund të bëhet shkak për të shkuar në xhehenem.

Mje Hadith



## Kanceri i shpirtit: **EGOIZMI DHE MENDJEMADHËSIA**

### MIU MENDJEMADH

Mevlana e përshkruan me këtë histori egoizmin e njeriut, i cili nuk e shikon dobësinë dhe nuk arrin ta kuptojë të qenët asgjë:

Një mi i vogël e kishte kapur për kapistre një deve të madhe dhe po ecte duke u mbajtur mendjemadh e duke u mburrur. Ndërkohë që deveja shkonte pas tij gjatë gjithë rrugës për shkak të natyrës së saj të butë, miu në vend që ta shikonte pozitën e tij, mburrej duke thënë:

“Sa trim i madh që paskam qenë! Paskam qenë një trim që mund t’i tërheq edhe devetë!”

Ec e ec, arritën buzë një lumi. Kur miu e pa lumin, ngriu në vend ndërsa mburrej. Deveja, e cila ishte e vetëdijshme për mendjemadhësinë e miut, i tha me një sjellje të rrallë:

“O ti që më shoqërove nëpër male dhe lëndina! Përse ndalove? Ec përpara dhe shfaqë trimërinë tënde duke hyrë në lumë. A nuk je udhërrëfyese im? A të ka hije që të habitesh dhe të ngelësh në mes të rrugës?”

Miu u turpërua dhe u përgjigj duke belbëzuar:

“Shok! Ky lumë paska shumë ujë dhe qenka mjaft i thellë. Kam frikë mos mbytem.”

Deveja hyri në ujë dhe i tha:

“O mi i verbër! Uji qenka deri në gjunjë. Andaj s’ke pse të kesh frikë!”

Miu i dëshpëruar dhe i turpëruar vazhdoi:

“O deve e zgjuar! Ky lumë për ty është si milingonë,

ndërsa për mua është si kuçedër, sepse gjunjët kanë ndryshim nga njëri-tjetri. Gjunjët e mi i arrijnë gjunjët e tu vetëm nëse u vendos edhe njëqind palë gjunjë të tjerë.”

Nisur nga kjo, deveja e mençur i dha miut këtë këshillë:

“Atëherë mos tento të sillesh i paedukatë duke u kapluar nga mburrja dhe mendjemadhësia! Mos e kalo cakun! Mos u mbaj si i madh duke u mashtruar nga toleranca ime ndaj asaj që bëre, sepse Allahu nuk i do ata që mbahen të mëdhenj!..

Tani shko dhe matu me minj që janë sa ti!”

Miu, që tashmë e kuptoi mirë të vërtetën dhe që po i vinte turp, iu përgjërua devesë:

“Jam penduar dhe jam bërë pishman. Për hir të Allahut më kalo nga ky ujë vrasës dhe mbytës!”

Për shkak të këtij përgjërimi, deveja ndjeu dhembshuri për miun dhe e mëshiroi:

“Eja dhe hip mbi gungën time dhe qëndro aty! Kalimi në këtë ujë apo mbartja e të tjerëve është puna ime, sepse detyra ime është që t’u shërbej qindra mijërave të dobëtve si ti.” Pastaj e kaloi miun në anën tjetër të lumit.

Miu në këtë histori që Mevlana e tregon në Mesnevi, është simboli i një njeriu që tenton të bëjë punë të paarritshme për atë, që e shikon veten më lart se të tjerët dhe që mburret. Ndërsa deveja simbolizon njeriun durimtar, me përvojë, të mençur dhe të përsosur.

Mevlana i shpreh përsëri vetë edhe mësimet që du-



het të nxirren nga kjo histori:

## SËMUNDJA E IBLISIT

"Iblisi në fillim ishte i famshëm ndërmjet engjëjve. Andaj filloi ta shikonte veten si më të lartë. Për shkak të kësaj, u kaplua nga mburrja dhe nuk e kuptoi madhësitinë e urdhrin të Allahut Teala. Në këtë mënyrë, e përçmoi Ademin, alejhi's-selam. Andaj edhe përfundoi i poshtëruar..."

Allahu i Lartësuar i tha Iblisit: "Bëji sexhde Ademit!" Ndërsa ai, për shkak të mendjemadhësisë që kishte, tentoi ta kundërshtonte Allahun me mendjen që ia kishte dhënë vetë Allahu. Kështu që bëri një kundërshtim të pakuptimtë duke thënë: "Unë jam më i lartë se ai. Unë jam krijuar nga zjarri, ndërsa ai është krijuar nga dheu."

Ndërkohë Allahu Teala i pati thënë: "Bëji sexhde!" Pra, nuk e pati pyetur nëse ai apo njeriu ishte më i lartë. Gjithashtu, nuk e pati pyetur nëse zjarri apo dheu është më i lartë.

Në vend që Iblisi të pendohet dhe të bëhej pishman për këtë kundërshtim që shfaqti kundrejt Zotit (xh.sh.), vazhdoi ta mbronte fajin e tij me këmbëngulje për shkak të mburrjes prej fodulli që kishte. Për shkak të kësaj mendjemadhësie, mori zemërimin hyjnor dhe xhehenimin e përhershëm.

Mevlana thotë:

"Dije se bakri nuk e di pozitën e tij pa u bërë flori. Edhe zemra nuk i shikon gabimet dhe nuk e kupton inferioritetin e saj pa arritur pjekurinë shpirtërore.

O zemër! Shpëto nga gropa e mendjemadhësisë dhe

e mburrjes së nefsit, shërbeji një eliksiri që mund të të shndërrojë në xhevahir siç veprooi bakri dhe bëhu flori! Shërbeji të dashurit që i ka rrethuar zemrat!"

"Këta të dashur janë njerëzit e përshtetshmërisë. (Janë miqtë e Allahut që kanë zemër të pastër.)"

Kur njeriu arrin epërsi të përkohshme, si fuqi, pasuri, dije dhe pozitë, mund të kaplohet nga sëmundja e pëlqimit të vetes. Mënyra për të shpëtuar nga kjo është pastrimi i nefsit. Njeriu arrin ta zgjedhë këtë duke med

dituar dobësinë e tij, duke u bërë modest, duke e mësuar se të gjitha mirësitë që posedon janë nga Allahu Teala dhe duke e falënderuar Allahun për to.

Besimi i tevhidit assesi nuk e pranon ortakërinë, sepse Allahu i Lartësuar ia ka caktuar Qenies së Tij atributin e madhësisë. Ai nuk pranon si ortak asnjë prej krijesave në këtë atribut të lartë. Mendjemadhësia është një poshtërsi që i ka rrënjët në xhehenim. Ndërkohë, njerëzit mendjemëdhën poshtërohen edhe në këtë botë. Ndërsa në ahiret, edhe një pjesë e vogël sa grimca prej mendjemadhësisë që mund të gjendet në zemër, e rrokullis njeriun në xhehenim.

Historia është e mbushur me shembujt e kësaj të vërtete:

tete:

A nuk e ke parë Ebrehenë?

Kjo ngjarje ndodhi pak para se të lindte i Dërguari i Allahut (a.s.). Ebrehe doli nga Jemeni me mendjemadhësi dhe mburrje. Qëllimi i tij ishte të shkatërronte Qabenë e Shenjtë. Përballë ushtrisë së tij, të cilën e kishte fortifikuar me elefantë që zinin vendet e tankeve në atë kohë, nuk kishte ndonjë ushtri tjetër që



*Besimi i tevhidit assesi nuk e pranon ortakërinë, sepse Allahu i Lartësuar ia ka caktuar Qenies së Tij atributin e madhësisë. Ai nuk pranon si ortak asnjë prej krijesave në këtë atribut të lartë. Mendjemadhësia është një poshtërsi që i ka rrënjët në xhehenim.*



të bënte rezistencë. Ndërkohë që po përparonte me mendjemadhësi drejt qëllimit të tij, Allahu i Lartësuar e shndërroi atë dhe ushtrinë e tij në gjethe të mbjellash të përtypura. Ata nuk i shkatërroi me luanë, tigra, gjarpërinj dhe akrepa, por me gurë që i hodhën zogitë harabela shumë të vegjël. Ebrehe u kthye i plagosur dhe i nënçmuar në vendin e tij nga i cili kishte ardhur dhe pastaj vdiq pasi u poshtërua ndaj njerëzve të tij. Këtë ngjarje e ka transmetuar vetë Kurani Fisnik duke u shprehur:

“A nuk e ke parë?” “A nuk meditove për të marrë mësim?”

Edhe fundi i Faraonit dhe i Nemrudit nuk ka qenë i ndryshëm. Faraoni, i cili pandehte se ishte zot, u mbyt në detin e kuq ndërkohë që po i ndiqte për t’i shkatërruar Musain që e nënçmonte dhe çifutët që i shikonte si skllëvër.

Ndërsa Nemrudi mendjemadh, i cili e mohonte profetësinë e Ibrahimit dhe shfaqti paturpësinë për të thënë: “Unë i vdes dhe i ringjall njerëzit!”, u mposht nga një mizë topalle.

Mevlana thotë:

“O ti që e dobëson xhevahirin e besimit për shkak të ushqimit! O ti që e shet thesarin për një elb! Nemrudi nuk ia nënshtroi zemrën Ibrahimit, por shpirtin ia dorëzoi një grerëze!”

Ndërsa Musai dhe Ibrahim, të cilët ishin të mbrojtur nga mendjemadhësia, i kërkuan mbrojtje dhe ndihmë Allahut Teala. Kështu, u lartësuan dhe ia dolën mbanë me ndihmën e Allahut (xh.sh.). Ata ishin mirënjohës ndaj Allahut Teala për fitoren që ua dha. Andaj kaluan në histori jo me humbje, por me mirësi.

Edhe në kohët e afërta ka plot shembuj për shkatërrimin që Allahu i Madhëruar u ka bërë atyre që mburren dhe mbahen mendjemëdhenj:

## PËRSËRITJA E SHKATËRRIMIT

Për shembull, për anijen madhështore të quajtur “Titanik” që u bë për ta kaluar oqeanin në vitin 1912, nga çoroditja e mburrjes dhe mendjemadhësisë u tha: “Këtë anije nuk mund të fundosë asnjë forcë!” Por që në udhëtimin e parë, anija u përplas me një ajsberg dhe u fundos në thellësitë e oqeanit.

Përsëri në vitin 1986, raketa kozmike e quajtur “Challenger” domethënë “Sfiduesja”, të cilën dëshironin ta hidhnin në hapësirë, shpërtheu dhe u bë copa-copa në qiell vetëm 73 sekonda pas hedhjes.

Njëra prej shfaqjeve më të shëmtuara të mendjemadhësisë është mburrja kundrejt atyre që thonë të vërtetën. Edhe Ebu Xhehli dhe ndihmësit e tij vepuruan si Faraoni dhe Nemrudi. Kështu që nuk i besuan

të Dërguarit të Allahut, (a.s.), i cili u solli të vërtetat, për shkak të mendjemadhësisë së tyre. Fakti që muslimanët e parë përbëheshin nga të varfrit, skamnorët, robërit dhe njerëzit e dobët, ua shtoi edhe më shumë mendjemadhësinë atyre.

## MENDJEMADHËSIA: FATKEQËSIA MË E MADHE

Të mjerët, si Ebu Xhehli, Ebu Lehebi dhe Umejje bin Halefi, në të vërtetë, patën fatin të lindnin në epokën e lumturisë dhe të ishin bashkëkohës të të Dërguarit të Allahut (a.s.), por mendjemadhësia e tyre i privoi ata nga virtyti për t’u bërë sahabë. Në këtë mënyrë, i bëri prej armiqve të shkatërruar të Islamit.

Për këtë arsye, njerëzit e urtë kanë thënë:

“Këta tre njerëz nuk mund të bëhen miq të Allahut: Mendjemadh, koprraci dhe budallai!”

Edhe Ebu’l-Hasan Harakani ka thënë:

“Fitnen që e nxjerrin në fe këta dy njerëz, nuk mund ta nxjerrë as shejtani. (Andaj qëndroni larg tyre!):

1. Dijetari i mposhtur nga lakmia ndaj kësaj bote,

2. Mistiku i papjekur që jeton i vetëm dhe larg urdhrave të Kuranit e Sunetit (i cili prish në vend që të rregullojë me veprat që bën!)”

Përgjatë gjithë historisë nuk kanë munguar njerëzit që i kanë luftuar miqtë e Allahut dhe dijetarët e sinqertë dhe që i kanë parë më poshtë se veten e tyre. Mevlana thotë:

“Fillimi i mendjemadhësisë dhe mburrjes nis nga dëshirat e ndryshme vetjake dhe veçanërisht nga dashuria e tepërt që ndjehet kundrejt interesave të kësaj bote dhe pasurisë së madhe si asaj të Karunit. Nëse këto dëshira ekstreme vendosen, mblidhen dhe hedhin rrënjë në zemër, arrijnë ta bëjnë këtë për shkak të dobësisë së nefsit.”

Njeriu e ka kusht që ta njohë veten, në mënyrë që ta perceptojë nevojën, dobësinë dhe të qenët asgjë të ekzistencës së tij kundrejt fuqisë hyjnore. Ky është edhe njëri prej kuptimeve të vërtetës: “Ai që njeh veten, njeh edhe Zotin.”

I Dërguari i Allahut, (a.s.), i cili ishte në kulmin e “marifetullahut / njohjes së Zotit”, asnjëherë nuk lavdërohej. Por kur e kishte të detyrueshme për t’i shprehur cilësitë që i përkisnin atij, i konsideronte ato si mirësi që ia kishte dhënë Allahu Teala dhe shfaqte një modesti madhështore duke thënë: “La fahre / Nuk ka lavdërim!” (Tirmidhi, Menakib, 1; Ibn Maxhe, Zuhd, 37; Ahmed, I, 5, 281.)

Mevlana thotë kështu:

“Nefsi është bërë si Faraoni nga lavdërimet e tepëruara. Andaj bëhu modest dhe mos u mburr! Sa të kesh

mundësi, bëhu rob, por jo sulltan!"

Sahabi i nderuar, Xhabiri, (r.a.), thotë:

Një ditë shkova te i Dërguari i Allahut, (a.s.) dhe trokita në derë. Pejgamberi (a.s.), pyeti:

"Kush është?" Unë iu përgjigja:

"Jam unë!"

Nisur nga kjo, i Dërguari i Allahut, (a.s.), tha:

"Unë, unë! (Ashtu ë?)" Mesa duket, nuk i pëlqeu përgjigja ime. (Buhari, Isti'zan, 17.)

Sulltani i të urtëve, Mevlana (k.s.), i shpjegon kështu me gjuhën e zemrës urtësitë që gjenden në hadithin fisnik të mësipërm:

"Dikush shkoi dhe trokiti në derën e mikut. Miku i tha nga brenda:

-O njeri besnik, kush je?

Ai që trokiti në derë u përgjigj:

-Jam unë. Miku ia ktheu:

-Atëherë shko! Akoma nuk ka ardhur koha që të hysh brenda. Njeriu i papjekur nuk ka vend në sofrën e mirësive të tilla shpirtërore."

Çfarë mund ta pjekë tjetër njeriun e papjekur përveç zjarrit të ndarjes dhe largimit? Çfarë mund ta shpëtojë atë nga hipokrizia dhe dyfytërsia? Njeriu i shkretë u largua nga dera dhe mori rrugët përgjatë një viti të tërë. Kështu që u dogj dhe u përvëlua nga ndarja me mikun e tij. Ky i dashur i djegur, u kthye dhe erdhi duke u pjekur nga zjarri i ndarjes. Kështu që filloi përsëri të ecte rreth e rrotull shtëpisë së mikut të tij. Ai i ra ngadalë hallkës së derës duke bërë shumë kujdes dhe duke shfaqur edukatë të lartë, në mënyrë që të mos i dilte nga goja ndonjë fjalë që mund ta lëndonte mikun e tij. Miku i tha nga brenda:

"Kush është ai që troket në derë?"

Ai iu përgjigj:

"O ti që ke marrë zemrën time! Ti je ai që ndodhet edhe te dera."

Miku i tij i tha:

"Meqë tani ti je unë, atëherë hyr brenda o ti që je unë dhe që je prej meje! Kjo shtëpi është e ngushtë. Këtu nuk ka vend që t'i nxërë dy unë. Nëse peri që do të hyjë në vrimën e gjilpërës ndahet, domethënë, nëse maja i

bëhet fije-fije, nuk mund të hyjë në vrimën e gjilpërës. Meqë ti je i vetëm dhe një, eja dhe hyr në vrimën e kësaj gjilpëre!"

Ky shpjegim e nxjerr qartë në pah se si e pengon mendjemadhësia njeriun për t'u bërë mik i Allahut Teala.

Mevlana vazhdon:

"O ti që e ke mposhtur egon që ke në nefsin tënd! Eja dhe hyr brenda! Ti tashmë nuk je e kundërta e trëndafilut si ferrat në bahçë! Ti tani je prijësi i trëndafilave!"

Lum për atë njeri që e përçmon nefsin! Ndërsa mjerë për atë njeri që e sheh veten të lartë!

Këtë dije mirë se, mendjemadhësia dhe vetëpëlqimi janë një helm shkatërrues. Budallenjtë e ndjejnë veten të mençur, ngaqë janë dehur nga vera e këtij helmi. Nëse ndonjë i mjerë pi nga ky eliksir i helmuar, e tund kokën për një çast i gëzuar. E tund kokën, por pas pak i jep lamtumirën humanizmit dhe poshtërohet.

O ti njeri që e ke mendjen në kokë! Dije mirë këtë se, shpata pret qafën e atij që ngre kokën. Ndërsa hija është shtruar dhe është bërë njësh me tokën. Ngaqë nuk ka kokë dhe trup, është e pamundur të plagoset dhe të pritët.

O ti njeri që ke devijuar nga e drejta! Të mbahesh i madh dhe të kaploshesh nga mendjemadhësia, mburrja dhe vetëpëlqimi, është sikur të vendosësh zjarr mbi dru. Atëherë, si mund të shkosh te një zjarr i tillë dhe ta hedhësh vetën në të?

Shiko me kujdes dhe vërja gishtin kokës!

A janë gjuajtur ndonjëherë nga shigjetat hijet që janë njësh me tokën? Ndërsa njeriu që e ngre kokën nga toka, që shfaqet si trim dhe që mburret, gjuhet nga shigjetat. Ngaqë nuk ka asnjë rrugëzgjdhje tjetër, shigjetat e shpojnë dhe e shkatërrojnë vazhdimisht atë."

Allahu i Lartësuar na mbrojtë të gjithëve nga mendjemadhësia, mburrja, egoizmi dhe vetëpëlqimi! Të gjithëve na bëftë prej robërve të Tij modestë dhe të pjekur që i kërkojnë mbrojtje Atij duke e perceptuar të qenët asgjë, që e njohin Atë duke e njohur veten dhe që ecin me modesti nëpër tokë!

Amin!..





# ALTRUIZMI

## Sami Gëksyn

Dhënia është njëra prej veprave të mira...

Allahu i Madhëruar i ka lavdëruar në Kuranin Fisnik ata të cilët japin duke thënë:

**“Ata i ushqejnë të varfrit, jetimët dhe të zënë të robër, edhe pse vetë janë nevojtarë.”** (Insan, 8)

Domethënë, në këtë dhënie ka ndjenjë altruizmi. Ka flijim. Edhe pse Aliu dhe Fatimja ishin agjërueshëm dhe nuk kishin asgjë, ushqimin e iftareve të tyre tri ditë rresht ia dhanë të varfrit, jetimit dhe robit që u erdhi te dera. Sigurisht se këtë vepër e bënë me këto ndjenja.

Prej sahabëve të të Dërguarit të Allahut (a.s.), kishte prej atyre që i linin fëmijët e tyre dhe veten pa ngrënë asgjë dhe i jepnin mysafirrit.

Ata bënin sakrificë të tilla, sepse patën dëgjuar se i Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë:

*“Shtëpitë me bukuri të veçantë dhe madhështore të xhenetit janë për ata që flasin butë dhe ëmbël, që u japin për të ngrënë të tjerëve, që agjërojnë vazhdimisht dhe që falin namaz kur njerëzit janë në gjumë.”* (Tirmidhi, Xhenet, 3, IV/673.)

Si besimtarë të devotshëm, sahabët e kuptuan shumë mirë këtë hadith fisnik dhe të tjerët të ngjashëm me të. Madje, jo vetëm që i kuptuan, por u bënë shembull edhe për ne duke i përjetuar. Edhe ata që i

ndjekin sahabët, e kanë pranuar këtë gjendje si shkak i lumturisë dhe menjëherë kanë filluar ta zbatojnë.

Kjo gjendje është shumë e lartë dhe fisnike, ngaqë siguron zhvillimin e qetësisë, paqes, bashkimit, unitetit, dashurisë dhe respektit në shoqëri.

Nisur nga kjo që thamë më sipër, myslimanët gjithmonë duhet të japin, duhet të jenë altruistë dhe të kenë moral të lartë. Nevojtarët duhet t'i konsiderojnë si amanetin e tyre. Ata duhet t'i lartësojnë gradat e humanizmit të tyre, duke ua mundësuar edhe të tjerëve që të përfitojnë nga mirësitë që u ka dhuruar Allahu Teala. Por të mos harrojmë se në të gjitha këto përpjekje dhe sakrificë, synimi duhet të jetë vetëm pëlqimi i Allahut (xh.sh.). Besimtarët nuk presin ndonjë shpërblim apo vlerësim prej atyre që i kanë ndihmuar si kundërvlerë për atë që u kanë dhënë. Ata nuk presin prej tyre as komplimente dhe as lavdërime. Në ajetin e nëntë të sures Insan, Allahu i Lartësuar thotë, duke na treguar për fjalët e robërve të Tij të veçantë të cilët japin për hir të Allahut:

**“Ne ju ushqejmë vetëm për hir të Zotit. Për këtë, nuk duam shpërblim e as falënderim!”** (Insan, 9)

Sakrificat e tyre nuk përbëheshin vetëm prej sofrave që shtroheshin herë pas here. Nëse do t'i hidhnim një shikim jetës së tyre, do të shohim se si e kanë sakrifikuar pasurinë, madje edhe shpirtin e tyre për

të tjerët. Sa bukur i lavdëron Allahu Teala në Kuranin Fisnik muhaxhirët dhe ensarët që e shfaqën këtë sakrificë:

**“Një pjesë e plaçkës i takon edhe mërgimtarëve të varfër, të cilët u përzunë nga vendlindja dhe pasuritë e tyre, duke kërkuar mirësinë dhe kënaqësinë e Allahut dhe duke ndihmuar Allahun dhe të Dërguarin e Tij. Pikërisht ata janë besimtarët e sinqertë. Ndërsa ata që banojnë në Medinë dhe që e kanë pranuar besimin qysh më parë, i duan mërgimtarët që vijnë në Medinë dhe në zemrat e tyre nuk ndejnë kurrfarë rëndimi, për atë, që u është dhënë atyre, por duan t’u bëjnë më mirë mërgimtarëve sesa vetes, edhe pse vetë janë nevojtarë. Kushdo që ruhet nga lakmia e vetvetes, me siguri që do të jetë fitues.”** (Hashr, 8-9)

Këto ajete fisnike tregojnë se ensarët e nderuar kishin një moral sublim edhe në lidhje me këtë çështje. Muhaxhirët ishin në vështirësi, ndërsa ensarët e nderuar u lidhnin plagët. Në këtë mënyrë, ensarët shpëtuan që në këtë botë nga koprracia e egoizmi dhe fituan shpëtimin e shpërblimin hyjnor edhe në këtë botë, edhe në botën tjetër.

Në hadithin që përmendëm më sipër, i Dërguari i Allahut, (a.s.), shprehet se të folurit me butësi, ëmbëlsi dhe mirësi është një mundësi e vyer për të shkuar në xhenet dhe fituar shtëpitë madhështore të xhenetit.

I Dërguari i Allahut (a.s.), si në çdo çështje tjetër, edhe në çështjen e të folurit bukur është i vetmi udhërrëfyes që mund ta marrim për shembull. Atëherë, ne si myslimanë duhet të jemi të sjellshëm dhe të sinqertë në të folurin tonë dhe në jetën sociale. Në këtë mënyrë do të fitohen zemrat, do të dalë në pah dashuria dhe respekti, do të shtohen mirëkuptimet dhe do të shfaqet paqja e qetësia. Ne duhet ta dimë shumë mirë se nuk mund të arrijmë askund duke ua thyer zemrat njerëzve, duke i urreyer ata dhe duke shkaktuar përçarje e prishje.

Fjalët e thëna me vend, me mënyrë të sjellshme dhe me urtësi, shkrimet domethënëse dhe të shkruara duke menduar thellë mbi to, influencojnë pozitivisht te shpirtat, i joshin zemrat dhe na ndihmojnë në realizimin e qëllimit tonë.

Edhe Allahu i Lartësuar, në lidhje me këtë çështje, thotë kështu në shumë ajete të Kuranit Fisnik duke ua tërhequr vëmendjen njerëzve:

**“...Thuajuni fjalë të ëmbla.”** (Nisa, 8)

Besimtarët e sinqertë dhe të dëlirë i frikësohen Allahut Teala dhe gjithmonë përpiqen të thonë fjalë të vërteta, të dobishme, të ëmbla dhe të buta. Ata lar-

gohen nga fjalët e dëmshme dhe të padobishme. Në ajetin fisnik të mëposhtëm, Zoti (xh.sh.), na e shpreh këtë obligim duke thënë:

**“O ju që keni besuar! Kini frikë nga Allahu dhe thoni fjalë të vërteta.”** (Ahzab, 70)

Gjuha e ëmbël, të shprehurit e bukur, të sjellët me ndershmëri... Një zemër e fituar duke vepruar me këtë metodë, është më e vlefshme se e gjithë bota. Ja pra, në sajë të kësaj, robi arrin lumturinë dhe shpërblimin e kësaj bote dhe të ahiretit. Në të kundërt, shejtani fut hipokrizi ndërmjet njerëzve, nxit të keqen, shton vështirësitë dhe e ndalon realizimin e qëllimeve që synojnë mirësinë. Kurani Fisnik na ka lajmëruar se shejtani është armiku i hapur i yni.

Allahu Teala na njofton haptazi:

**“Kush flet më bukur se ai që i fton njerëzit drejt Allahut, bën vepra të mira dhe thotë: “Unë, me të vërtetë jam mysliman.”** (Fussilet, 33)

Domethënë, robërit që flasin më bukur janë ata njerëz që përpiqen për t’i ftuar robërit e Allahut të Madhëruar për te Ai. Ata i ftojnë njerëzit për t’i bërë ibadet dhe për t’iu bindur Allahut Teala. Ndërkohë, edhe vetë e praktikojnë atë që thonë dhe bëjnë vepra të mira. Ata bëhen shembull virtyti dhe sinqeriteti për njerëzit.

Fjala e myslimanëve të tillë të sinqertë është për Allahun dhe për shërbimin ndaj myslimanëve. Madje, edhe pasurinë dhe jetën e flijojnë duke shërbyer për këtë...

Myslimani duhet t’i gjejë nevojtarët kudo që mund të ndodhen në botën islame, në mënyrë që t’u japë ushqim për të ngrënë. Po ashtu, duhet të hapë puse uji në vendet e nevojshme, duhet të bëjë çezma, duhet të ndërtojë azile, duhet të ndërtojë kurse Kurani, duhet të bëjë shkolla dhe duhet t’u japë iftare nxënësve që mësojnë Kuranin. Në këtë mënyrë duhet të përpiqet vazhdimisht për t’ua plotësuar njerëzve nevojat e tyre materialo-shpirtërore.

Duhet të nxitojmë për t’i ndihmuar nevojtarët duke marrë vendin tonë në këtë fushë me zekatet, lëmoshat, fitrat<sup>1</sup> dhe mirësitë tona. Padyshim se ata që i bëjnë këto përpjekje, në botën tjetër do të arrijnë nderin për të parë në xhenet “xhemalullah / bukurinë e Allahut”.

Zoti (xh.sh.), na dhëntë sukses për të bërë vepra që na shpiejnë në xhenet dhe që na japin nderin për të parë “bukurinë e Allahut”. Amin!..

1. Lëmosha në masë të caktuar që duhet t’u jepet të varfërve brenda mujit të Ramazanit.



# Fakte shkencore NE KURAN

M. sc. Artan S. Mehmeti

Kurani ka shumë ajete që na tregojnë për veçoritë shkencore, të cilat e vërtetojnë se Kurani është me të vërtetë libër i shenjtë. Prej shumë veçorive është fakti se një numër i konsiderueshëm i këtyre fakteve shkencore të lartpërmendura, njeriu i ka zbuluar vetëm me ndihmën e teknologjisë së shekullit XX e të cilat janë shpallur në Kuran 1400 vjet më parë. Këto fakte shkencore në kohën e Muhamedit (a.s.), as që mund të perceptoheshin apo imagjinoeshin. Këto e vërtetojnë edhe më tepër prejardhjen hyjnore të Kuranit. Kjo, gjithashtu, provon se Muhamedi (a.s.), është me të vërtetë një profet i dërguar prej Zotit.

Zoti (xh.sh.), i thërret njerëzit të studiojnë dhe reflektojnë rreth qiejve, tokës, maleve, yjeve, bimëve, farave, kafshëve, ndryshimeve të natës me ditën, krijimit të njeriut, shiut dhe shumë gjërave të tjera të krijuara. Duke i eksploruar këto fakte, njeriu arrin ta njohë aftësinë artistike të krijimtarisë së Zotit. Më këto krijime njeriu arrin që ta njohë Krijuesin e tij, i Cili krijoi të gjithë universin dhe çdo gjë që ndodhet në të nga asgjëja.

Edhe pse në Kuran gjejmë shumë fakte shkencore, të cilat janë zbuluar në mënyrë të plotë me ndihmën e

teknologjisë bashkëkohore, Kurani nuk është një libër shkencor e as që mund të pretendojmë një gjë të tillë. Qëllimi i shpalljes së tij është udhëzimi i njerëzve drejt së vërtetës dhe nuk është shtjellimi i fakteve shkencore apo shpjegimi i dukurive natyrore.

## FAKTE SHKENCORE NGA FUSHA E GJEOGRAFISË

Kurani, i cili ka zbritur në gjysmën e parë të shekullit VII pas erës sonë, jep fakte konkrete dhe të sakta të cilat shkenca e gjeografisë dhe ato që kanë lidhje të ngushtë me to i kanë verifikuar nëpërmjet teorive dhe aparaturave të ndërtuara për këtë qëllim.

## SHTRESAT E TOKËS

Brendësia e Tokës është e ndarë në disa shtresa të cilat janë emërtuar në varësi të veçorive sizmike dhe kimike. Toka ndahet në këto shtresa: 1. korja e tokës, 2. manteli i sipërm, 3. astenosfera, 4. manteli i poshtëm, 5. shtresa e guetenbergut ose shtresa D, 6. bërthama e jashtme, 7. bërthama e brendshme (bërthamëza).<sup>1</sup> Shkenca po e vërteton se toka është e përbërë me shtresa të cilat shtrihen njëra mbi tjetrën dhe këto

<sup>1</sup>. KOÇO PRIFTI, PAJTIM BEHJTA, GJEOLGJIA E PËRGJITHSHME, Sht - pia Botuese LIBRI UNIVERSITAR, Tiranë 1996, faq. 129 - 133



janë në funksion të përbashkët, këtë e shohim edhe në Kuran. Zoti (xh.sh.), në Kuran për shtresat e tokës thotë:

**"Allahu është Ai që krijoi shtatë palë qiej e edhe prej tokës aq sa ata..."** (Talak, 12)

### FORMA E KORËS SË TOKËS DHE LËVIZJA E SAJ

Në të kaluarën u mendua se malet ishin thjesht zgjatje që ngriheshin mbi sipërfaqen e Tokës. Shkencëtarët kuptuan se kjo hipotezë nuk ishte e vërtetë, ata zbuluan dhe vërtetuan se malet i kanë rrënjët poshtë në mantel dhe këto rrënjë janë 10 - 15 herë më të mëdha në sipërfaqen e tokës se sa lartësia e tyre mbi sipërfaqen e Tokës.<sup>2</sup> Nga kjo që u cek më lart, kuptohet lehtësisht se malet kanë formën e shtyllave të ngulitura në mantel. Këto rrënjë mund t'ua kalojnë disa herë ngritjeve të tyre në sipërfaqen e Tokës. Kjo e arrihur shkencore nga ana e gjeologëve është zbuluar për herë të parë në gjysmën e dytë të shekullit XIX. Kurani, i cili i zbriti Muhamedit (a.s.), nga Zoti (xh.sh.), katërmëdhjetë shekuj më parë, malet i përshkruan kështu:

**"A nuk e bëmë Ne tokën të përshtatshme (për jetë), Ndërsa kodrat shtylla?"** (Nebe, 6-7)

Tektonika e pllakave është një hipotezë gjeologjike që i shpjegon lëvizjet tekto - magnetike që ndodhin në brendësi të kores së tokës dhe në sipërfaqen e saj.<sup>3</sup> Në Kuran është përmendur "lëvizja e maleve". Sot, shkencëtarët bashkëkohorë për këtë lëvizje përdorin termin "lëvizja kontinentale." Zoti (xh.sh.), për lëvizjen e maleve në Kuran thotë:

**"E i sheh kodrat e mendon se ato janë të palëvizshme, ndërsa ato lëvizin si retë..."** (Neml, 88)

Shkencëtarët gjithashtu kanë zbuluar se malet kanë rol të rëndësishëm në stabilizimin e kores së tokës, d.m.th. se korja e tokës gjithmonë ka qenë dhe është në lëvizje. Gjithashtu, nga kjo që u cek më lart, kuptuam se malet kanë formën e shtyllave të ngulitura në mantel. Teoria moderne e pllakave tektonike e tregon se malet shërbejnë si stabilizues për tokën. Për rolin e maleve si stabilizuese të tokës Zoti (xh.sh.), në Kuran thotë:

**"Dhe Ai vuri kodra (të forta) në tokë, që ajo të mos lëkundet me ju..."** (Nahl, 15)

### SHTRESAT E FORMACIONEVE GJEOLGJIKE (LLOJET E SHKËMBINJVE)

Shtresa e tokës (litosfera) është ndërtuar nga llojet e ndryshme të shkëmbinjve, të cilët ndërmjet veti dallohen për nga mënyra e formimit, struktura, madhësia forma dhe ngjyra. Ka një numër të madh të kombinimeve të shtresave të ndryshme gjeologjike në pjesët e ndryshme të tokës. Këto që thamë më lart, Zoti (xh.sh.), na i ka treguar në Kuran, ku thotë:

**"...nëpër kodra ka vija të bardha e të kuqe ngjyrash të ndryshme, e ka edhe shumë të zeza."** (Fatir, 27)

### MALI TUR (SINAI)

Mali Tur (Sinai), ndodhet në rrafshnal tën Tin, në Gadishullin e Sinaït, përkatësisht në pjesën jugore të tij.<sup>4</sup> Mali Tur (Sinai) është i shenjtë për tri fetë (Jehudizmin, Krishterimin dhe Islamin), për arsye se në këtë mal Zoti (xh.sh.), i ka folur të dërguarit të vet Musait (a.s.) dhe ia ka zbritur Teuratin. Të tri fetët e besojnë Musain (a.s.), si profet. Zoti (xh.sh.), e përmend këtë mal duke u betuar për të, ku thotë: **"Pasha Turin!"** (Tur, 1)

### PIKA MË E ULËT E TOKËS

Në ajetet e mëposhtëm bëhet fjalë për pikën më të ulët të tokës kontinentale, që është - 418 m të lartësisë mbidetare dhe gjithnjë është duke rënë,<sup>5</sup> si dhe për disfatën e Bizantit nga persët që ka ndodhur po në këtë vend. Gjithashtu këto ajete tregojnë se Perandoria Bizantine, pas disfatës së rëndë që kishte pësuar prej ushtrisë perse, do të triumfonte shumë shpejt, ku pas disa viteve Perandoria e Bizantit korri fitore mbi atë Persiane.<sup>6</sup> Për këto fenomene, Zoti (xh.sh.), në Kuran thotë:

**"Elif, Lam, Mim. Bizantinët (rumët) u mundën, në tokën më afër (tokës së arabëve), po pas disfatës së tyre, ata do të ngadhënjëjnë, brenda pak viteve..."** (Rum, 1-4)



2. [http://www.miraclesofthequran.com/scientific\\_25.html](http://www.miraclesofthequran.com/scientific_25.html) 20.8.2014

3. KOÇO PRIFTI, PAJTIM BEHJTA, GJEOLGJIA faq. 325 - 326

4. ATLAS GJEOLGJIK, TRIMAKS, Shkup 2008. faq. 66

5. [http://sq.wikipedia.org/wiki/Deji\\_i\\_Vdekur](http://sq.wikipedia.org/wiki/Deji_i_Vdekur) 30.8.2014

6. <http://www.zeriislam.com/artikulli.php?id=847> (Dr. Milazim Krasniqi) 30.08.2014

## ATMOSFERA (KUPA QIELLORE) MBUROJË E TOKËS

Atmosfera mbron Tokën nga efekti përvëlues i rrezeve të Diellit, si dhe rregullon shpërndarjen e temperaturës në sipërfaqen e Tokës. Shtresa e ozonit mbron Tokën nga rrezet ultraviolett. Meteorët kur arrijnë në atmosferën e Tokës, nga fërkimi nëpër ajër gjatë shpejtësisë së madhe ndizen dhe digjen. Brezi Van Alen e mbron Tokën nga efektet shkatërruese dhe dëmtuese të hapësirës. Pra pa atmosferë nuk do kishte jetë në Tokë. Për këtë Zoti (xh.sh.), na tregon në Kuran ku thotë:

**“Qiellin ua kemi bërë kulm të sigurt...”** (Enbija, 32)

## KRIJIMI I REVE DHE RESHJEVE

Procesi i formimit të shiut kalon në tri procese (faza) të cilat janë: *Së pari*, avulli i ujit me ndihmën e erës ngrihet lart në qiell; *Së dyti*, me ndihmën e erës retë e vogla bashkohen njëra më tjetrën dhe formojnë lloje të ndryshme të reve; dhe së *Treti*, kur pikat e ujit të cilat formojnë retë bëhen shumë të rënda, atëherë nga këto re fillojnë të bien në tokë në formë shiu, bore, breshëri.<sup>7</sup> Të njëjtin proces të formimit të shiut Zoti (xh.sh.), e thotë përmes ajetit kuranor:

**“Allahu është Ai që i lëshon erërat e ato lëkundin retë dhe Ai i shtrin lart si të dojë, i bën ato edhe të ndara në pjesë dhe përmes tyre e sheh se si bie shi...”** (Rum 48)

Lëvizjet shumë të forta konvektive në komulonimbuse janë shkak që në pjesët e këtyre reve të grumbullohet elektriciteti pozitiv dhe negativ. Lëvizja jashtëzakonisht e vullshme e elektricitetit nëpër ajër në të shkakton një ngrohje shumë të madhe dhe e bën atë të dukshme, sikurse te shkëndija elektrike. Kjo dukuri e dukshme, e zbrazjes elektrike quhet rrufe. Krisma e rrufesë është vetëm zëri momental, mirëpo zëri zgjat një kohë dhe kjo quhet bubullimë.<sup>8</sup> Zoti (xh.sh.), për vetëtimat thotë:

**“Ai është që u shfaq vetëtimën trishtuese (nga ndonjë fatkeqësi), por edhe shpresëdhënëse (për shi), dhe formulon re të dendura.”** (Rad, 12)

## SASIA E SHIUT

Sasia e shiut është e lidhur ngushtë me procesin e qarkullimit të ujit në natyrë. Nga të dhënat e ndryshme meteorologjike del se sasia e shiut (reshjeve), në gjithë pjesët e tokës nuk është e njëjtë, ajo ndryshon nga një kontinent në kontinentin tjetër, nga një rajon në rajonin tjetër, nga një shtet në shtetin tjetër apo nga një vendbanim në tjetrin. Për sasinë e shiut Zoti (xh.sh.), në suren Zuhruf thotë:

**“Dhe Ai që lëshon nga qielli ujë (shi) me masë...”** (Zuhruf, 11)

## FORMIMI I RRYMAVE AJRORE (ERËS)

Ndryshimet në ngrohjen në ekuator dhe pole shkaktojnë edhe ndryshime në shtypjet ajrore. Për këtë arsye në atmosferën mbi sipërfaqen tokësore formohen disa rryma ajrore të përhershme, të cilat përbëjnë qarkullimin e përgjithshëm të rrymave ajrore në atmosferë. Ky qarkullim mund të përkufizohet edhe si erëra të përhershme mbi sipërfaqen tokësore.<sup>9</sup> Zoti (xh.sh.), na tregon në Kuran për qarkullimin masave ajrore (erërave), ku thotë:

**“...edhe në qarkullimin e erërave...”** (Xhathije, 5)

## ERËRAT MBARËSUESE

Siç shihet nga fazat e formimit të reve dhe shiut, erërat “mbarësojnë” avullin e ujit që noton në ajër me grimcat e pluhurit që ndodhen në ujë e që quhen aerosole. Gjithashtu era e bart polenin nga njëra bimë tek tjetra dhe kështu i mbarëson ato.<sup>10</sup> Këtë rol të erës Zoti (xh.sh.), na ka treguar në Kuran ku thotë:

**“Ne i lëshojmë erërat mbarësuese e nga qielli (retë) lëshojmë shi dhe atë jua japim ta pini, e ju nuk mund ta ruani atë.”** (Hixhr, 22)

## ERËRAT SI PARALAJMËRUESE TË RESHJEVE

Nëse një vend ka kohë të qetë, d.m.th. kohë me diell dhe në një moment fillon të fryjë erë, atëherë në atë vend pritët ndryshimi i kohës. Në fillim paraqiten vranësirat, dhe pas një kohe në atë vend do të kemi reshje. Këto që i thamë më lart Zoti (xh.sh.), na i ka treguar në Kuran ku thotë:

**“Ai është që i lëshon erërat si myzhde pranë mëshirës (shiut) së Tij. E kur ato (erërat) bartin re të mëdha...”** (Araf, 57)

## ERËRAT E FUQISHME

Stuhitë e fuqishme formohen nëpër oqeanë dhe njihen me emra të ndryshëm, si ciklone, tajfune, uragane, tornado, furtunë, shtrëngatë, tufane, trumbeta etj. Zoti (xh.sh.), për këto erëra të fuqishme dhe shkatërrimtare në Kuran thotë:

**“Pasha erërat që fryjnë një pas një (pandërprerë)! Që janë shumë të stuhishme e shkaktojnë furtunë.”** (Murselat, 1-2)

Një lloj i këtyre erërave të fuqishme e që njihen me emrin tufane dhe trumbeta, gjatë udhëtimit të tyre bartin sasi të mëdha pluhuri, rëre etj.<sup>11</sup> Edhe këto erëra Zoti (xh.sh.), i përmend në Kuran përmes ajetit në të cilin thotë:

9. Po aty, faq. 181.

10. [http://www.miraclesofthequran.com/scientific\\_47.html](http://www.miraclesofthequran.com/scientific_47.html) 03.09.2014

11. Dr. Marko Milosavljeviq, METEROLOGJIA, faq. 224

7. Dr. Marko Milosavljeviq, METEROLOGJIA, faq. 122.

8. Po aty, faq. 228.

**“Për erërat që ngrenë dheun dhe e shpërndajnë.”**  
(Dharijat, 1)

### OQEANET

Shkenca ka zbuluar se në vendin ku takohen dy dete ekziston një barrierë (pengesë) ndarëse, e cila bën të mundur që secili prej dy deteve të ruajë temperaturën, dendësinë dhe kripësinë e tij. P.sh. uji i detit Mesdhe është më i ngrohtë, më i kripur dhe me dendësi më të vogël se uji i oqeanit Atlantik.<sup>12</sup> Kurani i Shenjtë e përmend këtë barrierë midis deteve, të cilët nuk e kalojnë atë. Zoti në Kuran thotë:

**“...në mes dy deteve bëri ndarje...”** (Neml, 61)

Oqeani botëror, në mënyrë vertikale është i ndarë në 5 shtresa: 1. Zona e rrezeve të diellit (Epipelagic Zone), nga 0 deri 200 m, 2. Zona e Muzgut (Mesopelagic zone), nga 200 deri 1.000 m, 3. Zona e mesnatës (Bathypelagic Zone) nga 1.000 m deri 4.000 m, 4. Zona e pafundme (Abyssopelagic zone) nga 4.000 deri 6.000 m, 5. Zona Hadal nga 6.000 deri më shumë se 10.000 m thellësi.<sup>13</sup> Për këtë Zoti (xh.sh.), në Kuran thotë:

**“Ose (veprat e tyre) janë si errësirat në det të thellë të cilin e mbulojnë valët mbi valë dhe mbi ato retë e dendura, pra, errësira njëra mbi tjetrën sa që nuk mund ta shohë ai as dorën e vet...”**  
(Nur, 40)

Ky ajet përmend edhe errësirën në thellësinë e detit, errësirë ku nuk mund të shikosh as dorën tënde. Errësira në dete haset në thellësi nga 200 m e poshtë.<sup>14</sup>

### GRYKËDERDHJA E LUMENJVE NË DET

Grykëderdhja e lumenjve në det (Estuaries), është vendi ku takohet uji i ëmbël i lumenjve më ujën e kripur të deteve. Ujën e ëmbël nga ai i kripur në grykëderdhjet e lumenjve e ndan një zonë e cila është e përbërë nga disa shtresa ndarëse. Ky informacion është zbuluar nga Wollast dhe Duinker në vitin 1982,<sup>15</sup> kurse

12. I.A. Ibrahim, UDHËZUES I ILUSTRUAR MBI ISLAMIN, CIMS - Aleksa - dri - Egypt, Prishtinë - Kosova 2006, faq. 20

13. <http://www.learner.org/courses/envsci/unit/pdfs/unit3.pdf>

14. Po aty

15. <http://www.amap.no/documents/doc/Basic-circulation-and-salinity-distribution-in-salt-wedge-partially-mixed-well-mixed-and-fjord-type-estuaries-as-defined-by-Wollast-and-Duinker1982-Numbers-and-shading-show-salinity-values/340> 05.09.2014

Zoti (xh.sh.), na ka treguar para 14 shekujve, në Kuran ku thotë:

**“Ai la të lirë të bashkohen dy dete, ku (njëri) i pijshëm e i shijshëm e (tjetri) i njelmët e i hidhur e mes tyre bëri si të jetë ndonjë pendë, pritë që të mos përzihen.”** (Furkan, 53)

### UJËRAT NËNTOKËSORE, BURIMET DHE LUMENJTË

Ujërat nëntokësore quhen të gjitha ujërat që ndodhen poshtë sipërfaqes së Tokës. Burimi kryesor i ushqimit të ujërave nëntokësore janë reshjet atmosferike. Për këto ujëra Zoti (xh.sh.), na tregon në Kuran ku thotë:

**“Ne lëshuam me masë ujë nga qielli dhe atë e përqendruam në tokë. Po Ne kemi mundësi edhe ta humbim atë (ujin).”**  
(Muminun, 18)

Dalja e ujërave nëntokësore mbi sipërfaqen tokësore quhet burim. Për këtë Zoti (xh.sh.), në Kuran thotë:

**“A nuk e sheh se Allahu lëshon ujë nga qielli dhe atë e shpërndan në tokë nëpër burime...”** (Zumer, 21)

Burimet karstike janë të pranishme në sipërfaqet tokësore, ku janë të zhvilluara format karstike. Karst quhet procesi i tretjes prej ujit i disa shkëmbinjve, gjatë të cilit lindin forma të veçanta karstike të relievit dhe formohen tipa të ndryshëm boshllëqesh.<sup>16</sup> Për burimet karstike, Zoti (xh.sh.), na tregon në Kuran ku thotë:

**“...sepse ka nga gurët prej të cilëve gufojnë lumenj, e ka disa prej tyre që çahen dhe prej tyre buron ujë...”** (Bekare, 74)

Shumica e të gjithë lumenjve në sipërfaqen e Tokës formohen nga burimet që ushqehen prej ujërave nëntokësore. Ka disa lumenj që formohen nga reshjet e shiut, mirëpo shumica e këtyre lumenjve janë të përkohshëm. Disa lumenj formohen edhe nga shkrirja e borës dhe akullit i cili ndodhet në majat e larta të maleve. Zoti (xh.sh.), në Kuran na tregon për formimin e lumit ku thotë:

**“A nuk e sheh se Allahu lëshon ujë nga qielli dhe atë e shpërndan në tokë nëpër burime...”** (Zumer, 21)

16. KOÇO PRIFTI, PAJTIM BEHJTA, GJELOGJIA. faq. 287.



# *Kush* **MASHTRON** *nuk është prej nesh*

Nuredin Nazarko

Koha është gjykatësi më i mirë. Rrjedha e saj pa kthim përshkon çdokënd, dhe askush nuk mund të dalë jashtë rrjedhës së saj. Është pikërisht kjo rrjedhë që nëpërmjet luhatjeve të saj, shkulumzime dhe qetësime, turbullime dhe qartësi, pastron dhe i bën të shkëlqejnë disa fytyra e shumë syresh i shpëlan dhe i nxiros si mos më keq.

Jeta e njeriut është e shenjtë dhe e tillë duhet trajtuar. Shenjtërimi i saj nuk është aspak vepër e njeriut, ashtu siç nuk është vepër e tij as bota që e rrethon. Ardhja e njeriut këtu, nuk është zgjedhje e tij. As largimi i njeriut nga këtu, nuk është zgjedhje e tij. Mes ardhjes dhe ikjes rrjedh pikërisht rrjedha që nxjerr çdokënd lakuriq para së vërtetës, pavarësisht veshjeve luksoze ose jo që mban njeriu.

Sado gjatë që të përpiqet njeriu të fshehë atë çfarë në të vërtetë është në brendësi të qenies së tij, nuk mund ta kryejë këtë deri në ikje, sepse fati nuk përcaktohet nga vetë njeriu. Sikur kjo çështje të ishte në dorën e njeriut, me siguri tashmë do të ishim duke u ushqyer me mish njeriu sade. E megjithatë disa syresh i kanë ngritur dhe vazhdojnë t'i ngrënë të mirat e tyre materialistike mbi jetë të shenjta njerëzish.

Njeriu është qenia që ka mundësinë të marrë një vendim se ç'do të bëjë me jetën e tij. Ashtu siç njerëzit janë të ndryshëm nga njëri-tjetri, ashtu edhe zgjedhjet e tyre nuk mund të jenë standarde dhe të njëjta. Zgjedhja që kryen njeriu nuk mund të jetë absolutisht e njërit drejtim. Pra, nuk mund të zgjedhë të lëvizë vetëm në binarët e drejtësisë, apo të kundërtën e saj.

Njeriu i duhet që të marrë një vendim se mbi cilët binarë do të lëvizë jeta e tij, për sa kohë është këtu. I duhet të marrë një vendim se në cilën rrjedhë do të lahet apo shpëlahet fytyra dhe syri i tij.

Tekembramja, sado që të mundohet njeriu të ruajë fshehtësinë e zgjedhjes dhe mosekspozimit të saj në sytë e publikut, koha, gjykatësi i drejtë dhe i paanshëm do ta nxjerrë çdokënd pikërisht në atë rrjedhë në të cilën i ka fjetur zemra njeriut, kur ka marrë vendimin më esencial dhe themelor të jetës së tij. Ky është rregull absolut dhe nuk ka njeri në botë të dalë kundër këtij rregulli, edhe sikur të jetë mashtruesi më perfekt dhe hipokriti më i fshehtë dhe intrigant.

Kjo, sepse njeriu nuk mundet kurrsesi të jetë zot i

jetës dhe fatit të tij dhe mbizotërues i plotë i veprave të tij. Në momente të caktuara të rrjedhës së jetës do të nxjerrë krye ajo që qëndron e fshehur dhe që është pjesë e qenësishme e njeriut, e drejtë apo e padrejtë qoftë. Do të vijë momenti që njeriu do të tradhtohët nga vetvetja dhe do të dalë zbuluar ajo që njeriu intrigant, mashtrues e hileqar ka mbajtur të fshehur në skutat e qenies së tij, të molepsur me ligësi, edhe pse në fytyrën e përdhosur i "shkëlqen" një buzëqeshje e akullt dhe pa jetë.

Çështja më e rëndësishme dhe më shqetësuese është se cilit rend gjërash duhet t'i përkasësh. Të marrësh vendimin t'i përkasësh rendit metafizik të gjërave nuk është as lojë dhe as hajgare. Çështja e binarëve jetësorë është shumë serioze dhe po kaq shumë serioz është dhe vendimi që duhet të merret.

Në rast se njeriu vendos të hapërojë pikërisht në këtë sferë, atëherë duhet të jetë i përkujdesshëm që fytyra e tij të lahet vazhdimisht në këto ujra të pastra, të kulluara dhe të paqta.

Në rast se njeriu hapëron në sferën e metafizikës, por në momentin e vendimit nuk ka lënë pas padrejtësitë e së shkuarës, është e sigurt që ujrata e pastra, të kulluara dhe të paqta do të turbullohen dhe do të shkulmëzohen duke turbulluar dhe shkulmëzuar fytyrat që patën guximin të mendonin se mund të përbaltnin sferat e larta të metafizikës me idhnakësinë e tyre.

Për hir të së vërtetës, ka një soj njerëzish që mendojnë gjithmonë se janë dhe qëndrojnë në anën e së vërtetës, se janë ata që gjithmonë e dinë se çfarë është më e mirë, se janë ata që e dinë se kur është momenti për ta shfrytëzuar një mundësi për të përfituar, qoftë edhe në rrafshin materialistik.

Ky soj njerëzish, mendon se gjykimi i tyre nuk mund të gabojë cak, pasi që caku i tyre është e vërteta. Në ditët e sotme relativizimi i vlerave ka marrë përhapje të gjerë dhe çdokush mendon se ajo çfarë di dhe beson është e vërteta, ndërsa tjetri që nuk u qëndron të njëjtave gjykime ka lajthitur. Në këtë terren, ku çdokush faktorizon relativizimin egoist si kriter të përcaktimit të anës së duhur të gjërave, zhguriten ata të cilët koha i shpëlan me turbullirat dhe shkulmet e skutave të errëta të qenies së tyre.

Por në këtë mes, askush nuk mund të pretendojë se gjendet në anën e duhur, për sa kohë dielli i së vërtetës të mos perëndojë në zemrën e qenies njerzore, sepse nëse hija e gjërave të vogla është rritur brenda qenies, atëherë dielli është vërtetë duke perënduar. E në momentin kur dielli perëndon, hija e errësirës do ta mbulojë njeriun, edhe nëse mund të ketë zgjedhur ecjen në sferat e metafizikës, sepse mund ta ketë zgjedhur, por nuk ka sakrifikuar nga egoizmi vetjak për hir të asaj që ka zgjedhur.

Gjatë gjithë kohës ka menduar për vetveten dhe shpurën që e ndjek, duke menduar se diskutimet dhe vendimet e llagëmeve dhe gjirizeve të errëta nëntokësore nuk do të dilnin në sipërfaqe. Dhe për më tepër, është shitur në mesin e të drejtëve, në mesin e atyre që besatimin ndaj së Vërtetës e kanë shtyllë kurrizore të jetës së tyre, si përkrahës i kauzave të drejta.

Por, rrjedha e jetës është aq kokëfortë saqë nuk mund t'u japë kënaqësinë të vdesin pa nxjerrë më parë fytyrën e pafytyrë të "mbrojtësve" të mëdhenj, të kauzave të drejta. Nëse turpërohen ose jo është çështje e tyre, por publiku që mund t'u ketë besuar verbërisht duhet t'i shkëlmojë, që njerëz të këtij kallëpi të përfundojnë në koshin e historisë dhe atje të përpëliten dhe jargëzohen me fytyrat e njëjta si fytyrat e tyre.

Mashtruesit, që nën petkun e së vërtetës duan të realizojnë etjen e tyre karrieriste, nuk do ta kenë të gjatë kamuflimin, sepse dielli i së vërtetës dhe ata që ndriçohen prej tij, i shohin çështjet me qartësi dhe nuk mund të viktimizohen prej këtij soji edhe sikur fjalimet e tyre të jenë magjike. Kjo sepse, fjalët e tyre janë të thata, të vdekura, pa jetë, pa shpirt dhe rrjedhimisht do të manifestohen në jetën e tyre këto cilësi të vyera që kanë.

Mashtruesit, sado të kalibruar të jenë, do të thyhen përballë besatimit të atyre njerëzve që sinqeritetin dhe drejtësinë i kanë shkrirë dhe i kanë përnjështuar me qënien e tyre, me jetën e tyre, duke u përcaktuar qartë se kush i përket me të drejtë rendit metafizik. Mashtruesit, edhe pse të kalibruar apo dhe të shumtë në numër e ndoshta të veshur edhe me pushtet apo në përpjekje për t'u veshur, duhet ta dinë se sa më shumë thellohet nata, aq më afër është agimi.

*Mashtruesit, edhe pse të kalibruar apo dhe të shumtë në numër e ndoshta të veshur edhe me pushtet apo në përpjekje për t'u veshur, duhet ta dinë se sa më shumë thellohet nata, aq më afër është agimi.*

(inspirime realitetesh të jetuara)

# “Allahumme, më ruaj nga paaftësia për të punuar dhe nga dembelizmi..!”

Imam Muhamed Sytari  
Myfti i Zonës Shkodër

Një prej temave të neglizhuara kohëve të fundit në realitetet e jetës sonë të përditshme, është pa dyshim edhe puna, angazhimi për të fituar nga hallalli i duarve dhe sakrifica për familjen dhe komunitetin.

Ajeti kuranor: **“Ai është që tokën jua bëri të përshtatshme, prandaj ecni nëpër pjesë të saj dhe shfrytëzoni begatitë e Tij”**, ngelet një busull e përhershme orientimi, sado të hutohet njeriu, myslimani në veçanti. Ndërkohë, lutja e Resulullahut (a.s.): “Allahumme, më ruaj nga paaftësia për të punuar dhe nga dembelizmi...”<sup>2</sup>, merr përmasat e një lutjeje obligative, që duhet konsumuar ditë për ditë, në kuadër të rritjes profesionale dhe cilësore, në raport me punën që bëjmë, secili në fushën dhe zanatin e tij!

Po lexoja një trajtim shumë interesant, që dietari bashkëkohor, Shejkh Ali Sherbexhi i bën vlerës që ka shfrytëzimi i kohës në jetën e myslimanit në drejtim të punës, fitimit të hallallit, prodhimit, shfrytëzimit të mundësive të shumta, për të bërë diçka të dobishme në jetë.

Ndër të tjera, ai thekson: “Fitimi hallall dhe kërkimi i rizkut nga burimet e tij legjitime, është një urdhëresë e detyruar për myslimanin e pjekur, sepse nëpërmjet punës ai arrin të mjaftojë veten, familjen, si dhe të shtrijë dorën e ndihmës ndaj nevojtarit e skamnorit. Jo vetëm kaq, por edhe të kontribuojë në zhvillimin e resurseve të vendit të tij, lulëzimin e jetës dhe realizimin e mirëqenies!”<sup>3</sup>

Nga këtu, nuk ka sesi të mos gëzohemi dhe të mbushemi me optimizëm për të sotmen dhe të ardhmen, kur Resulullahu (a.s.), na jep sihariq se: “Ai që del të punojë për të ushqyer fëmijët e tij të vegjël, është në

rrugën e Allahut. Edhe nëse del të punojë për të ushqyer dy prindërit e tij të moshuar, është në rrugën e Allahut. Edhe nëse del të punojë për të ruajtur veten e tij nga harami, është në rrugën e Allahut. Ndërsa ai që del të punojë për të rënë në sytë e tjerëve a për t'u mburrur (plot egoizëm) me punën e tij, është në rruqën e shejtanit!”<sup>4</sup>

Feja jonë islame na edukon me frymën e punës dhe sakrificës në jetë. Për këtë nuk ka asnjë dyshim, pasi myslimani është i ftuar ta ndërtojë jetën dhe ta perfeksionojë punën që bën, në funksion të dëshmimit të tij si një pasues besnik i urdhëresave hyjnore, që i japin kuptim jetës.

Transmetohet se Omeri (r.a.), u kishte thënë një ditë disa të rinjve: “Mos të frenohet ndonjëri prej jush nga kërkimi i rizkut, duke thënë: “Allahumme më furnizo me rizk”, sepse ju e dini se nga qielli nuk bie as ar, as argjend!”<sup>5</sup>

E kishte thënë këtë, jo për të ndaluar lutjet, jo, aspak! Por për t'i edukuar të rinjtë se puna dhe angazhimi për të fituar rizkun hallall është një mirësi e madhe, që e bën njeriun të jetojë me nder e krenari në jetën e tij. Për të dhënë një mesazh të qartë, se në jetë, duhet të programohet koha dhe t'i jepet çdo gjëje haku i duhur, ndonëse në praktikën e përditshme, kjo kërkon disiplinë dhe shumë përkujdesje.

Për këtë, Resulullahu (a.s.), thoshte: “Ku ka njeri me shpërblim më të madh sesa ai që shpenzon për fëmijët e tij të vegjël, duke i mbrojtur nga harami? U sjell Allahu dobi prej punës së tij dhe i mjafton.”<sup>6</sup> Pra, i ushqen nga puna e duarve të tij dhe i mjafton nga uria, etja, dhe nevojat që kanë.

1. Kurani, Mulk: 15.

2. Imam Hakimi dhe Bejhekiu, në një hadith të gjatë të transmetuar nga Enesi (r.a.).

3. Shejkh Ali Sherbexhi, “El-Erbaunmukhtare fil-fedailid-dinijeti vinsan-ije”, botimi i parë, Kuvajt, 2006, f. 394.

4. Transmetuar nga Imam Tabaraniu, ndërsa Mundhiru ka thënë: “Burrat e zinxhirit të tij, janë burra të hadithit të saktë”.

5. Imam Shihabuddin ibn Muhammed Ebshihi, “El-Mustatraf fi kul-li fennin mustadhruf”, Bejrut, 1981, f. 304.

6. Transmetuar nga Imam Muslimi, nga Ebu Kilabe (r.a.).

Sot është e nevojshme që të rinjtë myslimanë të mos e humbin kohën e tyre, pa dobi, por të angazhohen e të sakrifikojnë në kërkim të hallallit. Sepse ai që punon dhe mbështetet në Allahun, ai do të ketë sukses dhe mbarësi në jetë. Do të punojë pastër, do të fitojë pastër, do të shpenzojë nga pasuria e tij dhe nëpërmjet saj do të arrijë kënaqësinë e Zotit!

Ka shumë të rinj, në ditët tona, që sillen vërdallë, pa punë, pa dritë shprese, plot pesimizëm e shpesh edhe demoralizim, nga mungesa e politikave të punës dhe zhvillimit të begative, me të cilat Zoti e ka begatuar këtë vend.

Nga ana tjetër, ka shumë të rinj myslimanë, të cilët janë përkushtuar në zanate e punë të ndryshme, kanë hapur biznese, sado të vogla qofshin. Shpesh, këto biznese i etiketojnë edhe me termin "hallall". Natyrisht, myslimani nuk punon vetëm se hallall, pastër e ndershëm.

Por, ndoshta, meqë haramet janë përhapur gjithandej dhe fatkeqësisht edhe në bizneset e shumë myslimanëve me emër, këta të rinj janë detyruar të specifikojnë se puna e tyre është brenda kufijve të hallallit. Për këtë, ata duhet të jenë të kujdesshëm dyfish. Së pari, për vetë punën dhe zanatin e tyre. Së dyti, për të justifikuar me nder dhe krenari termin "hallall", që ia shoqërojnë bizneseve dhe zanateve të tyre, Zoti u dhashtë të mbarën!

Sepse ai që hap një biznes dhe i paraprin emrit të zanatit të tij me fjalën "hallall", nëse nuk është korrekt me veten dhe etikën islame në punë, ai është më i dëmshëm se pala e parë. Më qëlloi një ditë të hyj në një biznes "hallall". Punëtori i parë që më doli në ballë, ishte veshur me pantallona të shkurtra, përtej kufirit të auresit, mbante një cigare në gojë, teksa shijonte një këngë që dëgjohej në sfond nga një manjetofon i hapur, me zë të lartë...?

Fryma e punës dhe e dobisë nëpërmjet saj, qëndron në themelet e edukatës së myslimanit. Resulullahu (a.s.), thoshte: *"Cilido mysliman që mbjell një fidan, apo një arë, prej së cilës ushqehet zogu, njeriu a bagëtia, atij do t'i regjistrohet si sadaka."*<sup>7</sup>

Lexova para disa ditësh se një fshatar, në një zonë të Turqisë, kishte vendosur një tabelë të madhe në një cep të arës së tij, ku kishte mbjellë lloj-lloj frutash. Në të shkruhej: "Kushdo që kalon nga kjo arë dhe ha diçka prej saj, e ka hallall". Subhanallah, sa bukur. I lumi ai!

Në tregjet e Damaskut, në shumë tezgja, ku shkon të blesh, do të gesh tabela të vogla të vendosura mbi mallrat e larmishme, ku shënohet: "Provoje, e ke hallall!"

Prandaj, mesazhi im nëpërmjet këtij shkrimi, i kush-tohet pikërisht nxitjes për të punuar, për të fituar zanate, për të kërkuar punë hallalli, për të dhënë she-

7. Transmetuar nga Buhariu dhe Muslimi.

mbullin tonë si myslimanë nëpërmjet punës dhe sakrificës në të.

U them shumë të rinjve besimtarë: Shkoni dhe mësoni zanate si: gdhendja në dru, punimi i gurit, zdrucktaria, punimi i hekurit, rrobaqepësia speciale, imtësitë e elektronikës, kuzhina.

Nëse keni grumbulluar një sasi të hollash, apo i keni trashëguar nga familja, shkoni dhe hapni lokale dhe restorante, pa pije dhe ushqime të ndaluara dhe, shërbeni bukur dhe me shije atë që kërkojnë klientët.

Hapni punishta ëmbëlsirash, sera lulesh etj., por çdo gjë që të bëni, bëjeni me shpirt, me plot përkushtim, respektoni klientin dhe nderojeni atë. Mos e lini të presë atë që ju ka ardhur në punishte, në dyqan, në lokal, në restorant a kudo qoftë puna e juaj, vlerësojeni kohën, shijen dhe kërkesën legjitime të tjetrit!

Dhe, asnjëherë të mos kini turp nga ajo që bëni, sepse çfarëdo që të bëni në jetë, shoqëruar me besim dhe frikën e Zotit, është punë e pastër, punë e hajrit, punë që të nderon.

Për këtë, Resulullahu (a.s.), udhëzonte: *"Pasha Atë, që e ka shpirtin tim në dorën e Tij, të marrë ndonjëri prej jush litarët e tij dhe të lidhë drunj mbi shpinë, është më e mirë për të sesa të shkojë e të lypë nga njerëzit; dikush i jep e dikush jo!"*<sup>8</sup>

Gjithashtu, thoshte: *"Janë disa gjynahe që nuk i fshin as namazi, as agjërimi, as haxhi, as umreja, por i fshin shqetësimi për kërkimin e jetesës!"*<sup>9</sup>

Në përfundim, dua të sjell një shembull të mrekullueshëm nga nëna jonë, Zejneb bint Xhahsh (r.a.), nëpërmjet lidhjes së saj me hadithin: *"Ajo që më së shpejti do më ndjekë nga kjo botë, është më bamirësja ndër ju!"*<sup>10</sup>

Aishja (r.a.), nëna e besimtarëve, tregon se: "E para grua që ndërroi jetë pas Resulullahut (a.s.), ishte Zejneb bint Xhahsh (r.a.)... Ajo punonte me duart e saj lëkurat dhe jepte sadaka."<sup>11</sup>

Pra, gruaja e të Dërguarit të Allahut, punonte me duart e saj, pa u paragjykuar për llojin e punës, sepse puna e dobishme, ajo e lejuara, nuk paragjykohej, përkundrazi, është vlerë dhe dobi!

Dhe në orbitën e mëdyshjeve, që sillen në mendjen e të rinjve tanë, sa herë që përballen me një ofertë të vlefshme për një punë legjitime, a kërkojnë për të mirën e tyre, le të kujtojnë lutjen e Zotërisë tonë, që thoshte: *"Allahumme, më ruaj nga paaftësia për të punuar dhe nga dembelizmi...!"*

8. Transmetuar nga Buhariu.

9. Transmetuar nga Ebu Nuajmi në "Hilje" dhe Ibn Asakir, nga Ebu Hurejra (r.a.) Imam Sujuti e ka regjistruar në "Xhamiu-Sagir", me nr. 2461.

10. Transmetuar nga Buhariu, nga Aishja (r.a.).

11. Nedhir Mektebi, "Safahatun nejjiratun min hajatis-sabikat", botimi i dytë, Bejrut, 1996, f. 157. (Me përshtatje të lehtë të dy transmetimeve të ngjarjes. M.S.)

# Unë dhe ti

## *Tjetri jam unë*



Edison Çeraj

Për të pranuar Tjetrin ashtu siç Tjetri është, së pari duhet të pranojmë Vetën siç ajo është. Pranimi i Tjetrit ndërkohë që akoma nuk kemi pranuar Vetën, është vetëm një iluzion ose shtirje në emër të shoqërores/publikes imagjinare.

Ne kemi nevojë ta respektojmë njëri-tjetrin, jo ta tolerojmë.<sup>1</sup> Zëvendësimi i respektit me tolerancën, jo vetëm që shkakton diferencime të paqenësishme, - duke e vënë toleruesin automatikisht në një pozitë superiore - por bën që marrëdhëniet në shoqëri të jenë thellësisht formale. Një rast tipik për këtë është Shqipëria.

Le ta shohim këtë në pikëpamjen e asaj që tradicionalisht emërohet si dinjitet njerëzor: cili nga ne do pranon të ishte i toleruar dhe jo i respektuar?

Nocioni "tolerancë" buron nga fjala latine *tolerare* dhe se në thelb do të thotë "të durosh" dikë, diçka ose një situatë të caktuar. E cili pra është ai që nuk do ndjehej i fyer nëse vjen në përfundimin se vetëm po e durojnë, se nuk kanë zgjidhje tjetër, në vend që ta respektojnë? (Muhiq, 2013)

1. "Gjithnjë jam ndjerë i nënçmuar kur më kanë toleruar! Prandaj dhe asnjë herë nuk kam dashur që të më toleronin. Sa herë ishte e mundur, relacionin e tolerancës e ndërroja me marrëdhënien e respektit të ndërsjellë. Kuptohet që maja e vërtetë e kësaj linje të përpjetë marrëdhëniesh socio-psikologjike, për mua përfundonte në pikën më të lartë të jetës, që quhet dashuri!" (Muhiq, 2013)

Toleranca e anashkalon dinjitetin njerëzor si të tillë, me të cilin lind çdo njeri, dhe aktivizohet vetëm në raport me atë çfarë qenia ka marrë apo pranuar *postum*, që ndryshe mund ta quajmë edhe përkatësi botëkuptimore.

Kjo do të thotë se marrëdhëniet ndërmjet njerëzve janë përqendruar tek ajo që na dallon nga njëri-tjetri, duke harruar atë që na bashkon, të cilën e posedojmë dhe e gëzojmë të gjithë që në kryeherë, mbi dhe për të cilën është zbuluar dhe është ngritur çdo botëkuptim: për njeriun e drobitur gjer në tëhuajësim nga aventura e dallimeve.

Ja pse është kaq sublime krijimtaria artistike, veçmas poezia, sepse i drejtohet njeriut, pavarësisht botëkuptimit, racës, kombësisë, gjinisë, profesionit etj.

"Në fakt, të flasësh për tolerimin dhe tolerancën, kjo merr kuptim vetëm nëse jemi në pozicionin që ta pengojmë, që ta ndërpresim ose ta ndalojmë një sjellje të tillë. Për shembull, fëmijët, objektivist nuk janë në gjendje t'i tolerojnë veprimet ose qëndrimet e prindërve të tyre, por prindërit ndodhen në ato situata ku u duhet të jenë tolerantë ose jotolerantë ndaj sjelljes dhe mendimeve të shprehura nga fëmijët e tyre. Ose, në një shembull tjetër, toleranca fetare paraqet lejimin nga feja dominuese, që në fushën e dominimit të saj të veprojnë edhe fe të tjera, edhe nëse ato nuk janë të miratuara nga doktrina zyrtare ose konsidero-



hen si inferiore, të gabuara, ose, madje, edhe të dëmshme, ndonëse ajo ka instrumente autonome, apo instrumente shtetërore për të penguar veprimin e tyre të lirë. E kuptuar në këtë kontekst dinamik, toleranca, para së gjithash, paraqet praninë e një dallimi objektiv në statusin hierarkik ndërmjet palës që kërkon të jetë e toleruar, pra palës që vendos se a do tolerojë. E artikuluar më konkretisht, ky status hierarkik shprehet si posedim i fuqisë objektive, e cila përfshin edhe mundësi për ndalesë aktive dhe pengim të veprimit dhe mendimit të mundësive të tjera religjioze. Sipas kësaj, kur shihet në mënyrë integrale, si relacion i përcaktuar hierarkik i palës inferiore dhe superiore, toleranca, në radhë të parë, mund të barazohet me çështjen e marrëdhënies së të dobët me të fortin, ku pala e dobët kërkon ndryshim të qëndrimit të zakonshëm, të represionit nga më i forti mbi më të dobët dhe pret gatishmërinë e tij vullnetare për "të duruar" diçka që në çdo çast mund të pengohet, ndërpritet dhe ndalohet në mënyrë efikase. Pikërisht për shkak të kësaj, në aspektin historik, toleranca është një relacion që testohet ndaj pakicave në përgjithësi. E testuar në mesjetë, para së gjithash ndaj përcaktimeve religjioze të bashkësive më të vogla sociale të shteteve me fe dominuese zyrtare, sot ajo është shtrirë edhe ndaj bashkësive etnike, grupeve politike, homoseksualëve etj., ku me këtë rast, Konventa për të Drejtat e Njeriut përfshin edhe detyrimin ligjor të çdo shteti për tolerancë në të gjitha rastet." (Muhiq, 2013)

Me gjasë, ajo që i shtyn shumë njerëz t'i japin përparësi tolerancës e të mos jenë në gjendje të përbrendësojnë respektin karshi Tjetrit, është të menduarit apo mendësia ekskluziviste, që nënkupton se e vërteta, e drejta, e mira, e reja etj., është me mua, a thua se kanë në dorë *copyright*-in për këtë, apo sikur e vërteta është monopol i tyre. Për rrjedhojë, kjo mendësi nuk lë asnjë mundësi që të ndërtohet një marrëdhënie të hapur karshi asaj çfarë Tjetri është dhe çfarë ai posedon. Kjo nuk do të thotë aspak që bindjen për botëkuptimin apo mënyrën tonë të jetesës ta vëmë në dyshim, e të luftojmë me veten për të mos qenë asnjëherë të bindur për hir të Tjetrit - jo. Ashtu sikurse është pjesë e natyrës së njeriut të dyshojë, - gjë që pas Descartes-it e këndejt është kthyer në një mit ose idhull në mendimin evropian - po ashtu është po aq pjesë e natyrës së njeriut, - në mos më afër tij - të gjejë e të provojë bindje.

Nga ana tjetër, nëse do perifrasonim Wittgenstein, mund të themi se të dyshuarit në mënyrë të vazhdueshme<sup>2</sup>, që nuk ka një fund, nuk është më dyshim.<sup>3</sup> Si-

2. Duke u kthyer në pjesë spikatëse të karakterit të dikujt.

3. Dyshimi është një mjet, dhe si i tillë nuk mund të kthehet në qëllim.

kundërse nuk mund të quhet bindje ajo gjendje e cila e mbyll njeriun në vetvete duke e bërë si të vetëmjaftueshëm; duke e bërë që të besojë se e drejta është vetëm në anën e tij dhe se Tjetri *a priori* është gabim<sup>4</sup>; duke mos e lejuar pra të dëgjojë Tjetrin; duke e privuar kështu nga dialogu, që përbën një prej përvojave më të qenësishme në jetën e qenies, një pasqyrë pa të cilën nuk bëjmë dot; përndryshe, fare mirë mund të përfundojmë si uji i ndenjtur, që nuk merr e as nuk jep, duke iu shtuar era e keqe çdo ditë e më shumë.

Te romani *Robinson Crusoe*, Defoe na tregon se njeriu mund të jetojë edhe vetëm në një vend, siç është rasti me ishullin, por për njëfarë kohe ama, pasi në të kundërt, nëse vendos të jetojë në vetmi përgjithmonë, ai mund t'ia dalë, por duke shtypur e ndrydhur disa veti bazë të karakterit dhe disa sjellje kyçe të cilat kanë kuptim dhe janë të mundura vetëm me Tjetrin. Fjala vjen, nëse do nisemi nga imperativi kategorik, një parim i lashtë sa vetë njeriu, të cilin Kant-i vetëm sa na e ka kujtuar nëpërmjet një formulimi tjetërsoj, që njeriu duhet të veprojë vetëm në atë mënyrë që maksima e vullnetit të tij të jetë edhe parim i legjislacionit të përgjithshëm, atëherë, ai që vendos të jetojë i vetëm duhet të ndërmendet se nëse edhe të tjerët do vepronin si ai, për afro gjysëm shekulli a diç më shumë nuk do kishte këmbë njeriu mbi tokë.<sup>5</sup>

Po parimi tjetër, që edhe ky e ka shoqëruar njeriun që në krye të herës: të duash për tjetrin atë që do për veten, ose të mos i bësh tjetrit atë që tjetri nuk do të doje të ta bënte ty - po ky parim, si mund të kuptohet e aq më pak të jetohet kur je i vetëm pa askënd? Natyrisht që nuk është e mundur.

Po buzëqeshja, a mund të ketë kuptim pa Tjetrin?

Çdo njeri mbetet një qenie më vete, pra e vetme, e patëdytshme; fatin dhe përgjegjësinë i ka vetjake; vjen vetëm në këtë botë dhe ikën po vetëm; dhe siç e thotë poeti, "të tjerët mund ta bëjnë rrugën me ty, por jo për ty"<sup>6</sup>. Ama, për aq sa është në këtë udhëtim, njeriu është i lidhur pazgjidhshmërisht me Tjetrin.

"Të jërët mund ta bëjnë rrugën me ty..." - dhe rruga bëhet më e lehtë kur herë pas here ia jep dorën Tjetrit dhe ai ta jep ty.

4. Bash kjo është rrënja e çdo ekstremizmi.

5. Dikush mund të thotë e çë pastaj? Përgjigjja është se këtu po shtrojmë vetëm një supozim teorik, që përbën një element argumentues të trajtesës në fjalë, dhe si i tillë mbetet në letër, dhe nuk mund të ndodhë në jetën e jetuar, sepse duhet të bindësh të gjithë njerëzit të jetojnë në vetmi/të izoluar, pa Tjetrin. Kështu, kjo mbetet një utopi e kulluar. Prandaj, fakti që kjo mbetet një utopi, dhe jeta vijon pavarësisht planeve apo ëndrrave të disa individëve të caktuar, është përgjigjja më kuptimplote.

6. Rumi.



# Ruajtja e Zemrës

Prof. dr. Hasan Kamil Jëllmaz

Në përgjithësi, emri shejtan përdoret për njerëzit, xinët dhe kafshët e këqija.<sup>1</sup> Në Kuranin fisnik, fjalët shejtan dhe melek përdoren gjithsej 88 herë, si në shumës ashtu edhe në njëjës.<sup>2</sup>

Iblisi ose shejtani, ishte pjesëtar i një grupi të xhindëve, që ndodheshin pranë melekëve. Në Kuran tregohet gjatë e gjerë se kur Iblisi u sprovua me urdhrin e sexhdes ndaj Ademit (a.s.), ai refuzoi t'i bindej urdhrit dhe e humbi sprovën për shkak të mendjemadhësisë dhe smirës.<sup>3</sup>

Ajo që theksohet në këto ajete dhe mesazhi që japin ato, është ndikimi i ndjenjave djallëzore dhe prirjeve të egos në zemrën e njeriut. Urtësia e krijimit

1. -shih. Isfahani, Mufreddat, fq. 383.

2. -Iblis dhe shejtan, janë dy terma kuranorë që përdoren me kuptim të njëjtë. Iblis, do të thotë "i pashpresë" dhe vjen nga rrënja e fjalës "be-le-se". Iblis nënkupton atë që i ka këputur shpresat nga Allahu. Kjo fjalë kalon 11 herë në Kuran. Kërkimi i mbrojtjes nga Iblisi, që e ka humbur shpresën tek Allahu, është një urdhër kuranor dhe po ashtu, nuk është rastësi që edhe ky urdhër kalon 11 herë.

3. -shih. Bekare, 34-37; Araf, 11-22; Hixhr, 32-42; Isra, 61-66; Kehf, 50-51; Ta-Ha, 116-123; Sad, 74-83.

të njeriut është adhurimi i Allahut; dhe kushti i parë i adhurimit, është besimi. Ndërsa qendra e besimit është zemra. Për besimin, zemra e njeriut është si një kala e fortifikuar. Ndërsa shejtani është një armik i përbetuar që kërkon të hyjë në atë kala dhe të shkaktojë dëme. Ashtu siç mbrohet kalaja prej armikut, duke fortifikuar dyert dhe mbyllur të çarat e saj, në të njëjtën mënyrë edhe mbrojtja e zemrës, që është kalaja e besimit të njeriut, bëhet duke njohur rrugët e hyrjes së shejtanit në zemër dhe duke i mbyllur ato. Sipas Gazzaliut, dyert dhe të çarat që përdor shejtani për të hyrë në zemrën e njeriut mund të radhiten në këtë mënyrë:

1- Dera e parë dhe më e madhe nga ku hyn shejtani, është zemërimi dhe epshi. Zemërimi, pra nxehja apo nervozizmi, e nxjerrin mendjen jashtë loje. Dhe, kur mendja dobësohet, shejtani kalon në sulm. Ndërsa epshi dobëson forcën e vullnetit, duke i hapur rrugën shejtanit. Për këtë arsye, shejtani e mashtron më lehtë birin e njeriut kur zemërimi, urrejtja dhe epshi janë më të forta. Nëse e mbush barkun plot, qoftë

edhe me ushqim hallall, kjo e shton epshin dhe e forcon pozitën e shejtanit, sepse ngrënia e tepërt e bën njeriun përtac, të rëndë dhe neglizhent ndaj namazit dhe përmendjes së Allahut. Zemërimi dhe epshi e shpien njeriun në sjellje të urryera dhe përcmuese ndaj kundërshtarëve të tij. Dhe kjo e bën shejtantin ortak në punët e robit.

2- Dy dyer të tjera ku shejtani e hedh në kurth njeriun, janë smira dhe lakmia. Në fund të fundit, ajo që e çoi shejtantin në humbje, ishte smira. Ndërsa ajo që e nxori Ademin (a.s.), nga xheneti, ishte lakmia. Nëse njeriu e dëshiron shumë diçka, syri i tij nuk e sheh të drejtën dhe veshi i tij nuk e dëgjon të vërtetën. Ajo që e lajmëron njeriun për hyrjen e shejtanit në zemër, është drita e urtësisë. Mirëpo, lakmia dhe smira e verbojnë urtësinë. Kur njeriu verbohët, shejtani ndikon tek njeriu dhe ia zbukuron arritjen e dëshirës që ka.

3- Një prej dyerve që përdor shejtani për të hyrë në zemrën e njeriut, është edhe pasioni i zbukurimit me mirësitë e kësaj bote. Kur shejtani e sheh tek dikush këtë sëmundje, kllon në zemrën e tij dhe fillon të thurë kurthe duke përdorur bukuritë tërheqëse të kësaj bote.

4- Një nga dyert më të mëdha nga ku shejtani hyn në zemër, është edhe ndjenja e pangopësisë. Nëse kjo ndjenjë mbizotëron në zemër, njeriu bëhet dyfytirësh dhe hileqar vetëm e vetëm për të arritur atë që dëshiron. Mirëpo, dyfytirësia dhe hilja, e shkatërrojnë edhe zemrën edhe punën e tij.

5- Një tjetër prej dyerve nga ku futet shejtani në zemër, është nxitimi. Maturia, marrja e vendimeve duke u menduar mirë dhe llogaritja e përfundimit, i zvogëlon mundësitë e gabimeve të njeriut. Në zemrën e njeriut, tek i cili ekziston vetëdija se ndjenja e nxitimit është prej shejtanit, ndërsa ndjenja e maturisë është prej Rrahmanit<sup>4</sup>, zgjerohet horizonti i meditimit e i përkujtimit dhe drita e urtësisë së tij i pakëson vendimet e gabuara.

4. -shih. Tirmidhi, *Sunen*, Bejrut; Birr ve's- sila 65; Bejhaki, *Shuabu'l-iman*, Bejrut 1410, fq. 89.

6- Një prej dyerve që përdor shejtani për të hyrë në zemrën e njeriut, është edhe koprracia dhe frika nga varfëria. Këto ndjenja e pengojnë njeriun nga bamirësia dhe e nxisin atë të mbledhë sa më shumë pasuri. Ai orientohet drejt gjërave të kësaj bote, si mbledhja e floririt dhe argjendit. Mirëpo, mirësitë e kësaj bote që janë më tepër se nevojat, bëhen edhe qendra e veprimtimit të shejtanit.<sup>5</sup>

Allahu i Madhëruar i nxit robërit e Tij që në vend që të shpenzojnë pasurinë e tyre për t'u dukur, pa besuar në botën tjetër, ta shpenzojnë atë vetëm për hir të Allahut, duke e cilësuar shoqërinë me shejtantin një shoqëri shumë të keqe.<sup>6</sup>

Të çarat që hapen në zemër, janë vendet ku shejtani u ngre kurth njerëzve. Shejtani, si një gjahtar zemre, hedh karremat e tij, si zemërimin, epshin, lakminë, dashurinë për paranë, dëshirën për post etj., duke planifikuar humbjen tonë. Ashtu si zogu që nuk mashtrohet nga karremi që ka vënë gjahtari dhe shpëton prej tij, ashtu edhe robi që nuk mashtrohet nga karremat e shejtanit, ushqehet në fushat e së vërtetës dhe jeton i lirë, duke mos u lidhur pas asgjëje të kësaj bote.

Kur njeriu shpëton njëherë prej kurthit të shejtanit, mirënjohja e tij ndaj Allahut është të mos hyjë më në fushën e atyre kurtheve. Madje, të mos u afrohet fare atyre. Vesveset që nxit shejtani për të prishur zemrën e robit, nuk janë vetëm epshi dhe dashuria për këtë botë. Ai gjithmonë përdor rrugë të ndryshme, sepse është betuar se patjetër do të marrë hak prej njeriut. Siç e mësojmë edhe prej Kuranit, shejtani pretendon se Allahu i Madhëruar e devijoi atë nga rruga e drejtë me anë të Ademit dhe për këtë arsye, ai kërkoi leje prej Allahut t'i zërë pritë njeriut në rrugën e drejtë, me qëllim që ta devijojë atë duke i ardhur nga para, nga mbrapa, nga e djathta dhe e majta.<sup>7</sup> Allahu i Madhëruar, kërkesës së tij i përgjigjet në këtë mënyrë:

**"Ik! Kushdo prej tyre që të pason ty, do të ketë si**

5. -shih. *Ihja ulumi'd-din*, Kairo, fq. 30-39.

6. -shih. Nisa, 4/38-39.

7. -shih. Araf, 7/16-17.

*Nëse njeriu e dëshiron shumë diçka, syri i tij nuk e sheh të drejtën dhe veshi i tij nuk e dëgjon të vërtetën. Ajo që e lajmëron njeriun për hyrjen e shejtanit në zemër, është drita e urtësisë.*

**shpërblim Xhehenemin; (ky është) një shpërblim i plotë. Bëj për vete, me zërin tënd, kë të mundesh nga ata! Lësho kundër tyre të gjithë kalorësinë e këmbësorinë tënde! Bëhu pjesë në pasurinë e në fëmijët e tyre dhe jepu premtime! -Premtimet e shejtanit janë vetëm mashtrime. Por në të vërtetë, ti nuk ke kurrfarë pushteti ndaj robërve të Mil..<sup>8</sup>**

Ajo që e hedh njeriun në kurthin e shejtanit, është mospërmendja e Allahut. Kush qëndron larg përmendjes së Allahut, sulmohet më lehtë nga shejtani. Edhe pse shejtani e devijon nga rruga e drejtë, ai pandeh se gjithçka është në rregull. Njeriu që është bërë shok me shejtanin, do ta kuptojë se sa shok i keq është ai, ditën kur të dalë përpara Allahut. Atë ditë ai do të thotë: **"Ah, sikur largësia midis meje dhe teje të kishte qenë sa ajo mes lindjes e perëndimit!"** Por më kot, sepse në atë moment do të jetë shumë vonë.<sup>9</sup>

Shejtani vazhdimisht e sulmon njeriun dhe në një mënyrë apo në një tjetër, merret me të gjithë. Madje edhe Ademi (a.s.), me Havanë, për shkak të kurthit të tij u dëbuan prej xhenetit. Prandaj, të krekosesh duke thënë se "shejtani nuk më bën dot gjë", është diçka pabazë dhe e pakuptimtë. Në Kuranin Fisnik, Allahu i Madhëruar shprehet se shejtani është munduar të ndërhyjë në çdo fjalë apo shpallje që u vinte pejgamberëve të tjerë para Pejgamberit tonë (a.s.).<sup>10</sup> Në të njëjtin kuptim me këtë, edhe Pejgamberi ynë (a.s.), ka thënë: *"Ndonjëherë më vijnë në zemër gjëra të tilla, saqë bëj istigfar (kërkoj falje) njëqind herë në ditë".<sup>11</sup>*

Egoja dhe shejtani e nxisin njeriun që edhe veprat t'i bëjë për hir të dikujt tjetër e jo për hir të Allahut. Në këtë mënyrë, ato synojnë të dëmtojnë besimin e vërtetë në zemrën e njeriut. Besimi i dobët dhe miqësia me shejtanin, e fusin njeriun në vështirësi të mëdha. Në lidhje me këtë, Melvana i nderuar ka thënë:

8. -Isra, 17/63-65.

9. -shih. Zuhruf, 43/36-38.

10. shih. Haxhaxh, 52.

11. Ahmed b. Hanbel, *Musned*, Kairo IV, fq. 211.

"Shejtani është qen. Ai hyn brenda mijëra personave. Tek cilido që hyn dhe zë vend, ai person bëhet shejtan. Ajo që të ftoh prej Allahut e të vërtetës dhe të pengon nga adhurimi, është shejtani brenda teje. Ai është fshehur brenda në lëkurë. Nëse shejtani nuk e gjen njeriun shejtan që do ta ndihmojë, hyn në imagjinatën tënde dhe të shtyn në gjynahe. Ai të sjell vërdallë në botën e imagjinatës dhe të bën t'i ndjekësh ato. Pastaj, shejtani vjen dhe të merr çdo mirësi shpirtërore që ke arritur të mbledhësh prej namazit, agjërimit dhe çdo mirësie apo adhurimi që ke bërë."<sup>12</sup>

Gjithmonë është diskutuar se; a janë egoja me shejtanin e njëjta gjë apo dy gjëra të ndryshme? Por me sa kuptohet, ato janë dy gjëra të ndryshme dhe që të dyja e ftojnë njeriun në vepra të këqija. Mirëpo, shejtani është një ftues i jashtëm, që mundohet ta orientojë njeriun në punë të këqija i kamufluor në një personalitet të ndryshëm. Ndërsa egoja, është ndjenja djallëzore që e mbështet nga brenda këtë thirrje të jashtme dhe shkon pas saj. Pra, ajo që e devijon njeriun nga brenda, është egoja. Kur egoja që mbi-zotëron robin devijon edhe të tjerët, atëherë ai bëhet shejtan. Shejtani është i përgjithshëm, kurse egoja është e veçantë për çdo person. Çdo ego ka një anë djallëzore, por është e pamundur ta cilësosh çdo shejtan si ego.

Zëri i brendshëm i çdokujt që thërret në të keqe, për vetë personin është ego, ndërsa për të tjerët është shejtan. Ky është kuptimi që nxirret edhe prej ajeteve dhe haditheve.

Njeriu punon dhe përpiqet në këtë botë. Prandaj, ai i ngjan prodhuesit që e mbush hambarin e tij me grurë. Mirëpo, prodhuesi që nuk e vë re miun që hyn në hambarin e tij, në fund ngelet duarbosh. Në të njëjtën mënyrë, nëse njeriu e lë shejtanin dhe egon t'i marrin zemrën, çdo punë e tij do të humbasë dhe do të ngelet duarbosh. Kështu që edhe kjo botë edhe bota tjetër kthehet në një humbje të hidhur. Allahu na ruajttë të gjithëve nga ky lloj përfundimi!

12. Mesnevi, III, b. 4326-4335.

# Islami është feja e dashurisë, paqes dhe qetësisë

Dr. Halls Ç. Demirxhan

Në periudhën e injorancës padrejtësia kishte arritur kulmin. Gjithashtu vihet re se këto sulme dhe dhunime u janë bërë edhe ithtarëve të parë të fesë islame.

Edhe pse ishin ballë për ballë me këto padrejtësi, Allahu Teala i urdhëroi besimtarët:

**“O ju që keni besuar! Bëhuni të durueshëm dhe nxiteni njëri-tjetrin të jeni të tillë; bëhuni të vendosur dhe vigjilentë (në vepra të mira dhe në ruajtjen e kufijve) dhe kijeni frikë Allahun, në mënyrë që të shpëtoni!”** (Al'Imran, 200) Gjithashtu na bën edhe këtë paralajmërim:

**“Nuk barazohet e mira me të keqen! Të keqen ktheje me të mirë e atëherë armiku yt do të të bëhet menjëherë mik i ngushtë.”** (Fussilet, 34)

Në të vërtetë, i Dërguari i Allahut, (a.s.), lëroni derdhjen e gjakut të myslimanit, por e shikonte të papranueshme edhe vrasjen e grave, fëmijëve dhe të moshuarve jomyslimanë që nuk luftonin kundër myslimanëve, vrasjen e klerikëve që preokupoheshin me ibadetet e tyre, madje nuk pranonte që të shkatërroheshin faltoret, të priteshin pemët dhe të vriteshin kafshët edhe në kohë lufte.

Krahas gjithë kësaj tolerance, i Dërguari i Allahut, (a.s.), bënte paralajmërim, sikur po njoftonte për ngjarjet që do të ndodhnin në të ardhmen, duke treguar padrejtësitë e kohës së injorancës:

**“O njerëz! Jeta juaj, pasuria juaj dhe nderi juaj janë të shenjta dhe të mbrojtura nga çdo lloj sulmi, siç janë të shenjta këto ditë, muaj dhe qyteti juaj.**

**Shokët e mi! Nesër do të dilni në audiencën e Zotit tuaj dhe do të pyeteni për gjendjen dhe veprat tuaja të sotme. Kini kujdes dhe mos e vrisni njëri-tjetrin pas meje duke u kthyer në devijimet e kaluara.”** (Shpjegimi i Sahihu'l-Buhari, Përkthimi i Tedrixhu's-Sarih, vëll. X, nr: 396.)

Në ditët e sotme, në të gjithë botën dhe veçanërisht në vendet islame që ndodhen në lindjen e mesme, po përjetohen luftëra që të kujtojnë periudhën e injorancës në të cilën përdorej dhuna, imponimi dhe shkelja e të drejtave të njeriut. Të moshuarit, gratë dhe fëmijët që janë viktima të këtyre luftërave, po nxirren nga vendet e tyre dhe po detyrohen të emigrojnë.

Sa shumë të bën të mendosh ky ajet fisnik i cili sikur është zbritur për ta shpjeguar këtë gjendje:

**“Mirëpo ja tek jeni, duke vrarë farefisn tuaj, duke i dëbuar disa syresh nga shtëpitë e veta dhe duke ndihmuar njëri-tjetrin kundër tyre, fajësisht dhe armiqësisht. Dhe, kur ju vijnë të robëruar, ju i shpëtoni nga robëria me të holla, ndërkohë që me marrëveshje**

**e keni të ndaluar t'i dëboni. Mos vallë, një pjesë të Librit (Teuratit) e besoni, kurse pjesën tjetër e mohoni? Cilido prej jush që vepron kështu, do të ndëshkohet me poshtërim në këtë jetë, ndërsa në Ditën e Kiametit do të dërgohet në dënimin më të ashpër. Allahu nuk është i pavëmendshëm ndaj veprimeve tuaja.”** (Bakara, 85)

Për këtë arsye, terrori dhe dhuna, sido që të quhen, nuk kanë asnjë lidhje të afërt apo të largët me Islamin. Andaj, t'ia veshësh Islamit këto veprime barbare është krejtësisht e pamundur.

Përkundrazi, feja jonë shprehet se të gjithë besimtarët janë vëllezër dhe ua ka ndaluar atyre në formë të prerë çdo lloj anarkie, prishjeje, shkatërrimi, dhunimi apo torture, shkurtimisht çdo lloj terrori dhe tiranie siç thuhet edhe në ajetin fisnik: **“Në të vërtetë, besimtarët janë vëllezër, andaj pajtojini vëllezërit tuaj midis tyre dhe kijeni frikë Allahun, në mënyrë që ju të mëshiroheni.”** (Huxhurat, 10) Gjithashtu, feja islame e konsideron vrasjen e një njeriu si vrasjen e të gjithë njerëzimit. Në të njëjtën mënyrë, edhe shpëtimin e një jete e pranon si shpëtimin e të gjithë njerëzimit.

Me një shprehje tjetër, feja islame dhe morali i Kuranit nuk janë mbështetës të terrorizmit dhe të terroristëve, por janë zgjidhja e vetme që mund ta shpëtojë tokën nga fatkeqësia e terrorizmit.

Së fundi, nëse sot ka veprime dhe mendime si dhuna, imponimi dhe shkelja e të drejtave të njeriut në shoqëri-në islame, këto nuk janë gabimi dhe mangësia e Islamit, por të myslimanëve.

Ndërsa mënyra më e favorshme për të shpëtuar nga ky gabim është marrja për referencë e fetarëve të ndërgjegjshëm dhe e literaturave të sakta fetare.

Në të kundërt, do të shkaktohet një situatë që e mërzit shumë të Dërguarin e Allahut (a.s.).

Pejgamberi thotë:

**“Besimtarët janë si një trup i vetëm në dhembshuri ndaj njëri-tjetrit, në dashuri ndaj njëri-tjetrit dhe në mëshirë ndaj njëri-tjetrit. Kur ndonjë organ i këtij trupi të ndjejë dhimbje, edhe organeve të tjera u ikën gjumi dhe e ndjejnë fort të njëjtën dhimbje.”** (Buhari, Edeb, 27; Muslim, Birr, 66.)

Lus Allahun e Lartësuar që të gjithë besimtarët të bëhen si një trup duke ndjerë dhembshuri për njëri-tjetrin, duke e dashur njëri-tjetrin dhe duke e mëshiruar njëri-tjetrin!

# FJALA E BUKUR

## shenjë e pjekurisë shpirtërore

B. Xhahit Ozdemir

Allahu i Madhëruar ka krijuar njeriun në mënyrë speciale. Pastaj e bëri atë mëkëmbësin e Tij në Tokë. Ndryshe nga krijesat e tjera, e pajisi atë me virtyte dhe aftësi. Njeriu i shfaq në dy mënyra cilësitë shpirtërore që përbëjnë personalitetin e tij: përmes shprehjeve dhe sjelljeve.

Shprehja me fjalë e botës së brendshme të njeriut, bëhet përmes organit të gjuhës që gjendet në gojë. Duke u nisur nga ideja se “çfarë ke brenda dukesh nga jashtë”, ajo çfarë është brenda në shpirt, shprehet me gjuhë. Mirëpo, si një shprehje konkrete, cilësitë e botës së brendshme i atribuohen gjuhës; gjuhëbilbil, gjuhëbrisk, gjuhëgjarpër, gjuhëgjatë, gjuhëhelm, gjuhëlidhur etj. Në këtë kontekst, tregohet një tregim:

Një njeri i pasur, për një mysafir që do vinte tek ai, të cilin nuk e donte, kërkon nga shërbëtori që t'i bënte ushqimin më të keq të mundshëm. Kështu shërbëtori i përgatiti gjellën e gjuhës. Një ditë tjetër, që po prishte t'i vinte miku i tij që e donte, kërkoi nga shërbëtori që t'i përgatiste ushqimin më të mirë të mundshëm. Shërbëtori sërish kishte përgatitur gjellën e gjuhës. Kur zotëria kërkoi të dinte arsyen, ai u përgjigj:

“Gjuha është më e ëmbla dhe më e keqja gjë në botë, por varet nga përdorimi.”

Çështja se çfarë duhet të ketë njeriu si synim në jetë, ka qenë një nga preokupimet kryesore të njeriut që në kohët e lashta. Ekzistojnë mjaft mendime të filozofëve që kanë vlarë mendjen lidhur me këtë temë. Mirëpo, shprehja më e saktë lidhur me qëllimin e jetës, brenda konjunkturave të detyrës së shenjtë që ka bartur në vete njeriu, janë fetë hyjnore ato që kanë shënuar drejtimin e saktë që të çon tek lumturia. Madje duke e thjeshtëzuar atë përmes personaliteteve shembullore. Pasi, njeriu i parë që është krijuar është edhe pejgamberi i parë. Natyrisht nga këto fe hyjnore sot ka mbetur vetëm feja e fundit, Islami, të tjerat kanë hu-

mbur originalitetin e tyre duke u prishur nga mendje me interesa të caktuara. Porsi një frymëzim nga burimi hyjnor, qëllimi i jetës në fjalën e bukur, shpjegohet si “Kesbi kemal ederek, seyri cemale ermek”, pra “Të arrish të shikosh të bukurën, duke fituar pjekuri.”

Allahu i Madhëruar, udhërrëfyesit për njerëzit i ka zgjedhur nga mesi i njerëzve, kështu Ai ka promovuar sistemin e vlerave të kumtit hyjnor, duke u dhënë atyre mundësinë për të qenë personalitete më të përsosura; shpërblimi më i bukur është të mund të arrish tek Xhemalullahu. Mirëpo, ndonëse ekziston “Udhërrëfyesi Hyjnor” me cilësinë “shembulli më i përsosur”, i cili përmes përjetimit të tij, njerëzimit i ka edukuar fenë e shpallur nga Zoti, sidoqoftë nuk është edhe aq e lehtë të meritojë këtë sihariq. Meqë jeta është një sprovë e tërë, bashkë me urtësinë e saj, njeriu është pajisur me pengesa të fuqishme si nefsi dhe shejtani, që e bëjnë atë të pengohet nga kjo rrugë sublime. Ajo çfarë i takon njeriut është që brenda kornizave të asaj çfarë i lejohet të mund të arrijë në shpëtim. Një njeri që arrin në një cilësi të tillë të sinqertë, bën që të fitojë shpërblimin më të madh që i është premtuar.

Kelami, që është një nga cilësitë e Allahut, është një veçori që vetëm njeriut ia ka dhënë Zoti në mesin e krijesave të tjera. Fjala më e bukur është fjala e Allahut, që është Kurani Famëlartë. (Shih, Zumer, 23.)

Fjala e bukur ndikon tek njeriu që mban ndjenjën e simpatisë ndaj së bukurës në mënyrë të natyrshe (fitri), kështu bën që ajo të shfaqet. Lidhur me këtë kemi edhe fjalë të urta, si: “Fjalëmbli, nxjerr nga strofulli edhe gjarprin.” Edhe kafshët që janë të nevrikosura madje, duke u thënë fjalë të ëmbla, qetësohen. Kështu, njerëzit gjithnjë janë marrë me artin e fjalës së bukur dhe fjalës me ndikim. Kësisoj, lindën edhe arti i retorikës dhe oratorisë, që janë një metodë përpjekjeje për të thënë fjalë të bukura dhe me ndikim tek të tjerët. Me impaktin që është krijuar ndaj këtyre arteve, janë

edukuar shumë letrarë dhe oratorë, që ende sot u përmenden emrat.

Politeistët mekas, ngaqë e dinin fuqinë e ndikimit të fjalës së bukur dhe vetëm për shkak të interesave të tyre të ngushta i dolën kundër kumtit profetik të Pejgamberit të dashur (a.s.). Megjithatë, nuk arrinin dot të mbanin veten pa dëgjuar Kuranin Famëlartë fshehurazi teksa lexohej, ndërkohë që të tjerëve ua ndalnin me forcë. Edhe Omeri (r.a.), kur pati marrë rrugën për të shkuar tek Pejgamberi (a.s.) dhe për ta ekzekutuar atë, kur dëgjoji versetet kuranore në shtëpinë e së motrës së tij, papritur besoi, doli si një besimtar nga aty i impresionuar nga entuziazmi i papërshkruar që i dha Nuri i Qenies.

Në Kuranin Famëlartë, lidhur me fjalën e bukur, retorikën dhe oratorinë, thuhet kështu:

**“Vallë, a nuk e sheh se si Allahu e përqs fjalën e mirë me pemën e mirë, e cila rrënjën e ka të fortë në tokë, kurse degët nga qielli? Me lejen e Zotit të saj (pema) jep fruta në çdo kohë. Allahu u tregon shembuj njerëzve, që t’ua vënë veshin. Fjala e keqe është si pema e keqe me rrënjë të shkullura, e paqëndrueshme për ekzistencë.”** (Ibrahim, 24, 25, 26.)

**“Thuaju, robërve të Mi, që të flasin atë që është më e mira...”** (Isra, 53.)

Dhe në hadithe thuhet kështu:

“Fjala e bukur dhe e mirë është sadaka. Ruajuni nga zjarri i Xhehenemit, duke u dhuruar njerëzve qoftë edhe një gjysmë hurme (arabe), nëse nuk mundeni as këtë, atëherë dhurojuni atyre fjalë të bukura.” (Buhariu, vol. 13, f. 6013.) Kështu është këshilluar gjithnjë fjala e bukur.

Njeriu është përgjegjës për fjalën që i del nga goja. Për të bërë të ditur këtë përgjegjësi, Aliu (r.a.), ka thënë:

“Për sa kohë që nuk flet, fjalën e ke nën kontrollin tënd. Pasi të flasësh, atëherë të ka ajo nën kontroll ty.” Kështu, edhe fjalët e urta qortojnë njeriun në këtë mënyrë:

“Nëse të flasësh është argjend, të heshtësh është flori.”

“Mendo një mijë, një thuaj!”

“Fjala që thua, mos të të bëjë pishman kur miku yt të bëhet armik dhe mos të turpërojë kur armiku yt të bëhet mik.”

Padyshim që çështja nuk është vetëm tek heshtja, por të dish të flasësh dhe të mos flasësh në kohën e duhur. Pejgamberi ynë, Muhamedi (a.s.), ka thënë lidhur me këtë temë:

“Kush i beson Allahut dhe Ditës së Ahiretit, ose të flasë mirë, ose të heshtë.” (Buhariu, Kitabul-Edeb, 10/373.)

“Nëse një njeri heq dorë nga gjërat e të tjerëve që nuk i takojnë atij, kjo rrjedh si pasojë e mirësisë së Islamit të tij.” (Tirmidhiu, Zuhd, 11.)

Një nga mjeshtrit shpirtërorë të Anadollit, Junus Emre, e shpjegon në këtë mënyrë se çfarë është të flasësh:

“Ka fjalë që ndërpret luftë, ka fjalë që pret kokë, ka fjalë që gjellën e helmuar e bën mjaltë e gjalpë!”

Pejgamberi (a.s.), është “shembulli më i mirë” që bën të fitohet lumturia e kësaj bote dhe tjetrës. Jeta e tij e begatë që përkufizohet si “Kuran i gjallë”, është porsij një nur që shndrit horizontin e të gjithë besimtarëve të sinqertë. Kësisoj, sahabët fisnikë, në përpjekje për t’i ngjarë atij në të shprehur e sjellje, kanë krijuar shoqërinë e Epokës së Lumtur. Kështu, edhe Miqtë e Zotit të Madhëruar, evlijatë, të cilët kanë ndjekur rigorozisht ata dhe edukatën pejgamberike, kanë parashtruar praktikimin e traditës profetike (sunneti senijje) si lumturinë më të madhe të njeriut.

Ebu Bekri (r.a.), i cili pati merituar epitetin “Yar-i Gar; I dyti i dyshes” dhe që qe shkrirë në atë Nur të Qenies, thuhet se kishte kapur fort gjuhën e vet, që të mos gënjente, të mos bënte thashetheme e përgojonte dhe që të mos bënte faje të tjera karakteristike të gjuhës, madje kishte vënë edhe gurë në gojë, me qëllim që të ndalonte të folurit, nga frika e pasojës së gjuhës. Të flasësh me karar, do të thotë të mos hapësh gojën për tjetër veçse për mirë, të mos përdorësh fjalë të panevojshme, të heshtësh, të shprehësh të vërtetat në mënyrën më të shkurtër të mundshme, në mënyrën më racionale dhe më të bukur, si dhe metoda të tjera profetike janë bërë shenjat e përgjithshme të edukatës së komunikimit të besimtarëve të vërtetë.

Miqtë e Zotit, porsij përfaqësuesit dhe mëkëmbësit e Pejgamberit, Muhamedit (a.s.), detyrën e tyre si udhëzues në fenë e vërtetë e kanë kryer me këtë përkushtim dhe përkujdesje. Lidhur me elegancën në komunikimin e tyre, Mjeshtri Nexhip Fazëlli konstaton në këtë mënyrë:

“A keni dëgjuar ju ndonjëherë të bërtasë e të thërrasë një argjendar? Mallrat e tij të çmueshme bëjnë që ai të mos thërrasë. Shitësi i domateve dhe i specave bërtet, por argjendari jo. Mbledhësi i gjërave të prishura thërret, por ai i gjërave me vlerë, jo!”

Fjala e bukur është një shenjë e përsosmërisë, e pjekurisë shpirtërore. Sa më shumë që njeriu të jetë bërë një me Kuranin Famëlartë dhe me Traditën Profetike, sa më mirë të jenë shfaqur tek ai ky sistem vlerash hyjnore, aq më shumë ka arritur përsosmërinë dhe pjekurinë, aq më mirë shprehet.



# Ai që nuk interesohet për të tjerët është i pafat

Mehmet Lutfl Arslan

Ai që u shërben të tjerëve dhe e konsideron këtë si një mundësi për ta falënderuar Zotin (xh.sh.), do të thotë se e ka gjetur rrugën e duhur drejt pafundësisë. Kurdo që i japim përparësi vetes sonë, atëherë fillon edhe ngushtimi në zemër. Kur zemra fillon të ngushtohet, lihem i dorë të nefsit tonë. A ka më keq se ai që lihet në dorën e nefsit të tij? Sa fatkeq është ai që nuk interesohet përveçse për veten e tij!

Kur i riu u ngrit atë ditë i shqetësuar, mendoi se brenda kishte një ngushtim prej një kohe të gjatë.

“U bënë shumë kohë që nuk shkoj te i urti. Mos vallë po më ndodh nga kjo?”

Ai nuk kishte asnjë mendim se përse nuk kishte shkuar, por nga brenda nuk i vinte për të shkuar. Këtë nuk mund ta shpjegonte në asnjë mënyrë. Në të vërtetë, shumë herë pati bërë plane për të shkuar, por asnjëherë nuk arriti t'i realizonte.

Befasisht ndodhi diçka. Menjëherë u ngrit nga vendi dhe u përgatit shpejt. Ndërkohë nuk arrinte ta shpjegonte se çfarë po bënte dhe përse po e bënte. Në fakt, këtë nuk e kishte aspak si qëllim.

Pas pak gjendej pranë të urtit. Kur i urti e pa, vetëm buzëqeshi. I tregoi vendin për t'u ulur dhe përsëri u kthye te libri në të cilin zhytej plotësisht.

Ndërkohë që i riu po e shikonte atë, filloi të kontrollonte pak veten e tij. Tashmë nuk kishte ngelur ndonjë gjurmë nga ajo gjë që ia gërvishte zemrën, që ia dridhte atë si bishti i nepërkës dhe që ia bënte të dyshonte. Ndoshta një çast u mahnit, deshi të kërkonte ndonjë shpjegim, madje deshi ta kapte dhe ta pyeste. Por pastaj hoqi dorë fare dhe nuk e bëri diçka të tillë. “Kjo është tërheqja e gjakut.” – tha dhe ia la veten rrymës së ujëvarës që filloi të rridhte në brendësinë e tij.

Më vonë, pas asaj ndarjeje të gjatë, befasisht do t'i thoshte se nuk mund t'i shpjegonte aspak ato që gjeti pranë të urtit. Sa shumë luftëra ndodhnin brenda tij kur

ishite larg të urtit! Sa shumë beteja pati bërë mendja me zemrën e tij! Këtë e dinte vetëm ai. Kur qëndronte vetëm, mendonte se mendja e tij fitonte në të gjitha këto luftëra.

“Ja, për këtë arsye nuk mund të shkoj...”

Por kur befaz u ngrit e iku dhe kur mendja e çdo gjë që më parë pati fantazuar nuk e ndaluan dot, çdo gjë u kthye ndryshe. Në të vërtetë, kush ishte ai që kishte fituar këtu? Lëreni fare se kush kishte fituar, në të vërtetë, ishte mendja e tij ajo që kishte humbur. Si mund ta shpjegonte në një mënyrë tjetër këtë ardhje që ia shkatërronte të gjitha ato mendime e fantazi që pati bërë më parë? Aty kishte diçka që e kalonte atë. Diçka tjetër përtej thirrjes... Diçka që nuk e njihje aspak vullnetin dhe që vinte duke gufuar nga zemra...

Një herë deshi t'i thoshte vetes: “Mos vallë duhet të më shpien dhe të më vendosin në vendin që duhet të gjendem? Nuk jam i sigurt...” Me të vërtetë nuk ishte i sigurt, sepse nuk arrinte dot t'ia dilte mbanë sado që përpiquej ta shpjegonte. Nuk arrinte t'ia dilte mbanë, sepse nuk mund të bënte dot përkufizimin e duhur. Kërkimi i fjalëve për ato që kishte përjetuar dhe për ato gjëra që kishte arritur me eksperiencë, ishte sikur të ecte lakuriq ndërmjet njerëzve për të kërkuar rroba. Ndër të tjera, ajo që kishte gjetur nuk i tregonte gjë dhe e mashtronte. Në ato momente iu kujtua përsëri diçka që kishte dëgjuar nga i urti:

“Kur bëhet fjalë për të vërtetën, fjalët nuk mund ta shpjegojnë, por vetëm mund ta shikojnë...”

Pasi i riu kishte në sytë dhe në zemrën e tij të urtin, i urti e filloi fjalën sikur e dinte sa çfarë po mendonte i riu. I ngriti vetullat, kokën e uli pak dhe po e shikonte përmbi syzet e tij:

-Ku ke humbur?

I riu e uli kokën, ngaqë u turpërua dhe i tha:

-Nuk arrita të vija në asnjë mënyrë.



-Mos vallë nuk deshe të vije?

-Në të vërtetë desha, por...

-Domethënë, nuk deshe që të donte Ai...

I riu e ngriti kokën i mahnitur. I urti buzëqeshi nga kënaqësia që i dha reagimi që priste nga i riu dhe i tha:

-Ne nuk mund të duam pa dashur Ai. Për këtë arsye, nëse duam të bëjmë diçka, duhet të duam që të dojë Ai. Ne kësaj i themi qoftë e hajrit. Gjëja më e hajrit është ajo që do Ai.

Heshti, sepse nuk donte të fliste më shumë në lidhje me këtë çështje. Andaj mendonte se ky nuk ishte fati i asaj dite. Të gjithë kanë mundësi për të folur sipas kohës, kapacitetit dhe fatit të tyre. Siç përgatitet kësmti dhe na vendoset përpara me anë të dikujt, edhe mundësitë për të folur na vijnë me mënyra të caktuara. Edhe fjala do përpikëri dhe mjeshtëri si një gjellë e gatuar mirë. Ushqimet duhet të zgjidhen mirë, duhet të përgatiten mirë, duhet të gatohen mirë dhe duhen servitur me rregull. Njerëzit që gatuajnë fjalët duhet të jenë njerëz specialistë në lidhje me përdorimin e fjalëve. I riu gjithmonë pati dashur ta kishte një aftësi të tillë. Në të vërtetë, a nuk është sugjerimi i të Dërguarit të Allahut (s.a.s.), që t'u flasim njerëzve aq sa mund të perceptojnë?

I urti më shumë ishte i shqetësuar për qëndrimin e gjatë larg tij që i riu kishte bërë:

-Nuk munde të vije, sepse gjithmonë nuk kemi mundësi të vijmë e të shkojmë. Nganjëherë zemra na zgjerohet aq shumë, sa që mund ta nxërë të gjithë botën brenda. Ndërsa nganjëherë ngushtohemi aq shumë, sa që nuk mund të nxëmë brenda as veten tonë.

I urti e pa të riun sikur po maste masën e ndikimit të fjalëve të tij te ai. Kureshtja që e kishte kapluar të riun, dukej qartë në fytyrën e tij.

-Ti nuk mund t'ia caktosh erës drejtimin në të cilin duhet të fryjë, por mund të caktosh ndikimin që ajo mund të të lërë.

I riu nuk ishte shumë i sigurt për këtë. Kur dëgjonte diçka që mendja nuk ia pranonte, nuk mund ta ndalonte vrenjten e fytyrës. Përsëri kështu ndodhi. Kjo nuk i iku as të urtit pa e parë:

-E rëndësishme nuk është se kush do të vijë, por si do të na gjejë ai që do të vijë. Vullneti ynë nuk mund ta caktojë atë që do të vijë, por mund të caktojë se si do të sillemi ndaj atij që do të vijë. Nëse i kemi në dorë frenat e vullnetit tonë, mysafiri, qoftë i mirë apo i keq, vjen me të mirë, ndjehet mirë përgjatë qëndrimit dhe largohet i lumtur. Nëse i mbajmë në dorë frenat e vullnetit, vjen një ditë dhe na jepet mundësia për të zgjedhur ngushtimin apo zgjerimin e zemrës sonë.

I riu e ktheu kokën lehtë nga ana e djathtë. I urti i

buzëqeshi kësaj lëvizjeje që do të thoshte "nuk e kuptova" dhe tha:

-Sigurisht që është ashtu. Ti mund ta zgjedhësh edhe ngushtimin, edhe zgjerimin e zemrës. Mjafton që ta sundosh vullnetin tënd. Çdokush që të vjen, konsideroje sikur të vjen nga Ai. Andaj, atë që të vjen nga Ai, respektoje siç duhet respektuar. Mos e prish ekuilibrin ndaj asnjë mysafiri, sepse ne nuk mund ta dimë se te cili është mirësia.

Ai e ngriti dorën dhe ia vendosi te kraharori:

-A do më pyesësh se çfarë preferoj unë?

I riu u bë kureshtar. Ndërkohë që po thoshte "po" me lëvizjen e kokës, edhe po buzëqeshte. I urti vazhdoi:

-Unë e përdor ngushtimin ndaj vetes sime, ndërsa zgjerimin e përdor për të tjerët. Prandaj preferoj të jem i ngushtuar kundrejt vetes sime dhe i hapur kundrejt të tjerëve.

Kur i riu habitej, gjithmonë belbëzonte pak. Përsëri kështu ndodhi:

-Si, si arrini ta bëni këtë?

-Kur fryn era e ngushtimit të zemrës, e di se ka ardhur koha e marrjes së vetes në llogari. Andaj, menjëherë kthehem dhe e marr veten në llogari. Nëse zemrën e kam të ngushtë, patjetër që kam gabuar ndaj dikujt ose kam bërë ndonjë gjë gabim. Kështu që kërkoj falje, sepse kjo është koha kur duhet të qëndroj me veten dhe kur duhet t'i përgjërohëm Allahut të Lartësuar.

-Po kur e ndjeni zemrën të zgjeruar?

-Atëherë është koha e falënderimit dhe shërbimit. Kështu që i gëzoj të tjerët, u jap dhe i ndihmoj. Kjo është koha kur duhet t'i ndihmoj të tjerët dhe të falënderoj Allahun e Madhëruar.

Kur i riu po largohej nga i urti, po mendonte se përse nuk mund ta dimë kur dhe si mund të fryjë era. Papritur ndjeu një lëvizje nga brenda, mendja iu ndriçua dhe hapat filloi t'i hidhte më shpejt prej emocionit që i jepte arritja e perceptimit të një gjëje të re. Atë ditë shkroi këto rreshta në ditarin e tij:

"Nëse shërbimi ndaj njerëzve dhe falënderimi ndaj Allahut Teala bëhet vazhdimisht, edhe zemra vazhdimisht do të jetë e zgjeruar dhe e lumtur. Si rezultat, gjithmonë vazhdon të hapet. Ai që u shërben të tjerëve dhe e konsideron këtë si mundësi falënderimi ndaj Allahut të Madhëruar, do të thotë se e ka gjetur rrugën e hapjes drejt pafundësisë. Kurdo që i japim përparësi vetes sonë, atëherë fillon edhe ngushtimi i zemrës. Kur zemra fillon të ngushtohet, lihem i në dorë të nefsit tonë. A ka më keq se ai që lihet në dorë të nefsit të tij? Sa fatkeq është ai që nuk interesohet përveçse për veten e tij!"



# Xheneti NË SHTËPITË TONA

Fillimi i njerëzimit ishte familja. Zoti (xh.sh.), deshi që jeta mbi tokë të fillonte me Ademin (a.s.), dhe Havanë, pra me një familje.

Rituali i haxhit të kujton rëndësinë e familjes. Safa-ja dhe Merva-ja janë dy kodra të cilat na kujtojnë mundin e një nëne për t'i siguruar djalit të saj ushqim dhe ujë në një zonë të shkretë. Ajo (Haxherja) vraponte mes dy kodrave në kërkim të dikujt që ta ndihmonte të shuante etjen e foshnjës së saj.

Me qëllim që të ndërtojmë marrëdhënie familjare të shëndosha, ashtu siç dëshiron dhe kënaqet Zoti (xh.sh.), këto marrëdhënie duhet të kenë si bazë dhembshurinë dhe mëshirën mes familjarëve.

Allahu (xh.sh.), thotë: ***"Dhe një prej shenjave të Tij është që prej jush krijoi për ju bashkëshortet tuaja, që të qetësoheni pranë tyre, duke vënë ndërmjet jush dashuri dhe mëshirë. Me të vërtetë, në këtë ka shenja, për njerëzit që mendojnë"***. (Rum, 21)

Pasi Omeri (r.a.), ishte bërë Prijësi i Besimtarëve, një burrë shkollë të ankohet tek Ai për të shoqen e cila ia kthente fjalën. Por me t'u afruar tek dera e shtëpisë, dëgjoji zërin e gruas së Omerit e cila e kritikonte të shoqin. Ai u shtang nga kjo që i dëgjua veshët dhe menjëherë mori rrugën e kthimit. Në atë çast, rastis që Omeri hap derën të dalë jashtë dhe sheh personin në fjalë duke u larguar. Ai e thërrret dhe e pyet nëse e kishte sjellë ndonjë nevojë. Burri, i zënë ngushtë, i thotë: "Erdha të ankohem për gruan time, por kur pashë se si silllej gruaja jote me ty, e lashë atë muhabet dhe vendosa të kthehem". Omeri i thotë: "O filan! Ajo më duron gjatë gjithë kohës, më gatuan ushqimin, më lan rrobat dhe përkujdeset për fëmijët. Përse të mos e duroj edhe unë kur e ngre zërin?"

Në një transmetim të vërtetë thuhet se kur Omeri (r.a.), ka marrë pushtetin në Medinë dy vjet nuk ka shkuar asnjë njeri për t'u ankuar në gjykatë nga frikë që kanë pasur ndaj tij. Pasi e mori vesh këtë gjë, për çështjet e gjykatës caktoi Aliun (r.a.). Por ky Omer në familje ishte krejt tjetër.

Njeriu duhet të jetë realist, jo idealist. Nëse ti nuk je perfekt mos kërko që bashkëshortja jote të jetë perfekte. Vogëlsirat mes çiftit iblisi i zmadhon.

Misioni i shejtanit në këtë jetë është shkatërrimi. Ai mundohet të shkatërrojë fenë, moralin, marrëdhëniet ndërmjet njerëzve, bashkëjetesën, vëllazërinë dhe gjithçka tjetër që përmban mirësi. Çdo ditë ai dërgon dërgues dhe ushtarë për të përmbushur detyrat me të cilat ai i ngarkon.

Pejgamberi (a.s.), ka thënë: *"Me të vërtetë Iblisi e vendos fronin e tij mbi ujë, pastaj dërgon grupet e tij në drejtime të ndryshme. Ai që ka pozitën më të afërt tek ai, është ai që bën sprovën më të madhe. Kur njëri prej tyre vjen tek ai dhe i thotë se kam bërë këtë gjë dhe atë gjë, ai i thotë: "Ti nuk ke bërë asgjë." Kur një tjetër vjen dhe thotë: "Unë nuk e lashë atë, deri sa e bëra që të ndahej nga gruaja e tij", ai e merr atë pranë vetes dhe i thotë: "Sa i mirë je!"* (Muslimi)

Në hutben e lamtumirës Pejgamberi (a.s.), ka lënë porosi të shumta. Ndër to mund të përmendim: *"Ju porosis dhe ju lë emanet të silleni mirë me bashkëshortet tuaja se i keni emanet prej Zotit, i keni marrë me besë dhe me leje të Zotit."*

Zoti (xh.sh.), thotë: ***"...Jetoni e silluni mirë me to...!"*** (Nisa, 19) Dhe kjo nuk do të thotë vetëm që të mos e lëndosh dhe silllesh keq me bashkëshorten, por edhe t'a durosh atë në rast se të lëndon. Të durosh gabimet e saj, nervozizmin etj... Pejgamberi (a.s.), ka thënë: *"Silluni mirë me gratë tuaja."* (Tirmidhiu)

**Për të qenë një familje xheneti në këtë botë duhen bërë këto gjëra:**

*Rinovimi i jetës bashkëshortore.*

Nuk duhet lënë që jeta bashkëshortore të plakët. Duhet të ecim me kohën. Jepi nuses një lule, dergoji një sms, bëji dhurata të ndryshme, në mënyrë që martesja të ripërtërihet. Pejgamberi (a.s.), ka thënë: *"Imani vjetërsohet në zemrat tuaja, sikurse vjetërsohet rroba, andaj ripërtëriini"*

*imanin tuaj*" (Imam Ahmedi)

Romantizmi duhet të jetë pjesë e jetës bashkëshortore. Perpiquni herë pas here që atmosfera midis jush të jetë romantike, me përkëdhelje dhe të qeshura.

Lexoje me vëmendje këtë hadith të të Dërguarit të Allahut (a.s.), që e përcjell Ebu Hurejra: "E pyetën Pejgamberin (a.s.), se cila është gruaja më e mirë dhe ai tha: "Është ajo që të fal kënaqësi kur (bashkëshorti i saj) e vështron, i bindet atij kur e urdhëron, nuk e kundërshton dhe as nuk e shpenzon pasurinë në diçka që ai nuk e pëlqen." (Nesaiu)

Duhet që të kemi takime familjare të paktën një herë në javë.

*Fal dhe tolero kur tjetri gabon.*

Transmetohet nga Enes ibn Malik (r.a.), se i Dërguari i Allahut, (a.s.) ka thënë: "A doni t'ju lajmëroj për gratë tuaja në Xhenet (d.m.th. ajo grua që e përgatiti veten e saj për Xhenet, me anë të moraleve dhe cilësive të larta)?" Pastaj vazhdoi: "Ajo grua e dashur që lind shumë, kur zemërohet me të bashkëshorti dhe sillet keq ndaj saj, ajo thotë: "Dora ime është me dorën tënde, nuk mund t'ia lejoj vetes që të mbyll sytë e qetë, derisa ti të jesh i kënaqur me mua." (Taberaniu)

*Ruajtja e sekreteve familjare.*

Dalja e sekreteve familjare është shkak për prishjen e familjes. Nëse doni që të keni sukses në familje, ruani sekretet familjare. Pejgamberi (a.s.), ka thënë: "Njeriu më i lig ndër njerëz dhe me pozitën më të ulët në Ditën e Gjykimit para Allahut, është ai njeri i cili e shpalos sekretin e bashkëshortes së vet dhe pastaj e hap atë." (Muslimi) Këtë e argumentojmë në atë se çka ka ndodhur me Profetin (a.s.), kur i ka zbritur shpallja. Ka qenë Hadixheja (r.a.), që më së shumti e ka dashur Profetin (a.s.). Çështja e shpalljes ka qenë shumë e rrezikshme në atë kohë, sepse ka qenë një ndryshim i historisë së njerëzimit. Me gjithë këtë, Pejgamberi (a.s.), ia ka zbuluar këtë fshehtësi gruas së tij. Nuk ka thënë se ajo nuk i mban sekretet se është grua, por ka qenë personi i parë që profeti ia ka zbuluar këtë fshehtësi.

*Gjërat duhet të thuhet, jo të mbahen përbrenda.*

Imam Shafiu ka një thënie të artë lidhur me ndryshimet dhe mosmarrëveshjet mes njerëzve, ku thotë: "Mendimi im është i drejtë, por mund të jetë dhe gabim. Sakaq mendimi i kundërshtarëve të mi është i gabuar, por që mund të jetë dhe i drejtë."

*Që të jetë jeta bashkëshortore sa më e mirë duhet që t'i kushtosh rëndësi paraqitjes.*

Ibn Abasi (r.a.), deti i dijes dhe komentatori i Kuranit, kur kthehej nga një udhëtim nuk shkonte direkt në shtëpi, por rregullohej, parfumosej, lahej etj. Kur e pa njëri nga nxënësit e tij i bëri përshtypje dhe e pyeti përse vepron kështu. Ai i tha: "Unë dua që të zbukurohem për gruan time, siç dua që ajo të zbukurohet për mua." (Ibn Xherir)

*Shikonitë tjerët që janë poshtë jush, jo ata që janë mbi ju.*

Mos krahasoni veten tuaj apo njëri-tjetrin me të tjerët.

Profeti (a.s.), ka thënë: "Mos i shikoni ata që janë më lart se ju. Shikoni ata që janë më poshtë se ju, se kështu më shumë do të kujtoni mirësitë e Allahut të dhuruara mbi ju." (Buhari, Muslim)

Duhet bërë kujdes për gjërat që burri i ka merak, i ka pikë të dobët, po ashtu edhe burri për ato gjëra që gruaja i ka pikë të dobët.

Pejgamberi (a.s.), ka thënë: "Kur njeriu të hyjë në shtëpinë e tij dhe të ulet për të ngrënë ushqimin e tij përmend Allahun, shejtani do t'u thotë shejtanëve të tjerë: 'Nuk ka vendstrehim as ushqim për ju, prandaj largohuni nga kjo shtëpi'." (Muslimi)

Për të qenë një familje me vlerë duhet që problemet që ke jashtë familjes mos t'i futësh brenda familjes.

Në një familje duhet të mbizotërojë butësia. Nëse Allahu (xh.sh.), ia do të mirën një familjeje, në mesin e saj vendos butësinë. Pejgamberi (a.s.), i ka thënë nënës së besimtarëve: "O Aishe, bëhu e butë, sepse Allahu kur dëshiron të fusë mirësi në një familje i udhëzon të bëhen të butë". (Ahmedi)

Për të qenë një shtëpi vendbanim i melekëve nuk duhet që në të të ketë qen dhe figura. Pejgamberi (a.s.), ka thënë: "Engjëjt nuk hyjnë në ato shtëpi ku ka qen dhe figura." (Buhari, Muslim)

Melekët nuk futen në një shtëpi ku ka qen dhe figura, sepse qeni është i pistë, kurse figurat janë përngjasim me krijimin që bën Allahu (xh.sh.). Po ashtu e tillë gjë është përngjasim edhe me jobesimtarët, të cilët e kanë zakon të vendosin figura të ndryshme në shtëpitë e tyre dhe më pas t'i madhërojnë ato.

Disa dijetarë janë të mendimit që fotografitë të cilat bëhen me aparat nuk hynë te kjo ndalesë, sepse ato kanë procedurë tjetër në nxjerrjen e tyre. Në rastin e fotove bëhet fjalë thjesht për përcjelljen e figurës që pasqyrohet brenda aparatit, prandaj ato nuk futen në të njëjtin kërcënim dënimi.

Mbajtja e qenve brenda dhomave është një traditë e keqe dhe aspak e shëndetshme, që në kohën e sotme ka marrë përmasa në shumë shoqëri dhe kultura, fatkeqësisht edhe disa myslimanë të ndikuar nga këto kultura kanë filluar ta praktikojnë këtë traditë jo të mirë.

Arsyet të cilat lejojnë mbajtjen e qenve janë:

1. Mbajtja e qenit për gjueti.
2. Për ruajtjen e bagëtive, dhe
3. Për ruajtjen e kullosave dhe të mbjellave.

Këto tre raste janë të vërtetuara me citate sheriatike, ndërsa Imam Neveviu thotë se, nëse ekzistojnë edhe disa arsye të tjera të ngjashme, atëherë lejohet të mbahet qeni, sikurse ruajtja e shtëpisë, e rrugëve etj. Në këtë hyn edhe përdorimi i tyre në kriminalistikë për gjetjen e lëndëve narkotike etj.

## RËNDËSIA E DHËMBIT TË PJEKURISË

Shpesh herë mund të kemi dëgjuar ndonjë mjek të na thotë se dhëmballët e pjekurisë duhet ti heqim, pasi ata janë dhëmb të kotë, të cilët nuk kanë asnjë funksion, përveç se dalin shumë vonë dhe për më tepër, mund të jenë të dëmshëm për organizmin. Mirëpo, në bazë të disa kërkimeve të fundit, duket se gjërat në lidhje me dhëmballët e syrit kanë ndryshuar. Pra, çfarë është një dhëmb pjekurie? Ata janë katër dhëmbët të vendosur në pjesën më të pasme të gojës suaj dhe dalin shumë më vonë se gjithë dhëmbët e tjerë. Përgjithësisht, koha kur ato shfaqen në gojë është pas adoleshencës, dhe më saktësisht, pas të 20-ave. Sipas një publikimi shkencor, 67% e dhëmbëve të pjekurisë janë të panevojshme. Heqja e këtyre dhëmbëve është shndërruar në një biznes. Vetëm në SHBA, mbi 10 milion dhëmbë të pjekurisë hiqen çdo vit. Një thënie e vjetër thotë se këta dhëmbë shkaktajnë probleme me shëndetin, por në fakt nuk është aspak e vërtetë. Ato janë shndërruar në një biznes të madh në një industri nga e cila nxirren miliarda dollarë çdo vit.

**Pse duhen dhëmbët e pjekurisë?**

Dr. Weston Price ka studiuar shëndetin oral dhe sëmundjet e gojës që në vitin 1990. Ai ka hulumtuar dhe ka bërë kërkime të ndryshme tek ata persona, të cilët nuk kanë qenë asnjëherë tek mjeku për probleme dentale, e ka vënë re se gjendja e dhëmbëve të tyre ka qenë shumë e mirë. Ai nënvizon se shëndeti dental është shumë i rëndësishëm dhe lidhet drejtpërdrejtë me tretjen. Sipas mjekut, duhet stimuluar kocka me minerale dhe proteina, të cilat ushqejnë dhëmbët. Ai ka vënë re se dhëmbët e fiseve që nuk konsultoheshin me mjekët për shëndetin e tyre dentar, nisën të kishin probleme në momentin që njerëzit po konsumonin ushqime me florur të bardhë dhe sheqer. Sipas të dhënave, dhëmballët e pjekurisë janë të nevojshme pasi ato janë pjesë e gjithë organizmit të njeriut. Sipas akupunkturistëve, këta dhëmbë janë të lidhur me pjesën e përparme të hipofizës si dhe me zorrën e hollë. Kjo traditë mjekësore kineze, e cila është studiuar për më shumë se 5 mijë vite, tregon se ka lidhje mes dhëmbëve vertebrave të shpinës, segmenteve spinale, organeve jetësore dhe

gjëndrave endokrine. Pa korteksin cerebral të trurit, 46% e motorit sensor të nervave janë të lidhura me gojën dhe me fytyrën. Kujdes: Rrënjët e dhëmbit të pjekurisë mund të jenë shumë të rëndësishme. Duhet marrë në konsideratë se rrënjët e disa dhëmbëve mund të jenë me të vërtetë shumë të rrezikshme. Sipas një kërkimi, rreth 57000-175000 njerëz, të cilët kanë hequr rrënjët e dhëmbëve të pjekurisë, kanë dëmtuar nerva të ndryshme në trup. Dihet që sistemi nervor dhe goja janë të lidhura me njëra-tjetrën. Bëni kujdes dhe zgjidheni mirë mjekun nëse vendosni që një ditë të hiqni dhëmbët tuaj të pjekurisë.



## MENUJA IDEALE PËR TË PARANDALUAR TUMORET

Kanceri mund të parandalohet nëse modifikohet regjimi ushqimor. Ky është përfundimi i një sërë studimesh të financuara nga OBSH-ja. Rezultati i tyre është: zgjidhni një dietë vegjetariane, të pasur me disa lloje fruta-perimesh, eliminoni ushqimet e përpunuara dhe të varfra me fibra. Merruni sa më shumë me aktivitet fizik dhe hani të paktën 800 gr fruta në ditë për gjatë gjithë vitit. Mos pini alkool dhe përdorni sa më pak mishin, duke preferuar peshkun dhe mishin e pulës. Eliminoni në maksimum ushqimet e skuqura dhe përdorni vaj ulliri. Eliminoni kripën dhe ushqimet e konservuara. Disa studime të kohëve të fundit kanë treguar se te fruta-perimet e freskëta që nuk gatohen, ekzistojnë substanca të panumërta që ndikojnë në bllokimin e radikalëve të lirë, që në mjaft raste janë shkaktarë të shfaqjes së tumoreve. Disa studiuues gjermanë kanë vërejtur se japonezët, që hanë shumë sojë, janë më pak të rrezikuar nga tumoret, sepse duket se ajo përmban disa substanca, të quajtura isoflavone, që janë estrogen natyrore, që arrijnë të bllokojnë receptorët për estrogenet njerëzore, duke mbrojtur nga kanceri i gjirit. Kjo substancë mund të gjendet te qumështi i sojës, farat dhe pluhuri i sojës. Një substancë tjetër me veprim antioksidant është melatonina, që është një hormone sekret i gjëndrës pishore. Përveç se ndikon në gjumë, ka një veprim të madh antioksidant, që është dy herë më e lartë se i vitaminave E. Studime të tjera kanë treguar se rreziku i kancerit të prostatës ulet deri në 35% te personat që përdorin një menu të pasur me licopen, një sub-

stancë që gjendet me shumicë te domatet. Fibrat luajnë një rol mjaft të rëndësishëm në parandalimin e kancerit, sepse përshpejtojnë kalimin e ushqimeve nëpër aparatit tretës, duke i penguar substancat mutagjene të hyjnë në kontakt të gjatë me mukozat e stomakut. Një lement i rëndësishëm në luftën kundër kancerit është seleni. Në Kinë dhe në Zelandën e Re, në disa zona të varfëra me selen, janë regjistruar një numër i konsiderueshëm kanceresh. Duket se seleni në prani të vitaminës E arrin të mbrojtë nga kanceri i mëlçisë. Në një studim të kryer nga Universiteti i Çikagos, që zgjati gati 5 vjet, u vu re se te 5000 persona që iu dha 200 mcg selen në ditë, u arrit të parandalohej në 69% të rasteve tumori i mëlçisë dhe i ezofagut. Tre probleme të mëdha që ndikojnë për shfaqjen e tumoreve është ruajtja, gatimi i ushqimeve dhe prania e nitrosaminave. Kështu, procesi i përpunimit eliminon shumë vitamina, fibra dhe një pjesë të mirë të kripërave minerale, p.sh. përpunimi i grurit në miell çon në humbjen 100 % të vitaminës A që përmban kjo bimë. Po kështu, gatimi i ushqimeve bën që të humbasin një pjesë e mirë e vitaminave, të bioflavonoideve dhe të strukturës proteinike.



## ZBULOHEK MËNYRA E SHNDËRRIMIT TË MBETURINAVE NË NAFTË

Një e re nga Egjipti ka zbuluar një mënyrë se si mbeturinat plastike t'i kthejë në naftë, zbulim ky që mund të vlejë miliona. Iidet e Azza Faidit kishin tërhequr Institutit të Kërkimeve të Naftës në Egjipt. Ata i dhanë qasje të lirë në laboratorin dhe kërkimet e saj ndihmuan të përsosin formulën për shndërrimin e mbeturinave plastike në naftë. Disa shkencëtar janë duke e quajtur këtë zbulim "bionaftë" për shkak të kemikaleve organike pasi që ajo nxirret nga polimeret plastike, të njëjta kemikale që ekstrahohen nga bimësia për të krijuar etanol të biokarburanteve. Ky proces po ashtu prodhon edhe kemikale tjera të cilat mund të riciklohen dhe shiten. Egjipti në vit prodhon miliona tonë mbeturina plastike çdo vitë, dhe me procesion që Faiada ka zbuluar ato mund të konvertojnë mbeturinat në naftë me vlerë 78

milionë dollarë. Ajo beson se fitimet nga ky zbulim mund të rriten deri në 168 milion dollarë në vit. Unioni Evropian për shkencëtarët e rinj e ka shpërblyer Faiadën me një çmim për punën e saj dhe ajo është duke punuar për të marrë patentën për procesin e shndërrimit të mbeturinave në naftë.



## SHKENCËTARËT KANË KRIJUAR NJË KOMPJUTER QË FUNKSIONON SI TRURI I NJERIUT

Midis kompjuterëve dhe trurit të njeriut mund të gjesh disa të përbashkëta: të dy përdorin sinjale elektrike, ruajnë një numër të madh informacionesh dhe mund të kryejnë detyra të vështira.

Megjithatë, ka edhe disa ndryshime midis tyre. Shkencëtarët kanë krijuar tani një kompjuter që ngjason edhe më shumë me trurin e njeriut. Ata kanë krijuar një memkompjuter, një tip kompjuteri që nuk operon si pajisjet e shpikura nga "babai i kompjuterëve", Alan Turing, para gati një shekulli.

Këta kompjuterë janë shumë të ngjashëm me trurin e njeriut pasi përfshijnë kujtesën

afatshkurtër. Në trurin e njeriut, kujtesa afatshkurtër është vendi ku mbajmë informacionin për të cilin jemi të ndërgjegjshëm për një moment të caktuar.

Kjo kujtesë afatshkurtër ju ndihmon të mbani mend një fjali të caktuar sa për ta mbajtur atë shënim, dhe mund ta harroni pas pesë minutash. Ndërsa tek kompjuteri, kujtesa afatshkurtër ndihmon në përpunimin e numrave dhe ruajtjen e tyre në të njëjtën kohë, dhe jo ndaras, siç veprojnë kompjuterët aktualë.

Këta kompjuterë do të jenë në gjendje gjithashtu të operojnë aplikacione që as kompjuterët më të fuqishëm që janë krijuar deri tani nuk mundën.

## TURQIA ME PROJEKTIN E PARË NË BOTË PËR FURNIZIMIN ME UJË TË QIPROS

Presidenti i Planifikimit të Arsimit të Lartë, Auditimit, Akreditimit dhe Këshillit Koordinues (YODAK), Husein Gokçekush deklaroi se projekti për furnizimin me ujë nga Turqia të Qipros Veriore është drejt përfundimit.

Në universitetin "Lindja e Afërt", në Lefkosia, bashkësisë e inxhinierëve turke dhe ajo e arkitektëve mbajtën një takim informues mbi projektin për

furnizimin me ujë të Qipros Veriore.

Gokçekush tha se projekti është drejt përfundimit dhe se me këtë projekt do të hiqet problematika e ujit të pijshëm e cila ka vazhduar mëse prej 40 vitesh në ishull.

"Tashmë është çështje kohe, ku brenda një kohe të shkurtër ëndrra po realizohet", theksoi ai.

Projekti i furnizimit me ujë

të Qipros Veriore nga Turqia kalon 23 kilometra në linjë tokësore dhe 80 kilometra nën det, në një nivel 250 metra poshtë ujit.

Ky projekt është i pari në botë për nga lloji i tij pasi për herë të parë me anë të një tubacioni, i cili kalon nën det, një numër i madh i popullsisë së Qipros Veriore do të furnizohet me ujë të pijshëm, i cili do të rrjedhë nga Turqia.

## SHKENCËTARËT KANË ZHVILLUAR NJË LËNDË DJEGËSE QË MUND TË PËRDORËT SI KARBURANT

Një ekip shkencëtarësh turq ka zhvilluar një lëndë djegëse të lëngshme që mund të përdoret tek automjetet me benzinë dhe naftë, shkruan Anadolu Agency (AA).

Pritet që i ashtuquajtur "gaz i gjelbër" i cili përmban një element kimik bor dhe hidrogjen, do të përmirësojë efektshmërinë e energjisë, duke kursyer

karburant dhe duke reduktuar emetimet e karbonit.

"Përdorimi i kësaj lënde djegëse në automjete do të mundësojë 20 deri 25 përqind kursimin e karburantit", tha asistenti në Universitetin Yıldırım Beyazıt të Inxhinierisë, Mukerrem Sahi, i cili drejton ekipin e shkencëtarëve.

Sipas tij, ky lloji i ri i zbuluar i karburantit mund të përdoret gjithashtu si lëndë djegëse në raketa.

"Ka potencial që të bëhet karburant i së ardhmes" tha Shahin, duke shtuar se janë në vijim negociatat me kompanitë e naftës në fushën e prodhimit të sasive të mëdha.

## CERN ZBULIME TË REJA, MUND TË NDIHMOJNË PËR "STRUKTURËN" E UNIVERSIT

GJENEVË (AA) - Qendra Europiane Kërkimore Nukleare (CERN) ka deklaruar se ka zbuluar copëza të reja të cilat mund të ndihmojnë për zbulimin e strukturës së universit, raporton Anadolu Agency (AA).

Sipas një deklarate nga CERN thuhet se nga përshejtimi më i fuqishëm dhe i shpejtë i atomit i cili quhet ndryshe si përplasja e Hadron-it për zbulimin e "Higgs Bozonu" janë gjetur copëza të quajtura "pentakuark".

Sipas zëdhënësit të CERN, Guy Wilkinson, "Pentakuark" nuk është vetëm një copëz e re, por një gjë që tregon komponentët bazë të bashkimit të neutroneve me protone gjë e cila nuk është zbuluar në kërkimet e kryera që prej 50 vitesh.

Wilkinson thotë se "pentakuarks" që formohet nga bashkimi i pesë grimcave subatomike në saj të kërkimeve mund të ndihmojë në zbulimin e strukturës së universit.

Dy vite nga përplasja e madhe e Hadronit në muajin qershor pas përplasjes së dytë e cila ishte me dyfishin e energjisë së përplasjes së parë u morën edhe përfundimet e para. Në përplasjen e cila realizohet në një tunel prej 27 kilometrash duke marrë të dhëna fizike shkencëtarët mundohen të gjejnë misterin e strukturës së universit. Me anë të këtyre provave shkencëtarët gjithashtu synojnë edhe zbulime të reja si në fushën e teknologjisë, etj.